



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 37/2021(JR)
Datë 07.07.2021

Vendim nr. 21(JR)
Datë 06.06.2023

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 06.06.2023, ditën e martë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Ramazan Avdiu, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 381, datë 06.05.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Ramazan Avdiu (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) vendosi mbylljen e hetimit administrativ kryesisht vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe në përfundim të procesit të rivlerësimit arriti në këto konkluzione: (i) subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurive të deklaruara, pasi ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016; (ii) nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe veprimeve të kryera prej tij, ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe gjendet në kushtet e pikës 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
3. Në përfundim, Komisioni, bazuar në pikat 1, 3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikat 3 dhe 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 381, datë 06.05.2021, vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Ramazan Avdiu, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.*

II. Shkaqet e ankimit të subjektit i rivlerësimit

4. Kundër vendimit nr. 381, datë 06.05.2021, të Komisionit, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit, duke kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”): (i) prishjen e vendimit të Komisionit si të pabazuar në prova e në ligj; (ii) kthimin për rishqyrtim të çështjes në Komision, pasi nëse do të shqyrtohej nga Kolegji do t’i cenohej e drejta e ankimit në një shkallë më të lartë gjykimi; (iii) gjykimin e çështjes në seancë publike, në mënyrë që t’i garantohet e drejta e mbrojtjes e shkelur në mënyrë thelbësore në procesin administrativ në Komision; (iv) ribërjen e hetimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe hetimin edhe për dy kriteret e tjera; si dhe (v) konfirmim në detyrë.
5. Subjekti i rivlerësimit e konsideron vendimin e Komisionit një vendim të marrë në shkelje flagrante të procesit të rregullt ligjor parashikuar në nenin 42, pika 2, nenin 179/b pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNJ”) dhe nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Ky vendim në vlerësim të subjektit të rivlerësimit nuk bazohet në fakte dhe prova, por merret mbi fakte të pahetuara dhe në zbatim të gabuar të ligjit. Procesin e rivlerësimit të zhvilluar në Komision, subjekti i rivlerësimit e kundërshton, duke ngritur në mënyrë të përmbledhur këto shkaqe ankimore.
 - 5.1. Pas korrigjimit të gabimit material mbi gjendjen e *cash*-it në fund të vitit 2003, Komisioni duhet të riçelte hetimin administrativ për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe të ribënte rezultatin e hetimit, por në kundërshtim me aktin “Hapat procedurale të unifikuar” e kaloi çështjen në seancë dëgjimore. Kjo shkelje e rëndë procedurale bëri që hetimi administrativ, i pambyllur dhe në shkelje të nenit 10 të Kodit të Procedurave Administrative nga Komisioni, të vështirësonte dhe cenonte të drejtën e mbrojtjes efektive në këtë proces, duke e vendosur subjektin e rivlerësimit në kushtet e hamendësimit të qëndrimit të Komisionit mbi ato elementë të rezultatit të hetimit që ndryshuan nga korrigjimi i gabimit material.
 - 5.2. Komisioni duhet të ribënte rezultatet e hetimit administrativ, pas përcaktimit në mënyrë tërësisht arbitrare të nivelit të shpenzimeve të jetesës në masën 66% të të ardhurave për

periudhën 1989 – 2002, pa kryer asnjë hetim lidhur me faktorët thelbësorë që përcaktojnë shpenzimet e jetesës së subjektit të rivlerësimit, në shkelje të pikës 1, të nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 dhe pa marrë në konsideratë: (a) kontekstin jetësor dhe mënyrën e jetesës së subjektit të rivlerësimit; (b) përbërjen familjare me numër të ndryshëm anëtarësh në kohë të ndryshme; (c) vendndodhjen gjeografike ku ka banuar gjatë kësaj periudhe; si dhe (ç) nivelin e të ardhurave, në përcaktimin e masës relative të shpenzimeve të jetesës (zvogëlimi relativ i shpenzimeve në raport me rritjen e të ardhurave). Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës, duke paraqitur pretendime për nënperiudha të ndryshme të periudhës 1989 – 2002.

5.3. Komisioni nuk i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrë prove lidhur me kthimin e shumë 3.641 USD, në vitin 2007, por vetëm mbi mospërputhjet e konstatuara në deklaratën periodike vjetore 2007 me rezultatin e hetimit të llogarive bankare dhe gjendjen *cash* të mbajtur në banesë. Arsyetimi i Komisionit në vendim kapërcen atë çka është kërkuar në hetim, duke cenuar procesin e rregullt ligjor për shkak të cenimit të së drejtës së mbrojtjes. Përfshirja e kësaj shumë në analizë kërkon ribërjen nga fillimi të rezultatit të hetimit për periudhën 2007 – 2016 dhe dhënien e mundësisë subjektit të rivlerësimit të paraqesë mbrojtje efektive dhe shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.

5.4. Subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e asnjë prej dy rasteve të parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës: (i) kur ka deklaruar më shumë se dyfishin e pasurisë së ligjshme; ose (ii) kur përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë, që ndaj tij të jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, për kriterin e vlerësimit të pasurisë. Qëndrimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fsheh apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë huan e z. D. X., subjekti e konsideron në kundërshtim me nenin 6 të KEDNj-së, nenin 42, pika 2 të Kushtetutës, me ligjin nr. 84/2016 e kuadrin ligjor që rregullon marrëdhëniet e subjektit të rivlerësimit në detyrë dhe jashtë saj. Për pasojë, konkluzioni i Komisionit është i pavlefshëm.

5.5. Parashikimi i pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i zbatuar nga Komisioni, kërkon plotësimin e njëkohshëm të dy kushteve, deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe për kontrollin e pasurisë. Për subjektin e rivlerësimit nuk është kryer kontroll i figurës e, për pasojë, masa e marrë në bazë të kësaj dispozite është në kundërshtim me ligjin.

5.6. Referuar pikës 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, masa e shkarkimit nga detyra merret vetëm kur plotësohen njëkohshëm dy kushte: (1) kur nga vlerësimi në tërësi, në kuptim të nenit 4, pika 2 të këtij ligji, rezulton se subjekti ka cenuar besimin e publikut të drejtësia; dhe (2) kur subjekti është në pamundësi për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit. Këto kushte janë kumulative dhe jo alternative. Që të plotësohet kushti i dytë, detyrimisht subjekti duhet të vlerësohet për kriterin e aftësive profesionale, pasi vetëm në vlerësimin e këtij kriteri mundet të arrihet në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit. Në këto kushte, masa disiplinore e dhënë nga Komisioni është në kundërshtim edhe me pikën 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

6. Lidhur me themelin e çështjes, për të kundërshtuar konkluzionet e arritura nga Komisioni në vendim, subjekti i rivlerësimit ka ngritur shkaqe ankimore, të cilat, në mënyrë të përmbledhur, konsistojnë në sa vijon:

6.1. *Për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 52,8 m², ndodhur në Gramsh*

6.1.1. Subjekti i rivlerësimit ka provuar pamundësinë objektive për të vërtetuar marrjen e kredisë për blerjen e minitraktorit dhe kthimin e saj, pasi është tejkaluar afati i ruajtjes së dokumentacionit në sistemin bankar e në arkivë, kredia është marrë dhe shlyer deri në vitin 1998.

6.1.2. Komisioni në vendim nuk shprehet për vërtetësinë dhe fuqinë provuese të deklaratës noteriale të blerësit të minitraktorit B. S.. Komisioni jo vetëm nuk pranoi thirrjen e tij dhe të personave të tjerë si dëshmitarë, por në kundërshtim me pikën 9, të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, as në vendimin përfundimtar dhe as në ndonjë vendim të ndërmjetëm nuk ka arsyetuar refuzimin e kësaj prove. Citimi i dispozitës, nenit 49, pika 6, germa “b”, që në fakt duhet të ishte germa “a”, për refuzimin e thirrjes si dëshmitar nuk përbën arsyetim. Komisioni duhet të analizonte se përse nuk e ka pranuar marrjen e këtyre provave dhe arsyet që marrja e tyre i *dukej e panevojshme*.

6.1.3. Qëndrimi i Komisionit mbi kredinë për blerjen e minitraktorit është kontradiktor, alogjik dhe tërësisht i papranueshëm e tendencioz, pasi kur argumenton shpenzimet e jetesës për periudhën 1989 - nëntor 1996, pranon faktin e marrjes dhe kryerjes së pagesave për shlyerjen e kredisë. Në periudhën 1989 - dhjetor 1993, nuk pranon mundësi kursimesh me arsyetimin e marrjes kredi për blerjen e minitraktorit. Në periudhën janar 1994 - nëntor 1995, shprehet se subjektit i është dashur të paguajë kredinë. Pra, për të llogaritur shpenzime sa më të larta dhe kursime sa më të ulëta, Komisioni pranon marrjen dhe shlyerjen e kredisë, ndërsa kur verifikon mundësinë financiare për blerjen e apartamentit nuk pranon ekzistencën e kredisë, me arsyetimin se nuk provohet marrja e saj.

6.1.4. Përfundimi i Komisionit, se për blerjen e apartamentit subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratime të ndryshme në deklaratat periodike, deklaratën e pasurisë *vetting* dhe prapësimet për rezultatet e hetimit, është i pavërtetë, pa evidentuar dhe argumentuar deklaratimet apo shpjegimet e ndryshme.

6.1.5. Pamundësia financiare, për blerjen e apartamentit në shumën (-) 130.251 lekë e konstatuar nga Komisioni, është tërësisht e padrejtë, bazuar në llogaritjen e gabuar të shpenzimeve të jetesës, si edhe mos marrjen në konsideratë të shumës 100.000 lekë nga shitja e minitraktorit, ndërkohë që subjekti rezulton me tepriçë pozitive 107.373 lekë.

6.1.6. Lidhur me kredinë për minitraktorin, konkluzioni i Komisionit është i padrejtë, mbështetur në fakte të pavërteta e të pahetuara, mosmarrjen e provave për hetimin e fakteve, pranimin dhe mohimin të të njëjtit fakt në analizën përfundimtare. Veprime këto që kanë cenuar të drejtën e mbrojtjes efektive për një proces të rregullt ligjor. Komisioni nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të subjektit.

6.1.7. Për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës deri në nëntor 1996, nuk është hetuar dhe vlerësuar asnjë rrethanë faktike, në kundërshtim me nenin 45, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Vendimi i Komisionit është i paarsyetuar dhe me përmbajtje kontradiktore, në shkelje me standardin kushtetues të procesit të rregullt ligjor, përcaktuar në praktikën e Gjykatës Kushtetuese (vendimi nr. 33/2005).

6.1.8. Është e domosdoshme të hetohen dhe vlerësohen sipas rrethanave dhe fakteve të provuara shpenzimet e jetesës për periudhën 1989 - nëntor 1996, pasi ndikojnë drejtpërdrejtë në përlllogaritjen e burimit të ligjshëm për blerjen e apartamentit. Subjekti kërkon nga Kolegji, ribërjen e rezultatit të hetimit për këtë shkak dhe shqyrtimin e çështjes në seancë publike, në të kundërt do t'i mohohet e drejta e mbrojtjes.

6.2. Lidhur me huan dhënë z. H. B. në maj 2002

6.2.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton metodologjinë e llogaritjes së shpenzimeve për gjithë periudhën 1996 - 2002, pasojë e mosmarrjes në konsideratë të fakteve dhe provave apo mbështetjes në fakte të pahetuara dhe konkludimit në llogaritje formale, që ndikojnë drejtpërdrejtë në burimin e ligjshëm për dhënien e huas.

6.2.2. Ndryshe nga sa arsyeton në vendim, Komisioni nuk ka paraqitur një tabelë analitike ku të ketë pasqyruar të ardhurat e shpenzimet, ashtu siç i ka pranuar duke u shprehur në vendim se nga llogaritjet gjendja negative ka rezultuar (-) 416.130 lekë. Për këtë pjesë, vendimi i Komisionit është i paarsyetuar.

6.2.3. Kolegji, duke vlerësuar të gjitha rrethanat, të pranojë pagesën e tatimit në vitin 2021 për shumën 893.396 lekë, që konsiston në dëmin që gjykata i ka njohur subjektit të rivlerësimit për mospërmbushjen e detyrimeve ndaj tij nga huamarrësi H. B. dhe ta pranojë këtë shumë si burim të ligjshëm financiar.

6.2.4. Konkluzioni i Komisionit për mosnjohjen e shumës 1.440.000 lekë, si e ardhur nga burime të ligjshme, është i padrejtë dhe i pabazuar. Edhe nëse nuk pranohet pagesa e tatimit mbi të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor, shuma prej 1.440.000 lekësh duhet të njihet si e ardhur e ligjshme në vitin 2009, pasi përbën principalin e huas.

6.2.5. Shuma e përfituar nga vendimi gjyqësor, principali dhe shlyerja e dëmit, është depozituar në bankë dhe deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2009, e nëse organet tatimore të ngarkuara nga ligji do të kryenin kontrollin përkatës do të kishin evidentuar këtë mangësi e do të ndërmerrnin masat përkatëse, të cilave subjekti do t'i përgjigjej duke kryer pagesat respektive.

6.2.6. Tatimi mbi këto të ardhura nuk duhet të paguhej, si dhe nuk kujton nëse e ka bërë pagesën. Megjithatë, mospagesa mund të jetë pasojë e harresës ose ndonjë interpretim i pasaktë i ligjit të kohës.

6.3. *Për ndërtimin informal me sipërfaqe 68 m², në apartamentin me sipërfaqe 52,8 m², në Gramsh*

6.3.1. Konkluzioni i Komisionit se për kohën e ndërtimit të shtesës shpjegimet e subjektit të rivlerësimit janë kontradiktore është i pambështetur, i paarsyetuar, nuk përmend cilat shpjegime ishin kontradiktore, si dhe nuk analizon provat e pretendimet e subjektit të rivlerësimit për këtë çështje. Me provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, provohet në mënyrë të padyshimtë fakti që shtesa është përfunduar në gjendjen e deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2012, në muajin tetor.

6.3.2. Lidhur me vlerën e ndërtimit, konkluzionet e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor të kohës (preventiv/situacion) për ndërtimin e shtesës dhe se është në pamundësi financiare për të mbuluar ndërtimin në fazën e deklaruar, janë tërësisht të pambështetura në provat e paraqitura.

6.3.3. Mungesa e dokumentacionit për vlerën në kohën e ndërtimit, vjen pasi ndërtimi nuk është bërë me leje apo nga një shoqëri ndërtimi, të cilat hartojnë preventiv e situacione dhe lëshojnë fatura tatimore për vlerën e mallrave dhe punimet e kryera, arsye e pamundësisë objektive për paraqitjen e dokumenteve për të provuar vlerën e ndërtimit. Këto rrethana nuk përjashtojnë mundësinë e vlerësimit të objektit me ekspert vlerësues bazuar në çmimet e tregut apo atyre të miratuara si orientim për preventivimin e punëve publike në rastin e prokurimit të fondeve publike, siç ka vepruar subjekti i rivlerësimit.

6.3.4. Mospranimi si provë i aktit të ekspertit vlerësues, me arsyetimin se zërat dhe volumet e punës janë llogaritur sipas sqarimeve të subjektit të rivlerësimit, pasi shtesa kishte përfunduar, është haptazi i pabazuar, pasi volumet dhe zërat e punimeve janë llogaritur mbi bazën e gjendjes faktike në kohën e kryerjes së tyre.

6.3.5. Vlera e përcaktuar nga Komisioni nuk është e saktë, në kushtet kur shtesa anësore nuk ka pasur faqe perëndimore, pra, as mur e as suvatime të brendshme dhe të jashtme, as dyer e dritare. Referenca të çmimit sipas Entit Kombëtar të Banesave (në vijim "EKB") nuk është e

saktë, pasi në rastin konkret nuk përfshihen punimet që i shërbejnë ambienteve të përbashkëta si kafazi i shkallës, rrjeti i përbashkët elektrik e hidraulik apo izolimi i tarracës.

6.3.6. Në përcaktimin e vlerës së karabinasë, Komisioni nuk referon akt ligjor, nënligjor apo disiplinë shkencore të ndërtimit ku të specifikohet se masa e shpenzimeve të ndërtimit në fazën e karabinasë përbën 70% të vlerës së objektit të përfunduar, gjë që e bën përfundimin e arritur prej tij, arbitrar.

6.3.7. Duke përlllogaritur vetëm elementin hua të kthyer nga z. P. B. në vitin 2012 në shumën 300.000 lekë apo gjendjen *cash* në fund të vitit 2007, kundërvlerën e shumës prej 3.641 USD pa këtë hua, provohet në mënyrë kategorike mjaftueshmëria e burimeve të ligjshme për ndërtimin e shtesës.

6.4. *Lidhur me mjetet monetare, depozita, llogari rrjedhëse të deklaruara në deklaratën e pasurisë vetting*

6.4.1. Komisioni nuk është shprehur në vendim nëse depozita bankare në shumën 500.000 lekë, çelur nga subjekti i rivlerësimit më datë 11.06.2015, në bankën “Societe Generale Albania” ShA, dega Gramsh, është krijuar me burime të ligjshme. Si burim krijimi për këtë pasuri duhet të konsiderohet edhe shuma 1.070.000 lekë e kthyer nga huamarrësi A. D., në maj 2015. Procesi i hetimit dhe arsyetimi i Komisionit janë tërësisht inkoherentë.

6.4.2. Për depozitën bankare në shumën 500.000 lekë, çelur nga bashkëshortja në bankën “Societe Generale Albania” ShA, dega Gramsh, më datë 10.07.2013, Komisioni, pas rishikimit të analizës financiare, konstatoi pamjaftueshmëri në vlerën (-) 229.167 lekë të burimeve financiare të ligjshme, por pa ribërë rezultatin e hetimit për të evidentuar se nga cilët elementë kishte ardhur ky ndryshim, duke vënë në vështirësi subjektin e rivlerësimit për realizimin e mbrojtjes.

6.4.3. Mosnjohja e padrejtë e kundërvlerës së shumës 3.641 USD *cash* gjendje në fund të vitit 2007 si burim krijimi të kësaj depozite, sjell pakësimin e burimeve financiare në vijim dhe jep efekt zinxhir në shumë elementë të analizës. Edhe nëse në analizë nuk përfshihet kjo gjendje *cash*, përsëri subjekti i rivlerësimit rezulton me balancë pozitive në masën 125.749 lekë.

6.4.4. Përderisa Komisioni për këtë depozitë nuk ka paraqitur në vendim analizë financiare, si dhe nuk është shprehur lidhur me argumentet e subjektit të rivlerësimit se ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e kësaj depozite, Komisioni ka pranuar ligjshmërinë e burimit, pasi në të kundërt vendimi do të ishte pasojë e procesit të parregullt ligjor, pa i dhënë përgjigje pretendimeve ngritur nga subjekti për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, duke i cenuar kështu të drejtën e mbrojtjes.

6.4.5. Lidhur me depozitën bankare në shumën 800.000 lekë, çelur nga bashkëshortja në bankën “Societe Generale Albania” ShA, dega Gramsh, më datë 14 tetor 2013, në vendim, Komisioni nuk është shprehur nëse kjo depozitë është me burime financiare të ligjshme, që të çon në përfundimin se Komisioni ka njohur ligjshmërinë e burimeve të krijimit të saj, në të kundërt, kishte detyrimin të paraqiste në vendim si analizën financiare, ashtu edhe përfundimet, lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për këtë çështje. Pavarësisht përfshirjes ose jo të shumës 3.641 USD, rezultati negativ ka ardhur edhe si pasojë e mosnjohjes pa të drejtë si burim i ligjshëm i shumës 600.000 lekë kthyer nga huamarrësi P. B. në vitin 2013.

6.5. *Për huan dhënë z. D. X. më datë 22.07.2004*

6.5.1. Konkluzionet e Komisionit për këtë hua janë të pabazuara në prova e në ligj. Në kohën e dhënies së huas, shuma nuk ka qenë as në përdorim e as në posedim të subjektit të rivlerësimit, por mbahej thjesht në ruajtje prej tij. Veprimi juridik është kryer faktikisht në vitin 2003 nga vëllai i subjektit dhe jo prej vetë subjektit. Deklarata me shkrim në vitin 2004 nuk ka pasur si

qëllim lidhjen e një kontrate të re, por vërtetimin e marrjes së huas në shumën 20.000 USD, në vitin 2003 për llogari të z. D. X. nga z. B. Ç.. Subjekti i rivlerësimit në këto kushte nuk kishte detyrim ligjor të deklaronte këtë hua në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie në vitin 2003 dhe deklaratën periodike vjetore 2004.

6.5.2. Veprimet e subjektit nuk mund të vlerësohen si përpjekje për fshehje apo për deklarim të pasaktë të pasurisë, kur huaja nuk është zbuluar si pasojë e veprimeve hetimore të kryera nga Komisioni, por nga deklaratimet me vërtetësi të bëra nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit të Komisionit.

6.5.3. Huaja buron nga të ardhura të ligjshme, si asistenca dhe puna në ndërtim e vëllezërve të subjektit të rivlerësimit, në Angli. Mënyra e dërgimit të shumave në rrugë ligjore nëpërmjet transfertave u jepte autoriteteve angleze dhe shqiptare mundësinë e verifikimit nëse do të kishin dyshime lidhur me ligjshmërinë e tyre.

6.5.4. Komisioni nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit të subjektit të rivlerësimit se vëllezërit e tij nuk mund të konsiderohen “persona të tjerë të lidhur” me të, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016, duke i cenuar kështu të drejtën e mbrojtjes e duke e bërë procesin të parregullt.

6.5.5. Huaja nuk ka qenë e ndaluar nga aktet që rregullonin këto marrëdhënie e, për pasojë, qëndrimi i Komisionit se subjekti nuk duhet të kishte hyrë në këto marrëdhënie sepse është informale, me burime të panjohura, nga persona të panjohur, është tërësisht i padrejtë. Subjekti nuk ka dëmtuar interesat e asnjë personi veçse të tij e të vëllezërve të tij.

6.5.6. Është tërësisht i pabazuar në provat e paraqitura arsyetimi i Komisionit në vendim, ku në mënyrë evazive shprehet se subjekti është përpjekur të fshehë apo paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë. Komisioni duhet të përcaktonte nëse subjekti ka fshehur pasurinë apo është përpjekur ta paraqesë në mënyrë të pasaktë atë. Vendimi i Komisionit është alogjik dhe kontradiktor.

6.5.7. Komisioni nuk ka analizuar asnjë prej pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që duhet t’i analizonte e të vendoste arsyet e mospranimit duke bërë analizën e provave. Kjo analizë nuk bëhet vetëm duke cituar përmbajtjen e provave, por duke vlerësuar fuqinë provuese të tyre, në raport me provat e tjera, nga shqyrtimi në tërësi i rrethanave të çështjes.

6.6. Lidhur me huat në vitet 2011, 2013 dhe 2015

6.6.1. Për huat dhënë z. P. B. në vitin 2011, z. A. D. dhe znj. Sh. D. në vitin 2013 nga bashkëshortja e subjektit, si dhe huan dhënë z. F. M. në vitin 2015, në mënyrë të përmbledhur subjekti i rivlerësimit, pretendon se: (i) ka provuar tërësisht burimin e ligjshëm të të ardhurave për dhënien dhe për kthimin e tyre në masën e deklaruar; (ii) ndonëse ka vënë në dyshim huat, Komisioni në vendim nuk është shprehur qartë nëse i pranon apo jo ato, ndërkohë që në rezultatin e hetimit administrativ nuk ka ngritur dyshim për dhënien e tyre dhe as nuk ka vënë në diskutim ligjshmërinë e burimit; (iii) konkluzioni i Komisionit se nuk ka prova që provojnë se huat janë dhënë me normë interesi sa interesat bankarë është tërësisht i padrejtë, në kundërshtim me provat dhe ligjin e aplikueshëm. Dyshimi i Komisionit për interesin 10% është tërësisht i pabazuar; (iv) Komisioni nuk arsyeton se në cilin akt ligjor apo nënligjor parashikohet se kthimi i huas ndërmjet subjekteve private duhet të bëhet vetëm nëpërmjet kanaleve bankare; (iv) përfundimet e Komisionit, për moskryerje, paqartësi apo mangësi në pagesën e tatimit, janë tërësisht të padrejta, alogjike dhe tendencioze. Nga Komisioni pranohet pagesa e tatimit në masën e deklaruar, por vihet në dyshim nëse është për këto të ardhura; (v) konkluzioni i Komisionit, se shumat e kthyera nga huamarrësit me arsyetimin se mbeten në kontekstin deklarativ dhe të paprovuara me ndonjë dokument financiar apo ligjor, është i paarsyetuar e i pabazuar në Kodin Civil dhe Kodin e Procedurës Civile.

III. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

7. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ramazan Avdiu, vendim të cilin nëpërmjet ankimit subjekti kërkon ta prishë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara, në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

8. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenin F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

9. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 381, datë 06.05.2021, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit, z. Ramazan Avdiu, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi.
10. Në fillim të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, trupi gjykues i Kolegjit shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, duke analizuar shkaqet me natyrë procedurale të ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim dhe parashtrime, si dhe kërkesën e tij për riçeljen e hetimit gjyqësor e administrimitin e provave të reja, për të vlerësuar nëse ishte i nevojshëm debati gjyqësor për korrigjimin e ndonjë shkelje të rëndë procedurale të Komisionit apo me qëllim konstatimin e saktë, të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike të çështjes.
11. Për të evidentuar shkeljet procedurale që do të cenonin procesin e rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 6, paragrafi 1 i KEDNj-së, trupi gjykues i Kolegjit mori në analizë shkaqet e ankimit me natyrë procedurale të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, si paraqitur në vijim.

11.1. Pas korrigjimit të gabimit material mbi gjendjen e *cash*-it në fund të vitit 2003, Komisioni duhet të riçelte hetimin administrativ për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe të ribënte rezultatin e hetimit, pasi në kundërshtim me “Hapat procedurale të unifikuar”¹ kaloi çështjen në seancë dëgjimore, në shkelje të pariparueshme të nenit 10 të Kodit të Procedurave Administrative. Komisioni ka vështirësuar dhe cenuar të drejtën e mbrojtjes efektive të subjektit të rivlerësimit në këtë proces, pasi subjekti i rivlerësimit duhej të hamendësonte qëndrimin e Komisionit në lidhje me ato fakte të rezultatit të hetimit që ndryshuan nga

¹ Miratuar me vendimin nr. 7, datë 12.02.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit “Hapat Proceduralë të Unifikuar”, i ndryshuar.

korrigjimi i gabimit material. Procesi i rregullt ligjor, referuar në vendimet² e Gjykatës Kushtetuese, cenohet për shkak të mosdhënies përgjigje e mosanalizimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, të vënies në pamundësi apo në kushte më pak të favorshme të njërës palë, (duke e konsideruar Komisionin *de facto* në pozitën procedurale të palës kundërshtare), të shkeljes së parimit të barazisë së armëve, shkeljes së parimit të paanshmërisë në gjykim, të mosarsyetimit të vendimit apo arsyetimit me kontradikta e kundërthënie thelbësore, etj. Lidhur me këto pretendime, trupi gjykues konstaton si vijon:

11.1.1. Pas administrimit të raportit të dorëzuar nga ILDKPKI-ja, dokumentacionit shoqërues të tij, dokumenteve shkresore të organeve publike dhe private, të administruara në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhënë në përgjigje të pyetësorëve, si dhe aktet shkresore të depozituara prej tij, Komisioni, më datë 11.03.2021, i përcjell subjektit të rivlerësimit “*Rezultatet e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Ramazan Avdiu*” (në vijim “rezultatet e hetimit”). Në zbatim të nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kalon subjektit të rivlerësimit barrën e provës duke i bërë me dije, njëkohësisht, të drejtën për t’u njohur me dokumentet e dosjes së procedurës së rivlerësimit, pajisjen me një kopje të tyre, si dhe e informon se mund të kërkojë thirrjen e dëshmitarëve apo marrjen e çdo prove mbështetëse, nëpërmjet paraqitjes së një kërkesë që duhet të përmbante informacionin e nevojshëm për verifikimin dhe kontaktimin e dëshmitarit ose provës, si dhe të dhëna mbi thelbin e informacionit të pritshëm.

11.1.2. Më datë 05.04.2021, subjekti i rivlerësimit përcjell “*Konstatime, kundërshtime, sqarime dhe kërkesa rreth rezultateve të hetimit administrativ nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Ramazan Avdiu*” (në vijim “prapësime mbi rezultatet e hetimit”), në të cilat parashtron edhe një sërë kërkesash, të cilat në mënyrë të përmbledhur konsistojnë në ribërjen e analizës financiare 1989 – 2002, duke marrë në konsideratë nivelin real të shpenzimeve të jetesës për subjektin e rivlerësimit, korrigjimin e gabimit material lidhur me likuiditetin në *cash* të deklaruar në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie 2003, thirrjen e dëshmitarëve, kryerjen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, etj.

11.1.3. Në përgjigje të këtyre kërkesave, Komisioni, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar, me vendimin e datës 13.04.2021, vendosi: (1) mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për kryerjen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, me arsyetimin se provat e grumbulluara deri në atë moment kishin arritur nivelin e provueshmërisë; (2) pranimin dhe administrimin e të gjitha provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit; (3) mospranimin e kërkesës për thirrjen si dëshmitar të personave: A. A., B. S., P. B., A. D. dhe E. D., pasi në bazë të germës “a”, pika 6 e nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, thirrja e tyre ishte e panevojshme, për sa kohë ata kanë shprehur vullnetin e tyre në formë të shkruar, nëpërmjet deklaratave noteriale; (4) mospranimin e kërkesës për thirrjen si dëshmitar të personave: S. Ç., E. T., H. A., Xh. D., P. A., B. (N.) A., H. (M.) Ç., V. (V.) S., A. K., A. B., N. B., H. M., G. L. dhe B. Ç., pasi në bazë të germës “b” të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, thirrja e tyre *duket e panevojshme*. Trupi gjykues konstaton se Komisioni i është referuar nenit 49, pika 6, germa “b” e ligjit nr. 84/2016³, ndërkohë që ka cituar përmbajtjen e germës “a” të kësaj dispozite, gjë që në vlerësim të tij nuk cenon ndonjë të drejtë të subjektit

² *Vendimet e Gjykatës Kushtetuese: vendimet nr. 23/2007 dhe nr. 34/2011, për shkelje të parimit të barazisë së armëve; vendimi nr. 15/2007, për shkeljen e parimit të paanshmërisë në gjykim; vendimi nr. 23/2021, për shkeljen e të drejtës së aksesit në gjykatë dhe të mbrojtjes; si dhe vendimet nr. 8/2006 dhe nr. 17/2005, lidhur me parimin e së drejtës për t’u dëgjuar e mbrojtur.*

³ *Neni 49, pika 6, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “6. Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: [...] b. fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjyqimit”.*

të rivlerësimit, në kushtet kur përmbajtja dhe qëllimi i këtyre dy parashikimeve nuk është i ndryshëm në kuadër të këtij procesi. Më datë 13.04.2021, Komisioni i përcjell subjektin vendimin e tij të së njëjtës datë, lidhur me kërkesat e paraqitura, duke e ftuar në të njëjtën kohë për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore më datë 15.04.2021.

11.1.4. Gjatë seancës dëgjimore të datës 15.04.2021, pas përfundimit të relatimit nga relatorja e çështjes, subjekti i rivlerësimit paraqiti një kërkesë me shkrim *“Për riçeljen e hetimit për kriterin e pasurisë, të dy kritereve të tjera, si dhe për marrjen e provave të reja”*, me arsyetimin se në analizën financiare është bërë një gabim material me pasojë në të gjithë analizën financiare për periudhën 2003 - 2016. Gabimisht, gjendja e likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2003, është konsideruar nga Komisioni 35.000 lekë, ndërkohë që është deklaruar 350.000 lekë në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie 2003, gjë që ka sjellë një zinxhir gabimesh të njëpasnjëshme, duke e bërë analizën jo reale, bazuar në të dhëna të pavërteta dhe duke e vënë subjektin e rivlerësimit në pamundësi të bëjë një mbrojtje efektive. Me referencë në pikën 11 të aktit *“Hapat procedurale të unifikuar”*⁴ të Komisionit, subjekti pretendon se ka arsye të rëndësishme për të mos kaluar në seancë dëgjimore, por të riçelët hetimi pasuror.

11.1.5. Korrigjimi i gabimit të mësipërm, sipas subjektit, sjell pasojë të drejtpërdrejtë në përjashtimin nga të ardhurat të kundërvlerës së shumës 3.641 USD, në vitin 2007 dhe një depozitë fillestare çelur në OTP Bank ShA, në vitin 2005, në masën 250.000 lekë dhe, për pasojë, ndikon në gjendjen financiare vit pas viti. Riçeljen e hetimit subjekti e kërkon edhe për faktin se shpenzimet e jetesës para vitit 2000 janë përcaktuar në masën arbitrare 66% të të ardhurave nga pagat, pa argumentuar metodologjinë e përdorur.

11.1.6. Këto pretendime, subjekti i rivlerësimit i kishte paraqitur që në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, por që Komisioni, në vendimin e arsyetuar të datës 13.04.2021, nuk u kishte dhënë përgjigje. Në këto kushte, Komisioni, me vendimin nr. 6, datë 15.04.2021, ndër të tjera, vendosi: (i) të pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për riçeljen e hetimit administrativ për kriterin e pasurisë me qëllim saktësimin e gabimit material në pasqyrimin e gjendjes së *cash*-it në analizën financiare në një vit dhe ridërgimin e analizës financiare të rishikuar në vijim subjektit të rivlerësimit; (ii) në lidhje me kërkesat e tjera të subjektit të rivlerësimit, Komisioni i qëndroi vendimit të dërguar në datën 13.04.2021 për mosçeljen e hetimit administrativ për dy kriteret e tjera deri në këtë fazë të procesit.

11.1.7. Më datë 16.04.2021, Komisioni i dërgon subjektit të rivlerësimit tabelën e analizës financiare të rishikuar, si dhe materialin sqarues *“Reflektim i ndryshimit të cash-it në analizën financiare”*. Referuar këtij materiali, Komisioni, me konsideratë gabimin material të kryer në analizën financiare lidhur me *cash*-in e deklaruar në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie 2003, ka reflektuar në analizën e rishikuar ndryshimin e gjendjes *cash* në fund të vitit 2003 në vlerën 350.000 lekë nga 35.000 lekë që ishte përllogaritur gabimisht në analizën fillestare të kryer për periudhën 2003 – 2016. Rezultati financiar për vitin 2003 ndryshon nga pozitiv në rezultatet e hetimit administrativ, në vlerën negative (-) 146.746 lekë me analizën e rishikuar. Efektet e korrigjimit të gabimit material i janë shpjeguar subjektit të rivlerësimit nga Komisioni me shkrim, analitikisht, si vijon:

⁴ Pika 11 e aktit *“Hapat procedurale të unifikuar”* parashikon: *“Trupa, në mbledhjen e thirrur nga kryesuesi, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, mund të vendosë për kalimin e çështjes në seancë dëgjimore. Në këtë rast, trupa vendos për njoftimin e subjektit, për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të seancës dëgjimore. Afati për zhvillimin e seancës dëgjimore nuk mund të jetë më shumë se 15 ditë nga data e njoftimit të subjektit për t'u dëgjuar në seancë”*.

1. Ndërtim informal me sipërfaqe 68 m², rezultati negativ nuk ndryshon, ngelet në vlerën (-) 1.085.407 lekë.
2. Apartament banimi me sipërfaqe 88,77 m² në qytetin e Gramshit, rezultati pozitiv ndryshon nga 129.684 lekë në 444.468 lekë.
3. Automjetet tip "Volkswagen", {***}, rezultati negativ ndryshon nga (-) 327.156 lekë në (-) 12.216 lekë.
4. Depozitë bankare 500.000 lekë, datë 11 qershor 2015, rezultati ndryshon nga rezultat negativ në vlerën (-) 511.249 lekë në rezultat pozitiv në vlerën 384.216 lekë.
5. Depozitë bankare 500.000 lekë, në emër të bashkëshortes, në datën 10 korrik 2013, rezultati negativ ulet nga vlera (-) 544.167 lekë në vlerën (-) 229.167 lekë.
6. Depozitë bankare 800.000 lekë në emër të bashkëshortes, në datën 14 tetor 2013, rezultati negativ ndryshon nga vlera (-) 506.287 lekë në vlerën (-) 409.626 lekë.
7. Dhënia hua debitorit P. B., rezultati negativ ulet nga vlera (-) 152.843 lekë në vlerën (-) 2.843 lekë.
8. Dhënia hua debitorit A. D., rezultati pozitiv nuk ndryshon, ngelet në vlerën 345.460 lekë.
9. Dhënia hua debitorit F. M., rezultati negativ ulet nga vlera (-) 419.535 lekë në vlerën (-) 104.535 lekë.
10. Depozitë bankare në vlerën 1.500.000 lekë në datën 1 tetor 2010, rezultati negativ nuk ndryshon, ngelet në vlerën (-) 173.497 lekë.
11. Depozitë në vlerën 250.000 lekë dhe 3.000 USD në datën 28 prill 2005, rezultati ndryshon nga vlera (-) 358.698 lekë në vlerën pozitive 13.932 lekë.

11.1.8. Në seancën dëgjimore të datës 30.04.2021, nisur nga fakti që korrigjimi i gabimit material kishte afektuar ndryshimin e 9 (nëntë) elementëve të analizës financiare, kjo sipas subjektit të rivlerësimit duhet të kishte çuar Komisionin drejt ribërjes së rezultateve të hetimit, që të reflektonte qëndrimin e Komisionit në lidhje me ato elementë që preken nga korrigjimi, në kuadër të mbrojtjes efektive të tij. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues i Kolegjit nuk konstaton shkelje të kryer nga Komisioni, pasi, pas ndreqjes së gabimit material të konstatuar, subjektit të rivlerësimit iu bënë me dije nga Komisioni, me shkrim, specifikisht rezultatet e afektuara nga korrektimi i gjendjes së likuiditetit të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur në *cash* në fund të vitit 2003 dhe ndryshimi i gjendjes së likuiditeteve për vitet 2003-2016.

11.1.9. Në rastin objekt shqyrtimi, trupi gjykues nuk konstaton shkelje të parimit të barazisë së armëve, parimit të kontradiktoritetit, paanshmërisë në gjykim, të drejtës së aksesit në gjykatë, të drejtës për t'u dëgjuar e mbrojtur që do të çonin në cenim të procesit të rregullt ligjor. Nga analizimi i akteve në dosje, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur kohë të mjaftueshme për përgatitjen e përgjigjeve të pyetësorëve dhe prapësimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ. Komisioni i ka miratuar subjektit të rivlerësimit kërkesën për shtyrje afati në rastin e dërgimit të prapësimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ nga data 22.03.2021 në datën 05.04.2021, si dhe kërkesën për shtyrjen e seancës dëgjimore nga data 26.04.2021 në datën 30.04.2021, për shkak të një fatkeqësie familjare të tij. Subjekti i rivlerësimit është njohur me dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit administrativ të zhvilluar në Komision dhe nëpërmjet deklaratës së nënshkruar prej tij më datë 25.03.2021, ka deklaruar se nuk ka asnjë vërejtje në lidhje me të. Analiza financiare e rishikuar nuk përmban të dhëna të tjera përveç atyre të ekstraktuara nga dokumentacioni i dosjes gjyqësore, të njohur nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, nga analizimi i procesverbalit të të dy seancave dëgjimore të zhvilluara në datën 15.04.2021 (me kohëzgjatje 1 orë e 28 minuta) dhe më 30.04.2021 (me kohëzgjatje 4 orë e 34 minuta), duket qartë se subjekti i rivlerësimit ka pasur kohën e mjaftueshme për të parashtruar

shpjegimet e tij të detajuara, në kuadër të mbrojtjes efektive në këtë proces. Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

11.2. Një shkak ankimor i ngritur nga subjekti, lidhur me procedurën e ndjekur nga Komisioni, përmes të cilit ai kërkonte ribërjen e rezultateve të hetimit administrativ, është përcaktimi në mënyrë tërësisht arbitrare nga Komisioni i nivelit të shpenzimeve të jetesës në masën 66% të të ardhurave nga pagat për periudhën 1989 – 2002, pa kryer asnjë hetim lidhur me faktorët thelbësorë që përcaktojnë shpenzimet e jetesës të subjektit të rivlerësimit, në shkëlqje të pikës 1, të nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, pa marrë në konsideratë: (a) kontekstin jetësor dhe mënyrën e jetesës së subjektit të rivlerësimit; (b) përbërjen familjare me numër të ndryshëm anëtarësh në kohë të ndryshme; (c) vendndodhjen gjeografike ku ka banuar gjatë kësaj periudhe; si dhe (ç) nivelin e të ardhurave, në përcaktimin e masës relative të shpenzimeve të jetesës (zvogëlimi relativ i shpenzimeve në raport me rritjen e të ardhurave). Në përgjigje të këtij shkak ankimor, trupi gjykues konstaton si vijon.

11.2.1. Nga analizimi i akteve në dosjen gjyqësore, trupit gjykues i rezulton se çështja më e kontestuar nga subjekti i rivlerësimit për periudhën 1989 – 2002, si gjatë hetimit administrativ në Komision dhe në ankim, të jetë ajo e përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës. Niveli i shpenzimeve të jetesës për periudhën 1989 – 2002 është analizuar për dy elementë të kriterit të pasurisë: (i) blerjen e apartamentit me sipërfaqe 52,8 m² në Gramsh, në nëntor 1996, në vlerën 420.000 lekë; dhe (ii) dhënien e huas në maj 2002, në vlerën 1.440.000 lekë, z. H. B.. Me rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni shpjegon se shpenzimet për jetesë para vitit 2000, u llogaritën në masën 66% të të ardhurave nga pagat, referuar në vendimin (JR) nr. 18, datë 26.07.2019, të Kolegjit, ndërsa për vitet 2000 – 2016, u bazuan në shpenzimet e jetesës të përcaktuara në raportin e ILDKPKI-së.

11.2.2. Lidhur me përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës, në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit parashtron se procesi i rivlerësimit është me natyrë individuale dhe për garantimin e një procesi të rregullt ligjor, Komisioni do të duhej të realizonte një analizë të bazuar në detaje të hollësishme individuale të subjektit të rivlerësimit, si një element thelbësor në analizën e pasurisë së tij. Niveli i shpenzimeve të jetesës diktohet në raport me nivelin e të ardhurave, stilin e jetesës, periudhën, vendndodhjen gjeografike dhe jo sipas një niveli fiks që mund të konsiderohet “arbitrar” për periudhën 1989 – 1999. Niveli i shpenzimeve jetësore prej 66 % të të ardhurave nga pagat është një indikator, i cili çon në konkluzione të deformatuara, deri absurde. Sipas subjektit, jetesa në fshat, kushtet e vështira ekonomike, familja me 9 (nëntë) anëtarë, ku subjekti ishte fëmija i parë, kanë ngulitur tek ai konceptin e reduktimit në maksimum të shpenzimeve të panevojshme. Subjekti i rivlerësimit sqaron se stili i tij i jetesës është relativisht modest, i orientuar drejt një jete normale, pa shpenzime të tepërta dhe të krahasueshme me komunitetin ku ka jetuar. Subjekti i rivlerësimit parashtron një sërë faktorësh që provojnë prirjen e tij drejt kursimit: prejardhjen e tij nga një familje punëtore, pa pasuri të trashëguara, me prindër të cilët kanë punuar shumë; pa kryer udhëtime jashtë shtetit, përveç një udhëtimi pune në 1999; pa bërë në këtë periudhë pushime verore apo fundjavave, jashtë vendbanimit; e vetmja pasuri deri në vitin 2009 ka qenë blerja e apartamenti me sipërfaqe 52,8 m² ndodhur në Gramsh, nga ku është larguar në vitin 2010, pasi për familjen ishte e domosdoshme një apartament me hapësirë më të madhe; dhe për periudhën 1996 – 2002 nuk ka bërë asnjë riparim të apartamentit, përveç zëvendësimit të derës me një derë metalike, si pasojë e një akti kriminal. Në mbështetje të argumenteve të tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur fragmente nëpërmjet disa video-regjistrimeve të ndryshme për periudhën 1997 – 2002, që sipas tij tregojnë mobilimin e thjeshtë të apartamentit dhe mënyrën modeste të jetesës, në funksion të pretendimeve të mësipërme, subjekti, gjithashtu, shpjegon se i pari dhe i vetmi automjet në pronësi të tij është ai i blerë në vitin 2012, i cili është ekonomik, familjar e përdoret prej tij edhe aktualisht.

11.2.3. Në vijim të prapësimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit sqaron se konteksti i jetesës së tij është i ndryshëm me atë të referuar në vendimin (JR) nr. 18, datë 26.07.2019, të Kolegjit, i marrë si referencë nga Komisioni, pasi niveli i shpenzimeve të jetesës në masën 66 % të të ardhurave nga pagat ka qenë për një familje me 4 (katër) anëtarë, në Elbasan dhe në një periudhë të ndryshme kohore. Ndërkohë që kosto e jetesës në Gramsh është ndjeshëm më e ulët se në Tiranë apo Elbasan, pasi në këtë qytet disa shërbime nuk ofrohen, niveli i çmimeve të produktit vendas është më i ulët, si dhe çmimi i disa shërbimeve, sipas të dhënave të INSTAT-it, është minimalisht sa $\frac{1}{2}$ në krahasim me çmimet e të njëjtave produkte në Tiranë apo Elbasan. Shpenzimet mesatare mujore të konsumit për frymë për periudhën 2002 – 2012⁵ janë paraqitur në 4 (katër) kategori (*bregdetare, qendrore, malore, Tirana*), sipas së cilit në rajonin malor, ku përfshihet dhe Gramshi, shpenzimet e konsumit mesatar për frymë sipas INSTAT-it janë rreth 20% deri 40% më të ulëta. Në rajonin malor, niveli i shpenzimeve të subjektit nuk mund të merret në masës 66% të të ardhurave nga pagat, por duhet të ulët me të paktën 20% dhe shpenzimet e jetesës për periudhën 1989 – 2000 do të duhet të ishin jo më shumë se 50% të të ardhurave. Në asnjë moment shpenzimet e jetesës së periudhës 1994 – 2001, nuk kalojnë nivelin prej 38% të të ardhurave.

11.2.4. Në vendimin objekt shqyrtimi, lidhur me shpenzimet e jetesës, Komisioni ka bërë këto vlerësime: (i) për periudhën gusht 1989 – dhjetor 1993 nuk ka marrë në konsideratë mundësi kursimi për shkak të pagës së ulët dhe inflacionit të lartë; (ii) për periudhën 1994 – prill 1995, shpenzimet e jetesës në masën 66% të të ardhurave nga paga; (iii) për periudhën prill 1995 – nëntor 1996, aplikon masën prej 38 %, duke mbajtur në konsideratë pagën e subjektit të rivlerësimit, faktorin gjeografik (zonë malore) dhe përbërjen familjare me 1 (një) person; (iv) për periudhën 1996 – 1999 i ka përllogaritur shpenzimet e jetesës në masën 66% të të ardhurave nga pagat; (v) për periudhën 2000 – prill 2002 janë llogaritur shpenzime sipas INSTAT-it për frymë, duke zbritur 20%, duke e konsideruar Gramshin, zonë malore.

11.2.5. Në ankim, subjekti i rivlerësimit kundërshton përdorimin e kriterëve të ndryshme për periudha të ndryshme kohore sa i përket shpenzimeve të jetesës, duke ngritur në mënyrë të përmbledhur këto pretendime: (a) për periudhën 1989 – 1993, pavarësisht se në rezultatin e hetimit Komisioni ka pranuar nivel të shpenzimeve të jetesës në masën 66% të të ardhurave nga pagat, pa iu referuar asnjë fakti, në vendim, Komisioni ka vlerësuar të mos marrë në konsideratë kursime për shkak të pagës së ulët dhe inflacionit të lartë të kësaj periudhe. Me këtë veprim, subjektit i është mohuar e drejta e mbrojtjes për të kundërshtuar faktet dhe argumentet e Komisionit lidhur me nivelin e shpenzimeve, pranuar në vendimin përfundimtar, pasojë kjo e një procesi të parregullt ligjor; (b) shpenzimet jetësore në Gramsh (zonë malore) janë rreth 20% më të ulëta se në rajonin e Elbasanit (qendror) dhe 30 deri 40% më të ulëta se të rajonit Tirana. Me konsideratë faktorin gjeografik dhe përbërjen familjare, shpenzimet e jetesës të subjektit të rivlerësimit për periudhën 1994 – 1999 nuk mund të jenë në asnjë rast më të larta se 38 % e të ardhurave; (c) në kushtet kur, për periudhën 2002 – 2012 shpenzimet e jetesës sipas ILDKPKI-së kanë trend rritës, për vitet 2000 dhe 2001, këto shpenzime nuk mund të jenë më të larta se ato të vitit 2002. Ky konkluzion, sipas subjektit të rivlerësimit përforcohet edhe nga korrigjimi që vetë Komisioni i ka bërë një anomalie të vërejtur në masën e shpenzimeve të jetesës për frymë për vitin 2007, të rezultuar në një shifër shumë më të lartë se ato të viteve 2006 dhe 2008; (ç) niveli i shpenzimeve të jetesës për periudhën 1994 – prill 1995 nuk ka qenë më i lartë se 25% e të ardhurave; (d) për periudhën prill 1995 – nëntor 1996, niveli i shpenzimeve të tij në masën 25% të të ardhurave është tërësisht i bazuar dhe përcaktimi në nivelin 38% është tërësisht i gabuar e arbitrar. Komisioni, në analizën e shpenzimeve të jetesës për këtë periudhë, është shprehur se merr në konsideratë faktorin gjeografik dhe përbërjen

⁵ http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START_LSMS/LSMS02/table/tableViewLayout1/

familjare me një anëtar, por në asnjë pjesë të vendimit nuk analizon sa ndikon secili nga këta faktorë në përcaktimin e nivelit të shpenzimeve; (dh) për periudhën tetor 1997 - dhjetor 1999, shpenzimet e jetesës nuk mund të llogariten me të larta se 30% e të ardhurave. Faktori i vendndodhjes gjeografike do ta ulte nivelin e shpenzimeve të jetesës nga 66 % në 50%, faktori i përbërjes familjare do ta çonte në masën 12.5% të të ardhurave. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni, pavarësisht argumenteve bindëse për pabazueshmërinë e konkluzionit të tij, nuk ka lexuar, analizuar e marrë në shqyrtim këto argumente, duke e bërë vendimin tërësisht të paarsyetuar; (e) për periudhën janar 2000 – prill 2002, shpenzimet e jetesës duhet të përllogariten në masën 40% të të ardhurave.

11.2.5.1. Për periudhën 1989 – 1993, trupi gjykues vlerëson se Komisioni duhet t'i kishte bërë me dije subjektit të rivlerësimit faktin që për vitin 1989 – 1993 nuk do të konsideronte mundësi kursimi, për arsytet e përmendura më pas në vendim. Megjithatë, ky element nuk është i mjaftueshëm për të afektuar ligjshmërinë e procesit të rregullt. Trupi gjykues gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit për të mos aplikuar metodologjinë e përllogaritjes së shpenzimeve të jetesës në masën 66% të të ardhurave nga pagat dhe duke e konsideruar mundësinë e kursimit zero për këtë periudhë, për vetë nivelin e pagave në atë kohë dhe kushtet e jetesës së subjektit të rivlerësimit. Në vitet 1991, 1992 dhe 1993, inflacioni ka qenë 104.1%, 236.6% dhe 30.9%, që dëshmon për çmime tepër të larta në raport me të ardhurat e realizuara nga pagat e kohës. Trupi gjykues sjell në vëmendje se subjekti i rivlerësimit ka jetuar në fshat, në një familje të përbërë nga 9 (nëntë) anëtarë dhe së bashku me ungjin bëheshin 10 anëtarë, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit ishte djali i madh i kësaj familje dhe, për rrjedhojë, financues kryesor i ekonomisë së përbashkët familjare. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e mësuesit në rrethin e Gramshit, gjatë periudhës objekt analize 1989 – 1993, duke përfituar pagë të ulët krahasuar me atë të hetuesit apo gjyqtarit realizuar prej muajit janar 1994 e në vazhdim.

11.2.5.2. Për periudhën janar 1994 – prill 1995, trupi gjykues vlerëson se subjektit të rivlerësimit nuk mund t'i konsiderohen shpenzimet e jetesës në masën 25% të të ardhurave nga pagat, ashtu sikundër pretendon. Mundësia për kursim në masën 34% e përllogaritur nga Komisioni për periudhën janar 1994 – prill 1995, mund të konsiderohet një skenar optimist, duke parë me objektivitet rrethanat e faktit të subjektit të rivlerësimit për këtë periudhë, në kushtet kur të ardhurat e subjektit kanë qenë burim potencial për përballimin e jetesës, në kushtet e një familje me shumë anëtarë, kur vëllezërit e tjerë ishin më të vegjël.

11.2.5.3. Për periudhën maj 1995 – nëntor 1996, trupi gjykues vlerëson të gabuar metodologjinë e Komisionit për të përllogaritur shpenzimet e jetesës në masën 38 % të të ardhurave nga pagat, me konsideratë faktorin gjeografik (zonë malore) dhe përbërjen familjare me 1 (një) anëtar, pasi ky qëndrim nuk referon në jurisprudencën ekzistuese të Kolegjit. Me referencë normat në rritje të inflacionit për periudhën 1995-1998, nuk mund të aplikohet kursim në masën 75% të të ardhurave, në kushtet e një trendi në rritje të inflacionit [8% në vitin 1995 rritur në 12.8% në vitin 1996, në 32.9% në vitin 1997 dhe në 21.6% në vitin 1998] dhe çmimet në rritje për pasojë. Subjekti i rivlerësimit nuk ka konsideruar efektin e faktorëve makroekonomikë në përcaktimin e çmimit të mallrave të konsumit të shportës e, për këtë arsye, pretendimet e tij, për të përllogaritur shpenzimet e jetesës për këtë periudhë në masën 25% të të ardhurave nga pagat, nuk qëndrojnë.

11.2.5.4. Nga analizimi i pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në ankim, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka keqinterpretuar aplikimin e masës 66 % të të ardhurave nga pagat për përllogaritjen e shpenzimeve të jetesës për periudhën deri më 31.12.1999. Sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, 66 % e të ardhurave nga pagat i përket shpenzimeve të jetesës për një familje me 4 (katër) anëtarë, duke e gjetur kështu të gabuar zbatimin ndaj tij të kësaj metodologjie përcaktuar në vendimin (JR) nr. 18, datë 26.07.2019, të Kolegjit. Për

shkak të këtij keqinterpretimi, subjekti i rivlerësimit paraqet argumente duke bërë krahasimin e të ardhurave të tij me të punonjësve të tjerë në administratën shtetërore e Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gramsh, duke pretenduar se me këtë përqindje të përlllogaritjes së shpenzimeve, një punonjës tjetër, me të ardhurat e tij do të ishte në kushtet e mbijetesës, ndërsa të tjerët nuk do të mund të siguronin jetesën me pagën që përfitonin. Duket se subjekti i rivlerësimit nuk e ka të qartë se sipas kësaj metodologjie, shpenzimet e jetesës përlllogariten në masën 66 % të të ardhurave nga pagat e realizuara nga anëtarët e familjes për periudhën e analizuar. Kjo përlllogaritje akordon me konsumin jetik për njësi familjare të çdo subjekti të rivlerësuar në raport proporcional me sasinë e të ardhurës përkatëse përfituar prej njësisë familjare pa u afektuar nga numri i anëtarëve të saj. Trupi gjykues arsyeton se subjekti i vlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit për shkak të funksionit që ushtron dhe ndaj tij është aplikuar e njëjta metodologji për përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës për periudhën përpara vitit 2000, sikurse edhe për subjekte të tjerë të rivlerësimit, bazuar në të njëjtën referencë për shkak të të dhënave të limituara nga burime zyrtare për periudhën respektive, si dhe për shkak të pamundësisë për të hetuar analitikisht çdo pretendim subjektiv lidhur me mënyrën e jetesës, tendencën për kursim e të tjera të ngjashme.

11.2.5.5. Duke sjellë në vëmendje praktika të ndjekura nga Komisioni dhe Kolegji, mbi përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës për periudhën deri në vitin 2000, në nivel më të ulët se për subjektin Ramazan Avdiu, në parashtrimet e depozituara më datë 30.05.2023, në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ngre pretendimin se kështu Komisioni i ka cenuar parimin e barazisë para ligjit. Në argument të këtij pretendimi, subjekti i referohet jurisprudencës⁶ së Kolegjit, për përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës në masën 30% të të ardhurave për periudhën para e deri më 31.12.1999. Mbështetur në arsyetimin e bërë në paragrafët 21.41 dhe 21.42 të vendimit (JR) nr. 15, datë 18.06.2021, të Kolegjit, subjekti i rivlerësimit referon, gjithashtu, të dhënat e raportit vjetor të Bankës së Shqipërisë 1995 dhe 1996, lidhur me të ardhurat mesatare në sektorin publik, shpenzimet e jetesës dhe kursimet e mundshme gjatë periudhës 1992 – 1996. Në paragrafët e sipërcituar, në përfundim të një analizimi logjik të të dhënave zyrtare, Kolegji shprehet se në kushtet kur pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve janë në raport 30% më të larta se ato të funksionarëve të tjerë të sektorit publik, shpenzimet e jetesës duhet të llogariten në masën 30% të të ardhura që përaftron me masën 66% të të ardhurave të pagave mesatare të të gjithë sistemit të pagave që arrijnë përafërsisht vlerën rreth 800 USD në vit. Nisur nga ky arsyetim, subjekti i rivlerësimit ngre pretendimin se nëse do të trajtohej me këto kushte do të rezultonte me mundësi financiare për blerjen e apartamentit dhe dhënien e huas.

11.2.5.6. Trupi gjykues sjell në vëmendje se ai shqyrton çështjet e juridiksionit të rivlerësimit që i adresohen nëpërmjet ankimit të vendimit të Komisionit, duke analizuar shkaqet e ankimit, sipas qëndrimit të mbajtur në jurisprudencën e tij dhe në vlerësim të fakteve, rrethanave konkrete dhe specifike të secilës çështje. Metodologjia e përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës aplikuar në Kolegj është bazuar në të dhënat zyrtare të INSTAT-it, të derivuara nga metodologji statistikore. Të dhënat e INSTAT-it për vitet 2002 e në vijim janë rezultat i të dhënave statistikore të rezultuara nga anketimi i një *kampioni* familjesh nga të gjitha rrethet e vendit, përfshirë të 12 qarqet e Shqipërisë, ndarë në zona urbane e rurale, kundrejt katër rajoneve gjeografike *Qendror, Bregdetar, Malor dhe Tiranën [si metropol]*. Pra në thelb, ndryshimet gjeografike janë konsideruar në të dhënat e konkluduara nga INSTAT të cilave u referohet Kolegji. Për arsyet e mësipërme, ulja me 20 % e shpenzimeve të jetesës për periudhën 2000 – prill 2002 për shkak të pozicionit malor të qytetit të Gramshit, aplikuar nga Komisioni në përlllogaritjet e tij, nuk u gjet i drejtë nga ana e Kolegjit, pasi do të përlligjte më pas pretendimin e subjektit të rivlerësimit përse nuk është aplikuar kjo ulje në vitet në vijim se

⁶ Shih vendimin nr. 14, datë 15.06.2021, paragrafi 49, që i përket subjektit të rivlerësimit Irma Balli dhe vendimin nr. 15, datë 18.06.2021, paragrafi 21.41, që i përket subjektit të rivlerësimit Kastriot Selita..

qyteti i Gramshit ka qenë malor për të gjithë periudhën dhe jo vetëm në këto vite, si dhe do të binte ndesh me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit. Trupi gjykues ka vlerësuar të aplikojë kursime në masën 34 % të të ardhurave nga pagat, duke përllogaritur kështu shpenzimet e jetesës për periudhën 1994 – 1999, në përputhje me metodologjinë e aprovuar në Kolegji. Edhe nëse shpenzimet e jetesës përllogariten në masën 30% të të ardhurave nga paga, për këtë periudhë, subjekti i rivlerësimit do të rezultonte me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, si për blerjen e apartamentit në nëntor 1996, ashtu edhe për dhënien e huas në maj 2002. Rezultatet e kësaj analize trajtohen analitikisht, në paragrafët 20.8 dhe 23.5 të këtij vendimi.

11.2.5.7. Pretendimin e ngritur nga subjekti i rivlerësimit se Komisioni ka vepruar në kundërshtim me nenin 45, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka bërë hetim lidhur me shpenzimet e jetesës, trupi gjykues e gjen të pabazuar në kushtet kur barra e provës për këtë çështje i përket subjektit të rivlerësimit. Në pamundësi për të hartuar një metodologji të personalizuar, ndodhur në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk provon me dokumentacion shpenzimet e jetesës në masën e pretenduar, trupi gjykues çmon se ky pretendim nuk qëndron.

11.3. Lidhur me pretendimin se Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove mbi kthimin e shumës 3.641 USD në vitin 2007, por vetëm sqarime mbi mospërputhjet e evidentuara, trupi gjykues, nga analizimi i rezultateve të hetimit administrativ, konstaton se Komisioni është shprehur: *11.6. Në analizën financiare nuk është marrë në konsideratë ky si burim për krijimin e vlerës së cash-it në banesë në vitin 2007 (3.641 USD) dhe në vijim në vitet pasardhëse. 11.7. Ka mospërputhje midis deklarimit të subjektit në DIPV-në e vitit 2007 me rezultatin e hetimit të llogarive bankare lidhur me gjendjen cash të mbajtur në banesë, ndërkohë në vijim i kërkon subjektit të provojë mospërputhjet në deklarime dhe të kundërtën e rezultatit të hetimit për këtë pasuri. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit, jo vetëm për të sqaruar mospërputhjet në deklarim, por edhe për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit administrativ se në të nuk përfshihet shuma 3.641 USD. Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se arsyetimi i Komisionit në vendim kapërcen atë çka është kërkuar në hetim, duke i cenuar të drejtën e mbrojtjes, është i pabazuar.*

11.4. Për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, subjekti i rivlerësimit pretendon se neni 33 i ligjit nr. 84/2016 përcakton detyrat e ILDKPKI-së në procesin e rivlerësimit kalimtar dhe nuk ka lidhje me detyrat e Komisionit në vendimmarrjen e tij. Trupi gjykues vlerëson se dispozitat e ligjit nr. 84/2016 duhen interpretuar në harmoni me njëra-tjetrën. Kolegji tashmë në jurisprudencën e tij ka zbatuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë, në ato raste kur subjekti është ndodhur në një ose disa nga situatat e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b”, “c”, “ç” apo “d” të këtij ligji.

11.5. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ndodhet në kushtet e asnjë prej rasteve të parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës: (i) kur ka deklaruar më shumë se dyfishin e pasurisë së ligjshme; ose (ii) kur përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë, që ndaj tij të jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, për kriterin e pasurisë.

11.5.1. Në përgjigje të këtij pretendimi, trupi gjykues konstaton që Komisioni në vendimin objekt shqyrtimi, të jetë shprehur: (i) për huan dhënë z. D. X. në vitin 2004, *12.9. [...] krijohet bindja se subjekti i rivlerësimit ka dashur të fshehë veprimet e kryera [...], duke i përjashtuar ato nga hetimi dhe verifikimi që kryen ILDKPKI-ja, por edhe Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, [...];* si dhe (ii) për shumën 3.641 në vitin 2007, *14.6. [...] Komisioni nuk e ka marrë në konsideratë në analizën financiare të vitit 2007 këtë shumë si burim për krijimin e gjendjes cash, duke e konsideruar deklarimin e subjektit të rremë.* Në këto kushte, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë është i pabazuar. Nga ana tjetër, Kolegji, tashmë në jurisprudencën e tij, ka konsoliduar

qëndrimin lidhur me aplikimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, të cilin e shoqëron njëkohësisht me zbatimin e nenit 61 pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016. Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

11.6. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se parashikimi i pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, kërkon plotësimin e njëkohshëm të dy kushteve, deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe masa e shkarkimit nga detyra për të në zbatim të kësaj dispozite është në kundërshtim me këtë ligj, pasi subjektit të rivlerësimit nuk i është kryer kontrolli i figurës, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e konsoliduar në jurisprudencën⁷ e Kolegjit. Në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, vlerësimi i kriterit të pasurisë dhe pastërtisë së figurës, respektivisht, mund të çojë në mënyrë të pavarur në pasojat e parashikuara nga kjo dispozitë, nëse deklarimi i subjektit për kriterin objekt shqyrtimi, vlerësohet i pamjaftueshëm.

12. Me ankimin e depozituar në Kolegj, subjekti i rivlerësimit kërkon administrimin në cilësinë e provës të akteve shkresore si vijon:

12.1. Shkresë nr. {***} prot., datë 16.06.2021, e Bashkisë Gramsh, sipas së cilës rruga automobilistike që lidh fshatin Trashovicë me qytetin e Gramshit ka përfunduar më 30.11.2016. Në këtë fshat nuk ka pasur linjë të transportit publik para datës 01.03.2019, lëvizja e banorëve është bërë nëpërmjet urës së vjetër me lëndë drusore, e cila lejonte vetëm kalimin e njerëzve. Distanca nga qendra e fshatit Trashovicë deri në qendër të qytetit të Gramshit është 1976 metra, distanca për të mbërritur në kohë llogaritet, në këmbë 24 minuta, me automjet 5 minuta.

12.2. Shkresë nr. {***} prot., datë 16.06.2021, e Bankës së Shqipërisë, nëpërmjet të cilës vihet në dispozicion informacioni statistikor mbi normën mesatare të interesit të depozitave 12-mujore në lekë, për periudhën 2002 – 2016.

12.3. Akt ekspertimi, i përgatitur nga eksperti kontabël A. Q. (NIPT: {***}), për përlllogaritjen e normës së interesit në përqindje për huat e dhëna në vitet 2002, 2004, 2011, 2013, 2015, si dhe diferencën me normën mesatare të interesave të publikuara nga Banka e Shqipërisë apo normën e interesave të bonove të thesarit.

12.4. Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.06.2021, e z. N. A. dhe z. A. A., lidhur me shumën 3.641 USD në vitin 2007.

12.5. Relacion vlerësimi shtesë, datë 21.06.2021, përgatitur nga inxhinier F. S.⁸ (NIPT: {***}), për shtesën anësore në apartamentin e ndodhur në lagjen “{***}”, Gramsh.

13. Në këndvështrimin e dispozitës ligjore që normon pranimin e provave të reja në gjykimin administrativ të apelit, konkretisht nenit 47⁹ të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar se pa fajin e tij nuk ka mundur të paraqesë këto akte shkresore gjatë hetimit administrativ në Komision e, për këtë arsye, ato nuk plotësojnë kërkesat e këtij neni. Nga analizimi i vlerës provuese të këtyre akteve dhe peshën e tyre në vendimmarrjen e Kolegjit, në harmoni me parashikimet e nenit 49, pika 6, geramat “a” dhe “b” e ligjit nr. 84/2016, se *kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i*

⁷ Shih vendimin nr. 33, datë 29.07.2022, paragrafi 19 etj.

⁸ Licencë, Nr. Regj. {***} për vlerësim në fushën “Ndërtesa dhe tokë truall”, Licencë {***}, në projektim, Licencë {***} “Për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi”.

⁹ Neni 47, i ligjit nr. 49/2012, parashikon: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

*Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: (a) marrja e provës duket se është e panevojshme; (b) fakti që kërkohet të provohet, është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit, trupi gjykues i vlerëson të panevojshme dhe të parëndësishme në raport me faktet që subjekti synon të provojë për zgjidhjen në themel të çështjes nga Kolegji. Nga analizimi i këtyre akteve, trupi gjykues konstaton se: (1) informacioni, në shkresën nr. {***} prot., datë 16.06.2021, të Bashkisë Gramsh, nuk ka rëndësi për vendimmarrjen, pasi Komisioni për periudhën 1989 – 1996, nuk ka përllogaritur në zërin “shpenzime”, shpenzime udhëtimi nga fshati Trashovicë për në Gramsh dhe anasjelltas; (2) shkresë nr. {***} prot., datë 16.06.2021, e Bankës së Shqipërisë, mbi normën mesatare të interesit të depozitave 12-mujore në lekë, për periudhën 2002 - 2016 dhe akti i ekspertimit për përllogaritjen e shumës së interesit përfituar nga subjekti i rivlerësimit për huat e dhëna në vitet 2002, 2004, 2011, 2013 dhe 2015, janë të panevojshme, pasi konkluzioni mbi diferencën mes interesave bankarë dhe atyre të parashikuara në kontratat e huave të nënshkruara nga subjekti i rivlerësimit është i aksesueshëm nga burimet e hapura online, si dhe ekstraktohet nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore; (3) relacioni i vlerësimit shtesë, datë 21.06.2021, për shtesën anësore, është i parëndësishëm për vendimmarrjen, si arsyetuar në paragrafin 28.9 të këtij vendimi; ndërsa (4) deklarata noteriale e vëllezërve të subjektit, B. (N.) dhe A. A., mbështet argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe deklarimet në deklaratën noteriale, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.04.2021, të z. A. A. të depozituara me prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ në Komision.*

14. Pas njoftimit për caktimin e seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, që do të zhvillohej në Kolegj më datë 06.06.2023, subjekti i rivlerësimit paraqiti më datë 30.05.2023, kërkesë “Për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore”. Në procesin e rivlerësimit kalimtar ndaj tij, subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar se plotësohen të tria kërkesat e nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike. Përveç akteve shkresore të depozituara me ankimin, për të cilat subjekti i rivlerësimit ngre pretendimin se nuk ishin depozituar në Komision, pasi nuk i ishte kaluar barra e provës, duke e vendosur atë në pamundësi objektive pa faj të tij, subjekti ka kërkuar nga Kolegji administrimin në cilësinë e provës edhe të disa akteve të tjera shkresore, me qëllim konstatimin e plotë dhe të saktë të gjendjes faktike për zgjidhjen e drejtë të çështjes. Arsye tjetër, sipas subjektit, është procesi i parregullt ligjor, me shkelje të rënda procedurale, si pasojë e cenimit të së drejtës së mbrojtjes efektive.
15. Më konkretisht, së bashku me parashtrimet me shkrim lidhur me shkaqet e ankimit përcjellë në Kolegj, më datë 30.05.2023, bazuar në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012¹⁰, subjekti i rivlerësimit depoziton edhe një sërë aktesh të tjera¹¹ shkresore. Trupi gjykues vlerëson se dispozita e përmendur nga subjekti i rivlerësimit nuk e legjitimon paraqitjen e provave të reja në këtë fazë të shqyrtimit të çështjes. Për më tepër që informacioni në përmbajtje të këtyre akteve, jo vetëm gjendet nga burime të hapura, por në të njëjtën kohë konsiderohet pa rëndësi në procesin vendimmarrës së Kolegjit.

¹⁰ Neni 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, parashikon: “[...] Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim [...]”.

¹¹ (i) Komentari mbi reformën kushtetuese në sistemin e drejtësisë (2016) botuar nga Instituti për Studime Publike & Ligjore, mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë; (ii) artikulli i gazetës “Shqiptarja.com” me titull “Fajdexhinjtë e drejtësisë/gjyqtarët dhe prokurorët që dhanë para hua me interes [...]”; (iii) ligji nr. 04/L-077 “Për marrëdhëniet e detyrimeve” i Republikës së Kosovës; (iv) lista me 775 emrat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të cilëve do t’u verifikohen pasuritë, publikuar nga Gazeta Standard online; (v) material “Karakteristika të përgjithshme të ekonomisë”: (1) inflacioni dhe çmimet; (2) zhvillimi i ekonomisë kombëtare, punësimi; (vi) material online mbi “Kuptimin e Fajdes”; (vii) raporti vjetor 1996 i Bankës së Shqipërisë.

16. Përveç shkaqeve me natyrë procedurale që subjekti i rivlerësimit ka ngritur në ankim, me parashtrimet në Kolegj, ai paraqet shkaqe të tjera të kësaj natyre, që sipas tij tregojnë që Komisioni ka qenë i njëanshëm, paragjykses, vendimi ka qenë i paracaktuar dhe është cenuar procesi i rregullt ligjor parashikuar në nenin 6 të KEDNj-së, nenin 179/b, pika 2 e Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Ky fakt, sipas subjektit, evidentohet qartë në: (i) qëndrimin në seancën dëgjimore të kryesuesit të trupit gjykues në Komision, lidhur me dhënien e huave me interes, seancë të cilën e konsideron një formalitet të detyrueshëm ligjor për t'u përmbushur dhe jo për realizimin e qëllimit të saj, sqarimin e rrethanave të çështjes dhe analizimin e provave të paraqitura, duke cenuar procesin e rregullt ligjor; (ii) në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni nuk ka dhënë asnjë arsye se përse nuk ka marrë në konsideratë raportin e vlerësimit të ekspertit F. S., duke i hequr kështu mundësinë e mbrojtjes. Ky raport sipas subjektit nuk është lexuar, pasi në të sqarohet qartë se mbi ç'bazë janë bërë llogaritjet; (iii) hetimi administrativ nuk është filluar për të tria kriteret e rivlerësimit dhe ndryshe nga subjektet e tjerë nuk janë administruar raportet e përgatitura nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, por vetëm raporti i ILDKPKI-së. Kjo situatë faktike, sipas subjektit, provon paragjykim dhe paracaktim të procesit; (iv) me rezultatet e hetimit nuk i janë vënë në dijeni pasojat ligjore lidhur me dhënien e huave dhe se këto veprime përbëjnë cenim të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, duke shkelur parimin e kontradiktoritetit dhe mbrojtjes efektive; (v) Komisioni ka përdorur standarde të shumëfishta për provueshmërinë e fakteve dhe vlerësimin e fuqisë provuese të provave lidhur me përcaktimin e shpenzimeve për jetesë, për deklarimin e transaksioneve të kryera brenda vitit me efekt zero, saktësinë e deklarimeve për kohën dhe koston e ndërtimeve informale, duke shkelur parimin e barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit.

16.1. Lidhur me qëndrimin e kryesuesit gjatë seancës dëgjimore në Komision, nga analizimi i procesverbalit të seancave dëgjimore të datës 15.04.2021 dhe 30.04.2021, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit në parashtrimet e tij ka sjellë në vëmendje të trupit gjykues të Komisionit elementë që nuk kishin lidhje me procesin e vlerësimit të kriterit të pasurisë për të cilin ishte kryer hetimi administrativ apo çështje/pasuri për të cilat nuk i kishte kaluar barra e provës. Kryesuesi i trupit gjykues në Komision, në kuadër të efikasitetit të procesit dhe ekonomisë gjyqësore i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore në mënyrë të përsëritur, të jetë sa më konciz në parashtrimet e tij, duke i përmbledhur ato dhe duke u fokusuar në thelbin e çështjes dhe në disa raste madje i ka sjellë në vëmendje rënien në përsëritje. Trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se kryesuesi është shprehur se dhënia e huave me interes nuk ka ndikim në vlerësimin e kriterit pasuror, ndërkohë që ka shërbyer si një nga shkaqet e rëndësishme për shkarkimin e tij nga detyra. Referuar procesverbalit të seancës dëgjimore, qëndrimi i kryesuesit shprehur në fjalinë “[...] nuk na duhen normat e interesit, nuk kanë lidhje fare me procesin [...]”¹² është interpretuar i shkëputur nga konteksti duke i dhënë një kuptim të pasaktë, pasi në vijim kryesuesi shprehur se për huanë dhënë z. H. B. me interes bankar mjaftojnë sqarimi i dhënë për huadhëniet e tjera, për të mos rënë në përsëritje. Trupi gjykues, konstaton se parashtrimet e subjektit të rivlerësimit kanë qenë tejet të detajuara, përtej kufirit të asaj që kërkon të provohet. Kërkesa e kryesuesit për të ekonomizuar kohën gjyqësore dhe orientimi për të qenë më konciz është diçka që ndodh në praktikën gjyqësore dhe në rastin konkret nuk konsiderohet cenim i parimeve të procesit të rregullt ligjor.

16.2. Subjekti i rivlerësimit ngre pretendimin se Komisioni në rezultatet e hetimit nuk ka dhënë asnjë arsye se përse nuk ka marrë në konsideratë raportin e vlerësimit të ekspertit F. S., duke i hequr mundësinë e mbrojtjes subjektit të rivlerësimit. Ky raport, sipas subjektit, nuk është lexuar nga Komisioni, pasi në të sqarohet qartë se mbi ç'bazë janë bërë llogaritjet. Trupi

¹² Shih faqen 1509 të procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 30.04.2021.

gjykues konstaton se *relacion për shtesën e apartamentit të z. Ramazan Avdiu, në Gramsh, datë 23.03.2020, përgatitur nga inxhinier F. S.*¹³ është depozituar nga subjekti i rivlerësimit me përgjigjet e pyetësorit të datës 02.03.2020. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni është shprehur se *për vlerën e shpenzimeve të kryera për ndërtimin e objektit informal, subjekti ka paraqitur një preventiv të ndërtesës, të kryer në datën 23.03.2020 nga një inxhinier ndërtimi, i licencuar si vlerësues pasurish të paluajtshme. Në relacionin e vlerësuesit të përgatitur në vitin 2020, vlera e shtesës është nxjerrë në shumën 835.523 lekë. Në relacionin e tij, vlerësuesi shpjegon se zërat dhe volume e punës të kryer janë llogaritur sipas sqarimeve dhe shpjegimeve të vetë subjektit të rivlerësimit, pasi në momentin e vlerësimit shtesa ka përfunduar. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit, pasi Komisioni është shprehur qartë përse nuk i është referuar vlerës së ndërtimit të shtesës anësore, sipas përcaktimit të ekspertit vlerësues.*

16.3. Pretendimin se Komisioni ka qenë paragjykues në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Ramazan Avdiu, pasi hetimi administrativ ndaj tij nuk është filluar për të tria kriteret e rivlerësimit dhe ndryshe nga subjektet e tjerë për të nuk janë administruar raportet e përgatitura nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, por vetëm ai i ILDKPKI-së, trupi gjykues e gjen të pabazuar. Administrimi i raporteve të organeve ndihmëse të këtij procesi (ILDKPKI, DSIK dhe KLGj), nuk kryhet me kërkesë të Komisionit, pasi dispozitat ligjore, konkretisht, neni 39, pika 2 dhe neni 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashikojnë se janë pikërisht këto organe ndihmëse, të cilat, pasi hartojnë raportet përkatës, ia përcjellin Komisionit. Pavarësisht se në rezultatet e hetimit administrativ apo në vendim nuk përmendet administrimi i raporteve që i përkasin kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, kjo nuk tregon që këto raporte nuk janë administruar në Komision. Nga analizimi i procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 15.04.2021, rezulton që relatorja e çështjes është shprehur se [...] *janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga institucionet e vlerësimit, si dhe bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Në përfundim, Komisioni ka përgatitur një raport për subjektin e rivlerësimit mbështetur vetëm në një kriter të vlerësimit, atë të pasurisë, duke vlerësuar se deri në këtë moment provat kanë nivelin e provueshmërisë.* Nga ana tjetër, në kushtet kur vendimi i Komisionit është marrë mbi bazën e një kriteri të vetëm, në Kolegj si rregull përcillet vetëm dokumentacioni i administruar në kuadër të këtij kriteri pa përfshirë raportet e organeve ndihmëse për dy kriteret e tjera të pahetuara. Trupi gjykues vlerëson se mospërcjellja në Kolegj e këtyre raporteve nuk cenon procesin e rregullt ligjor ndaj subjektit të rivlerësimit.

16.4. Lidhur me pretendimin se me rezultatet e hetimit nuk i janë vënë në dijeni pasojat ligjore lidhur me dhënien e huave dhe se këto veprime përbëjnë cenim të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, duke shkelur parimin e kontradiktoritetit dhe mbrojtjes efektive, trupi gjykues vëren se në rezultatet e hetimit, Komisioni është shprehur se [...] *lidhur me huadhëniet me interes të kryera nga ju ndër vite në shumë të konsiderueshme, ju duhet të shpjegoni për Komisionin a është ajo në harmoni me dispozitat kushtetuese e a bie ndesh ky veprim me figurën e gjyqtarit në Republikën e Shqipërisë.* Nëse Komisioni do të kishte përcaktuar që me rezultatet e hetimit administrativ, referencën ligjore apo pasojën, ky fakt do të përbënte paragjykim të çështjes nga ana e tij, që në kuptim të nenit 55, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i zhvillon bisedimet për marrjen e vendimit pas seancës dëgjimore, pasi ka dëgjuar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe provat që ai mund të depozitojë edhe gjatë seancës. Pavarësisht se trupi gjykues i Kolegjit, për rastin konkret, nga shqyrtimi i çështjes mund të arrijë në një

¹³ Licencuar me nr. {***}, datë 15.07.2008, si vlerësues i pasurive të paluajtshme të llojit truall e ndërtesë.

përfundim të ndryshëm nga Komisioni, sa i përket cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, përsëri vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit.

16.5. Sa i përket pretendimit të subjektit mbi standardet e shumëfishta të Komisionit duke shkelur parimin e barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, trupi gjykues sjell në vëmendje se në pamundësi për të analizuar qëndrimin e Komisionit në rastet e cituara nga subjekti i rivlerësimit në parashtrime, pasi nuk disponon dokumentacionin përkatës të tyre, garanton se në kushtet kur çështja objekt gjykimi që i përket subjektit të rivlerësimit Ramazan Avdiu do t'i nënshtrohet shqyrtimit në Kolegj, shkaqet ankimore të ngritura do të analizohen në koherencë me jurisprudencën e Kolegjit, vlerësuar nën dritën e rrethanave konkrete dhe provave të administruara për çështjen.

17. Për sa arsyetuar më sipër, në kushtet kur nuk janë evidentuar shkelje të rënda procedurale dhe aktet shkrese të paraqitura me ankimin dhe parashtrimet në Kolegj nuk plotësojnë kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, për marrjen e tyre në cilësinë e provave të reja, trupi gjykues vlerëson se nuk gjejnë zbatim parashikimet e nenit 51, pika 1 të këtij ligji, për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike dhe vendosi shqyrtimin e saj në dhomë këshillimi, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë

B/1. Për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 52,8 m², në Gramsh

18. Për këtë pasuri, Komisioni ka vlerësuar se është blerë gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës si gjyqtar dhe subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare për blerjen e pasurisë në nëntor të vitit 1996, në shumën (-) 130.251 lekë.
19. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, duke pretenduar se: (i) ka provuar pamundësinë objektive për të vërtetuar marrjen e kredisë për blerjen e minitraktorit dhe kthimin e saj, pasi afati i ruajtjes së dokumentacionit në sistemin bankar e në arkivë është 10 vjet, ndërkohë që kredia është marrë përpara 27 vitesh dhe është shlyer deri në vitin 1998; (ii) Komisioni në vendim nuk shprehet për vërtetësinë dhe fuqinë provuese të deklaratës noteriale të blerësit të minitraktorit z. B. S. dhe nga ana tjetër nuk pranoi thirrjen e tij dhe të personave të tjerë si dëshmitarë. Citimi i dispozitës neni 49, pika 6, germa "b", që në fakt duhet të ishte germa "a", për refuzimin e thirrjes si dëshmitar nuk përbën arsyetim; (iii) përfundimi i Komisionit se për blerjen e apartamentit subjekti ka bërë deklaratime të ndryshme gjatë deklaratimeve periodike, deklaratës së pasurisë *vetting* dhe atyre të dhëna me prapësimet pas rezultateve të hetimit, është i pavërtetë dhe pa evidentuar dhe argumentuar deklaratimet apo shpjegimet e ndryshme; (iv) pamundësia financiare, për blerjen e apartamentit në shumën (-) 130.251 lekë e konstatuar, është tërësisht e padrejtë, bazuar në llogaritjen e gabuar të shpenzimeve të jetesës, si edhe mos marrjen në konsideratë të shumës 100.000 lekë nga shitja e minitraktorit, ndërkohë që subjekti rezulton me tepriçë pozitive 107.373 lekë.
20. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues konstaton si vijon.
- 20.1. Pasuria apartament me sipërfaqe 52,8 m², e ndodhur në qytetin e Gramshit, sipas informacionit¹⁴ të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, Zyra Vendore Gramsh, rezulton të jetë e regjistruar në pronësi të z. Ramazan Avdiu, e përfituar me kontratë shitblerje, datë 09.11.1996, nga shitësit Y. dhe A. B., në vlerën 420.000 lekë.

¹⁴ Përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 25.01.2021.

20.2. Kjo pasuri, sipas deklaramit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, është krijuar me burim të ardhurat e subjektit të siguruara më parë nga paga dhe pjesërisht nga një hua e marrë në atë kohë. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se në janar 1994 është marrë një kredi në ish-Bankën Bujqësore Shqiptare¹⁵ për blerjen e një mjeti bujqësor (minitraktor-zetor) për nevojat e familjes në fshat, mjet që në vitin 1996 i është shitur z. B. S., banues në fshatin Trashovicë. Nga çmimi, subjekti deklaroi se mbajti pjesën e pashlyer të kredisë, që e përdori për blerjen e banesës. Kreditë më pas e ka shlyer deri në fund të vitit 1997 ose fillim të vitit 1998, me të ardhurat nga paga. Kredia ka qenë rreth 400.000 lekë (4.000 dollarë amerikanë) dhe për blerjen e apartamentit ka përdorur ¼ e saj, rreth 100.000 lekë. Këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar dhe në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie, dorëzuar më 28.06.2004, të krijuar me burim të ardhurat e siguruara nga paga dhe me huamarrje të shlyer më pas. *Banesa është blerë në tetor 1996 dhe huat e marra për këtë blerje janë shlyer deri në vitin 1998.*

20.3. Kërkesës së Komisionit për të paraqitur dokumentacion ligjor në lidhje me blerjen dhe shitjen e minitraktorit, të ardhurat e të cilët kanë shërbyer pjesërisht si burim për blerjen e apartamentit, me përgjigjet e pyetësorit të dytë (02.03.2020), subjekti i rivlerësimit shpjegoi se në dhjetor 1993 apo janar 1994 ka marrë një kredi prej 400.000 lekësh (4.000 dollarë), në ish-Bankën Bujqësore, dega Gramsh, për blerjen e një mjeti bujqësor për nevojat e familjes në fshat. Kredia u mor prej tij, por shlyej nga vëllezërit, të cilët merreshin me aktivitet bujqësor. Mjeti është shitur në vitin 1996 dhe nga çmimi subjekti mbajti pjesën e pashlyer të kredisë, ndërsa pjesën tjetër ua dha vëllezërve. Pjesa e mbajtur prej tij u përdor për blerjen e banesës, ndërsa kredia u shlye me të ardhurat nga paga e tij deri në fund të vitit 1997 ose në vitin 1998. Subjekti i rivlerësimit sqaroi se nuk disponon asnjë dokument për marrjen e kredisë apo shitjen e minitraktorit z. B. S.. Pasi u është drejtuar me kërkesë institucioneve, që sipas tij mund të dispononin dokumentet e ish-Bankës Tregtare Agrare lidhur me kreditë e dhëna, me përgjigjet e këtij pyetësi, subjekti i rivlerësimit depozitoi: (a) shkresën nr. {***} prot., datë 29.01.2020, të Bankës Kombëtare Tregtare ShA, që informon se për shkak të kohës dokumentacioni është dorëzuar pranë Arkivit Qendror Shtetëror ose është asgjësuar; (b) shkresën {***} prot., datë 03.02.2020, të Raiffeisen Bank ShA, që informon se nuk disponon dosje të kredive të ish-Bankës Tregtare Agrare dhe orienton për t'u drejtuar pranë Agjencisë së Trajtimit të Kredive; (c) shkresën {***} prot., datë 22.01.2020, të Agjencisë së Trajtimit të Kredive që informon se objekti i saj është trajtimi i kredive të transferuara nga bankat e nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror. Emri i subjektit të rivlerësimit nuk ndodhet në listën e debitorëve të transferuar nga këto banka, për pasojë edhe dosja për kreditë e marrë në ish-Bankën Bujqësore të rrethit Gramsh nuk ndodhet pranë kësaj agjencie. Ndërsa me përgjigjet e datës 29.12.2020, subjekti i rivlerësimit depozitoi kërkesat e tij drejtuar Drejtorisë së Arkivës Shtetërore, si dhe përgjigjen e Drejtorisë së Arkivave Shtetërore Vendore, me shkresën nr. {***} prot., datë 21.10.2020, se Banka Bujqësore e Shtetit Shqiptar nuk ka dorëzuar dokumente pranë këtij institucioni.

20.4. Për të provuar shitjen e minitraktorit, gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit depozitoi deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.02.2020, të blerësit të këtij mjeti bujqësor, z. B. S., i cili deklaroi se në fund të vitit 1995 ose në fillim të vitit 1996, ka blerë nga z. Ramazan Avdiu mjet bujqësor, minitraktor në shumën 200.000 lekë, të cilin, pasi e ka mbajtur jo më shumë se një vit, e ka shitur. Në dijeninë e deklaruesit, z. S., mjeti ka qenë blerë me kredi, por që ai nuk kishte dijeni për vlerën e saj, dhe se shitja e minitraktorit nuk është bërë me dokument. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit i kërkon Komisionit, që nëse kjo deklaratë noteriale nuk

¹⁵ Emërtimi zyrtar i bankës ka qenë "Banka Tregtare Agrare" krijuar në fund të vitit 1993.

do të ishte bindëse për të, rikërkonte të pyeteshin në cilësinë e dëshmitarit, z. B. S., vëllezërit e subjektit të rivlerësimit z. P. A. dhe z. B. A., si dhe banorë të tjerë të fshatit Trashovicë z. H. (M.) Ç. dhe z. V. (V.) S., kërkesë e papranuar nga Komisioni, i cili edhe më herët, me vendimin e datës 13.04.2021 të tij, e kishte konsideruar të panevojshme për procesin.

20.5. Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit ka bërë përpjekje për të mundësuar dokumentacion në lidhje me kredinë që ai pretendon të ketë marrë pranë Bankës Tregtare Agrare për blerjen e minitraktorit, megjithatë nuk rezultojnë të ketë depozituar qoftë edhe një dokument të vetëm të kohës, si për përfitim të kredisë apo shlyerjen e saj, ashtu edhe për blerjen e minitraktorit dhe shitjen e tij. Procesi i rivlerësimit, për vetë natyrën e tij, është një proces që kërkon dokumentacion provues. Nëse akte të tilla si deklaratat noteriale apo dëshmitë e dëshmitarëve nuk gjejnë provueshmëri, qoftë edhe në një akt provues të kohës, nuk kapërcejnë nivelin deklarativ për t'u konsideruar akt me fuqi provuese.

20.6. Nga analizimi i deklaratës së personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie, të vitit 2003, në cilësinë e provës që ligji nr. 84/2016 i ka njohur në nenin 32, pika 5 të tij, rezultojnë që subjekti si burim për këtë pasuri të ketë deklaruar *të ardhurat e siguruara nga paga dhe huamarrje të shlyer më pas. Banesa është blerë në tetor 1996 dhe huat e marra për këtë blerje janë shlyer deri në vitin 1998*, ndërkohë që nuk ka deklaruar si burim të ardhura nga shitja e minitraktorit. Në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së më 20.05.2015 për këtë qëllim, subjekti ka sqaruar se si hua ka deklaruar një kredi marrë në vitin 1994 në ish-Bankën Bujqësore të kohës për blerjen e një mjeti për nevoja të familjes, mjet të cilin në vitin 1996 e ka shitur dhe me të ardhurat e marra nga shitja, e të tjera që kishte, kursime nga pagat, si dhe hua të vogla nga të afërmit, bleu shtëpinë.

20.7. Gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit nuk përmend *huat e vogla marrë nga të afërmit* të deklaruara para ILDKPKI-së në vitin 2015 dhe as shumat e huave shërbyer për blerjen e shtëpisë. Në përgjigjet e pyetësorit standard të datës 08.01.2020, subjekti i rivlerësimit pretendon se për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 52,8 m² ka shërbyer edhe kthimi i shumës prej 100.000 lekësh nga z. Sh. J. dhënë nga subjekti për përdorim të përkohshëm. Sa i përket përdorimit të të ardhurave nga shitja e minitraktorit, rezultojnë që subjekti i rivlerësimit të ketë mbajtur qëndrime të ndryshme. Konkretisht, në deklaratën e pasurisë *vetting*, shprehet se nga çmimi i shitjes mbajti pjesën e pashlyer të kredisë, që e përdori për blerjen e banesës. Kredia ka qenë rreth 400.000 lekë (4.000 dollarë) dhe ka përdorur rreth ¼ për blerjen e apartamentit, pra, 100.000 lekë. Në përgjigjet e pyetësorit të dytë të datës 02.03.2020, subjekti deklaroi se nga çmimi i shitjes së minitraktorit mbajti për vete pjesën e pashlyer të kredisë të cilën e përdori për blerjen e banesës dhe kredinë e shleu më pas, ndërsa pjesën tjetër nga shitja ua ktheu vëllezërve. Ndërkohë që në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti shprehet se pasi u shit minitraktori pjesën nga shitja e mori subjekti i rivlerësimit, një pjesë e përdori për shlyerjen e këstit të vitit 1996 dhe pjesën tjetër rreth 100.000 lekë e përdori për blerjen e banesës në atë vit. Sa më sipër, mbetet i paqartë destinacioni i shumës 200.000 lekë pretenduar nga shitja e minitraktorit, shuma që iu dha vëllezërve nga shitja, nëse iu dha, pasi nisur nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit se marrëdhënia e tij me këtë kredi ka qenë formale do të rezultonte e pakuptimtë që kredia të jetë marrë për blerjen e minitraktorit që do të përdorej nga vëllezërit e subjektit të rivlerësimit për punën në bujqësi, këstet e kredisë të jenë shlyer po prej tyre¹⁶ dhe të mos kenë përfituar nga pjesa e shitjes që do të mbetej pas shlyerjes së kredisë. Gjithashtu, nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit mbetet

¹⁶ Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit subjekti deklaroi se, pjesën e këstit të kredisë ai e paguante formalisht por paratë ishin të vëllezërve të tij dhe mjeti ishte i tyre dhe se ai nuk ka shlyer veçse atë pjesë të kredisë së mbetur pa shlyer e që mbulohej nga vlera e shitjes. Duke qenë se mjeti u shit, me vlerën e shitjes u shlye pjesa e mbetur e kredisë.

e paqartë nëse shuma 100.000 lekë dhënë në përdorim z. Sh. J., buron nga kredia e marrë në vitin 1994 (1/4 e 400.000 lekë), nga kursimet e subjektit apo pjesë e të ardhurave nga shitja e minitraktorit. Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit në vendim se qëndrimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me shumën 100.000 lekë kanë qenë të ndryshme.

20.8. Në kushtet kur nuk ekziston qoftë edhe një dokument i kohës që të provojë marrjen apo shlyerjen e kredisë në shumën e pretenduar nga subjekti, interesin e aplikuar për këtë kredi, si dhe nuk ekziston ndonjë dokument që të provojë blerjen apo shitjen e mjetit bujqësor, Kolegji, në linjë me Komisionin, pavarësisht se i gjen pretendimet e subjektit të rivlerësimit jo bindëse, kreu analizën financiare për të verifikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të krijuar pasurinë apartament banimi në nëntor 1996 me të ardhura nga burime të ligjshme. Në analizën financiare: (i) të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit u konsideruan në masën 617.152 lekë; (ii) shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur në masën 100 % të të ardhurave nga pagat me arsyetimin në paragrafin 11.2.5.1, për periudhën 1989 – 1993 dhe në masën 66% për periudhën 1994 – nëntor 1996; (iii) në zërin *pasuri* janë përfshirë vlera e blerjes dhe shitjes së minitraktorit në vitin 1994 dhe 1996 respektivisht, si dhe vlera e apartamentit me sipërfaqe 52,8 m², blerë më datë 09.11.1996; (iv) në zërin *detyrime* është përfshirë vlera e kredisë 400.000 lekë marrë në vitin 1994, shlyerja e detyrimeve (principalit) për periudhën 1994 – 1996, si dhe dhënia dhe kthimi i shumës 100.000 lekë dhënë në përdorim të përkohshëm z. Sh. J.. Rezultatet e analizës së kryer treguan mungesë të burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për të blerë apartamentin më datë 09.11.1996, në vlerën (-) 249.521 lekë. Nëse shpenzimet e jetesës për periudhën prill 1995, kur subjekti i rivlerësimit emërohet gjyqtar (kryetar gjykate), deri në nëntor 1996 do të përlllogariten në masën 30% të të ardhurave nga paga, pamjaftueshmëria për blerjen e apartamentit rezulton në vlerën 105.014 lekë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

B/2. Për huan dhënë z. H. B., më datë 01.05.2002, në shumën 10.000 USD

21. Komisioni për këtë hua, në përfundim, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për dhënien e kësaj huaje në vitin 2002, në vlerën 416.130 lekë dhe se nuk ka paguar detyrimet përkatëse tatimore në vitin 2009, duke i shmangur ato. Lidhur me pagimin e tatimit, subjekti, në cilësinë e gjyqtarit, ka pasur dijeni se çdo e ardhur e përfituar duhet t'i nënshtrohet tatimit përkatës sipas ligjit dhe se ndër vite nuk ka bërë ndonjë përpjekje për plotësimin e këtij detyrimi, por e ka paguar atë vetëm për shkak të procesit të rivlerësimit dhe se forma me të cilën e ka paguar nuk është e njohur apo legjitimon një të ardhur të vitit 2009. Komisioni nuk ka njohur të ardhurat në vitin 2009 për krijimin e depozitës, duke i konsideruar në kundërshtim me kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
22. Subjekti i rivlerësimit duke mos qenë dakord me konkluzionin e Komisionit, për pamundësinë financiare për dhënien hua të shumës në vitin 2002, kundërshton metodologjinë e llogaritjes së shpenzimeve të jetesës për gjithë periudhën 1989 – 2002 nga Komisioni, pasi nuk ka marrë në konsideratë fakte e prova, duke u mbështetur në fakte të pahetuara e duke kryer llogaritje formale, që ndikojnë drejtpërdrejtë në burimin e ligjshëm për dhënien e huas. Komisioni nuk ka paraqitur një tabelë analitike ku të ketë pasqyruar të ardhurat dhe shpenzimet, ashtu siç i ka pranuar dhe shprehur në vendim, të llogaritura, të diferencuara sipas periudhave duke marrë në konsideratë përbërjen familjare dhe faktorin gjeografik, dhe në vendim është shprehur vetëm se nga llogaritjet, gjendja negative tashmë rezulton në masën (-) 416.130 lekë, pa e arsyetuar atë. Subjekti pretendon se edhe nëse nuk pranohet pagesa e tatimit mbi të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor, principali i huas në shumën 1.440.000 lekë duhet të njihet si e ardhur nga burime të ligjshme në vitin 2009.

23. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, lidhur me këtë hua, trupi gjykues konstaton:

23.1. Më datë 01.05.2002 nënshkruhet kontratë huadhënie (jo para një noteri publik), mes huadhënësit Ramazan Avdiu, huamarrësit H. B. dhe dorëzanësit K. Ç., për dhënien e një shume të hollash 10.000 dollarë amerikanë, me afat 1-vjeçar, me interes 10% në vit. Referuar përmbajtjes së kontratës, nëse huamarrësi nuk përmbush detyrimin në afat do të paguajë kamatëvonesë, si vijon: (a) nga data 15.05 deri 15.06.2003, për çdo ditë vonesë 0.1 % të huas dhe interesave të arrira; (b) nga data 16.06 deri 15.07.2003, 0.5% për çdo ditë vonesë; dhe (c) pas datës 16.07.2003, do të paguajë 1% për çdo ditë vonesë. Palët parashikojnë që gjatë vazhdimit të kontratës, huamarrësi nuk do të kryej asnjë veprim me shitjen e pasurisë së tij të paluajtshme.

23.2. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, në rubrikën “*Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre*”, subjekti i rivlerësimit deklaron të ardhura të përfituara nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. {***}, datë 29.01.2007, i Gjykatës Gramsh, ekzekutuar në vitin 2009, si shpërblim dëmi nga mosrespektimi i një kontrate huaje nga shtetasi H. B. (diferenca mes shumës së ekzekutuar prej 2.423.336 lekësh dhe 1.400.000 lekësh dhënë në fillim si hua lindi nga detyrimi dhe taksa e ekzekutimit paguar nga subjekti paraprakisht në shumën 66.216 lekë), në vlerën 957.120 lekë. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie, dorëzuar më 28.06.2004, ka deklaruar dhënien hua të shumës 1.440.000 lekë ose 10.000 USD (konvertuar sipas kursit të këmbimit 1USD/144 lekë), me interes 10% në vit, z. H. B.. Kontrata e huas për një vit, datë 01.05.2002. Detyrimet huamarrësi nuk i ka përmbushur. Burimi i huas: *të ardhurat nga paga në vitet e mëparshme*.

23.3. Në deklaratat periodike vjetore 2004 – 2008, subjekti i rivlerësimit deklaron huan e kapitalizuar çdo vit, me interesin prej 10% të saj të pashlyer nga huamarrësi, z. H. B.. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit deklaron të ardhura të papërfituara në momentin e deklarimit duke shprehur hipotetikusht përfitimin e tyre. Në deklaratën periodike vjetore 2007, subjekti deklaron se në datën 31.12.2007, detyrimi total (hua+interes) që huamarrësi ka për të shlyer është 2.108.000 lekë. Ndërkohë në deklaratën periodike vjetore 2009, subjekti deklaron se në muajin shkurt 2009, nëpërmjet një ekzekutimi të detyrueshëm u bë e mundur shlyerja e detyrimeve prej 2.423.300 lekësh [...] nga shtetasi H. B., përcaktuar me vendim gjyqësor në janar 2007. Nga shuma e përgjithshme që i ka xhiruar Zyra e Përmbarrimit rreth 101.000 lekë janë shpenzimet përmbarrimore të parapaguara nga subjekti në fillim të procedurës në qershor 2008. Me shumën 2.423.300 lekë është çelur depozita e muajit mars 2009.

23.4. Kundërshtimi i subjektit të rivlerësimit për konkluzionin e Komisionit mbi pamundësinë financiare për dhënien hua të shumës 10.000 USD më 01.05.2002, lidhet vetëm me metodologjinë e përdorur për përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se për periudhën dhjetor 1996 – prill 2002, në kohë të ndryshme ka bërë shpenzime jetike të ndryshme, të kushtëzuara nga numri i anëtarëve të familjes, faktori gjeografik dhe kushtet modeste të jetës, duke pretenduar shpenzime jetike në masën 25% të të ardhurave nga pagat për periudhën dhjetor 1996 – janar 1997, në masën 28% për periudhën shkurt 1997 – shtator 1997, në masën 30% për periudhën tetor 1997 – dhjetor 1999, si dhe në masën 40% për periudhën janar 2000 – prill 2002. Subjekti pretendon se mundësia e tij për kursim për periudhën nëntor 1996 – prill 2002, ka qenë në masën 1.619.554 lekë dhe gjendja financiare në momentin e dhënies së huas rezulton pozitive, minimalisht në masën 179.554 lekë, pa përfshirë gjendjen pozitive, që, sipas subjektit, ka rezultuar në momentin e blerjes së apartamentit në nëntor 1996.

23.5. Për të verifikuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për kursimin e shumës 1.440.000 lekë dhënë hua z. H. B. më 01.05.2002, trupi gjykues i Kolegjit, nëpërmjet

Njësisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare për periudhën 01.12.1996 – 30.04.2002, duke përllogaritur të ardhurat nga pagat në masën 2.848.487 lekë, shpenzimet e jetesës në masën 66 % të këtyre të ardhurave, shpenzime mobilimi 135.000 lekë dhe shlyerjen e detyrimeve për kredinë pranë Bankës Tregtare Agrare në vlerën 100.000 lekë, sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ. Rezultatet e analizës financiare treguan mungesë të burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur në vlerën (-) 719.951 lekë, për të justifikuar shpenzimet e kryera e kursimet e realizuara për të dhënë hua, në vlerën 1.440.000 lekë, më datë 01.05.2002, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Nëse shpenzimet e jetesës për këtë periudhë përllogariten në masën 30% të të ardhurave nga paga, pamjaftueshmëria rezulton në vlerën (-) 226.726 lekë.

23.6. Me dokumentacionin që subjekti i rivlerësimit ka depozituar në ILDKPKI bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, trupi gjykues konstaton të jenë depozituar: (i) mandat *urdhërderdhje* nr. {***}, më datë 1 korrik 2002, për depozitim të shumës 100.000 lekë për depozitë me afat 3-mujor në Bankën e Kursimeve ShA, dega Gramsh, me urdhërues z. B. T. dhe përfitues subjektin e rivlerësimit Ramazan Avdiu (Ilogaria nr. {***}); si dhe (ii) mandat *urdhërtërheqje* nr. {***} të lëshuar nga Banka e Kursimeve ShA, dega Gramsh, me të cilin subjekti i rivlerësimit ka tërhequr nga kjo bankë shumën 457.000 lekë më datë 5 shtator 2002, me përshkrimin *sa paguar depozitë 3-mujore*. Nga aktet financiare të mësipërme, trupi gjykues evidenton që subjekti i rivlerësimit përveç shumës së dhënë hua z. H. B. me kontratë huadhënie më datë 01.05.2002, duhet të ketë pasur gjendje depozite në bankë shumën 357.000 lekë deri në datën 01.07.2002 të depozitimit të shumës 100.000 lekë, pasi më datë 05.09.2002 provohet me mandat bankar tërheqja e depozitës në shumën 457.000 lekë prej tij. Komisioni nuk rezulton të ketë verifikuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të krijuar këtë shumë me konsideratë huan e dhënë më datë 01.05.2002, në shumën 1.440.000 lekë. Nëse në analizën e kryer do të përfshihej dhe kursimi i kësaj shume (457.000 lekë), pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të dhënë hua shumën 1.440.000 lekë në maj 2002, do të thellohej.

24. Lidhur me pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit, duke pretenduar që Kolegji, pasi të vlerësojë të gjitha rrethanat, të pranojë pagesën e tatimit në vitin 2021 për shumën 893.396 lekë, që konsiston në dëmin që gjykata i ka njohur për mospërmbushjen e detyrimeve ndaj tij, nga huamarrësi H. B. dhe të pranojë si burim të ligjshëm financiar këtë shumë. Shuma e përfituar nga vendimi gjyqësor, principali dhe shlyerja e dëmit, është depozituar në bankë dhe është deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2009 e nëse organet tatimore të ngarkuara nga ligji do të kryenin kontrollin përkatës do të kishin evidentuar këtë mangësi e do të ndërmerrnin masat përkatëse, të cilave subjekti do t'i përgjigjej duke kryer pagesat respektive. Subjekti i rivlerësimit pretendon se tatimi mbi këto të ardhura nuk duhet të paguhej, si dhe nuk kujton nëse e ka shlyer këtë detyrim. Megjithatë pretendon ai, mospagesa mund të jetë pasojë e harresës ose ndonjë interpretim i pasaktë i ligjit të kohës.

25. Nga analizimi i akteve në dosjen gjyqësore, lidhur me këto pretendime, trupi gjykues konstaton:

25.1. Me vendimin nr. {***}, datë 29.01.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gramsh, në çështjen civile me paditës Ramazan Avdiu, të paditur H. B. dhe K. Ç., me objekt [...] *shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga mosekzekutimi i kontratës së huas së datës 1 maj 2002, në masën 2.100.000 lekë, si dhe për çdo ditë pas datës 1 maj 2006 deri në përmbushjen e detyrimit, 1/365 e interesit 10% të detyrimit të arritur e të pashlyer*, ka vendosur: (a) miratimin e zgjidhjes me pajtim të mosmarrëveshjes; dhe (b) detyrimin e të paditurve H. B. e K. Ç. të paguajnë në favor

të paditësit Ramazan Avdiu shumë prej 2.000.000 lekësh, në dy këste: (i) kësti i parë prej 1.500.000 lekësh do të paguhet deri në datën 31.03.2007; (ii) kësti i dytë prej 500.000 lekësh do të paguhet deri në datën 31.12.2007; (iii) për çdo ditë vonesë në pagimin e secilit këst deri në pagimin e tij, nga të paditurit do të paguhet interes respektivisht në masën 400 lekë dhe 130 lekë; (iv) të paditurit kanë të drejtën e një afati prej 3 muajsh me interesat e mësipërme për secilin këst. Me kalimin e afatit të dytë, paditësi ka të drejtë të kërkojë ekzekutimin e detyrueshëm; (v) ligjërimin e masës së sigurimit të padisë, vendosur me vendimin nr. {***}, datë 05.07.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh. Vendimi ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar.

25.2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. {***}, datë 04.04.2008, ka pranuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin civil nr. {***}, datë 29.01.2007. Ekzekutuar nga Zyra Përmbarimore Gramsh nëpërmjet masës së sekuestros mbi sendin e paluajtshëm, njësi pronë e debitorit H. B. tjetërsuar përmes procedurave të ankandit në vlerën 3.605.000 lekë, në datën 20.02.2009. Në këtë kuadër është kaluar shuma 2.423.336 lekë kreditorit Ramazan Avdiu.

25.3. Gjatë hetimit administrativ, me përgjigjet e datës 25.01.2021 të pyetësorit të tretë, lidhur me pagimin e tatimit për të ardhurat mbi interesin e huas në vlerën 957.120 lekë të fituar në procesin gjyqësor me z. H. B., subjekti i rivlerësimit sqaron se nuk mban në kujtesë nëse ka paguar tatim mbi këtë shumë, si dhe nuk disponon dokument që provon pagesën. Nëse nuk është paguar, vjen për shkak se nuk është vlerësuar prej tij si interes i një huaje, por në ekzekutim të një vendimi gjyqësor. Subjekti sqaron se në kohën kur do të deklaronte pasurinë për efekt të procesit të rivlerësimit ka konsultuar legjislacionin tatimor dhe ka konstatuar se shpërblimi i fituar në bazë të një vendimi gjyqësor (neni 8, pika 1 e ligjit, për tatimin mbi të ardhurat), ka qenë përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat. Por ky përjashtim ka ndodhur me ndryshimin e ligjit në vitin 2012 dhe nuk ka qenë parashikuar në vitin 2010. Subjekti pretendon se nuk e ka pasur për qëllim të shmangë tatimin mbi të ardhurat për një shumë 95.712 lekë e të vinte në rrezik veprimtarinë e tij si gjyqtar, pasi ai ka paguar rregullisht pas vitit 2012 të ardhurat e siguruara nga huat dhe qiraja. Mospagesa, nëse rezulton sipas subjektit, vjen dhe për shkak të transferimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe ngarkesës shumë të lartë me punë.

25.4. Lidhur me pagesën e tatimit mbi të ardhurat, subjekti i rivlerësimit sqaron në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ se i është drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan, e cila, me shkresën nr. {***} prot., datë 22.01.2021, informon se për periudhën 2009 – 2012 tatimi mbi të ardhurat individuale nuk ka qenë i informatizuar në procesin e deklarimit të pagesës. Nga kontrolli i regjistrimit të pagesave në formatin *excel* në llogarinë tatime të tjera për periudhën 2009 – 2012 nuk rezulton asnjë pagesë e kryer nga Ramazan Avdiu. Ndërsa në një përgjigje të dytë me shkresën nr. {***} prot., datë 19.02.2021, kjo drejtori njofton se *pas verifikimit të kryer në sistemin informatik tatimor dhe në regjistrin e pagesave, të cilat janë të ruajtura në përputhje me dispozitat e ligjit 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe me aktet e nxjerra në zbatim të tij, ju bëjmë me dije se nuk rezulton asnjë pagesë e kryer nga z. Ramazan Avdiu për këtë periudhë.* Subjekti i rivlerësimit pretendon se Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan, me këtë shkresë nuk i është përgjigjur pyetjeve të tij, nëse regjistri i pagesave në formatin *excel* pasqyron në mënyrë të plotë të gjitha pagesat e bëra dhe a përbën akt zyrtar me fuqi të plotë provuese për të dhënat që pasqyron. Në këto kushte, informacioni i marrë nga organet tatimore nuk provon nëse e ka bërë këtë pagesë. Duke marrë përsipër humbje shtesë, subjekti ka bërë pagesën në mars 2021 të tatimit mbi të ardhurat personale të kësaj shume në masën 15%, pra, 143.568 lekë. Pagesa është bërë duke e konsideruar shumë si e ardhur individuale e periudhës janar – dhjetor 2020, pasi nuk kishte rubrikë për vitet 2009 – 2010, si dhe nuk ekziston rubrika për të ardhurat nga vendime

gjyqësore. Shuma e nxjerrë nga vendimi gjyqësor është depozituar në bankë dhe është deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2009. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk provohet se nuk e ka paguar tatimin mbi fitimin në vitin 2009 apo 2010 dhe kërkon pranimin e pagesës së tatimit të bërë nga ana e tij në vitin 2021, si dhe pranimin si burim të ligjshëm të shumës 957.120 lekë.

25.5. Trupi gjykues, vlerësimin e kësaj të ardhure e analizon në këndvështrim të kuadrit ligjor të procesit të rivlerësimit kalimtar, i cili në nenin D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 3, pika 19 të ligjit nr. 84/2016, ka përcaktuar qartësisht se të ardhura të ligjshme janë ato për të cilat janë paguar detyrimet tatimore sipas ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, si dhe vetë këtij ligji, i cili përcakton të ardhurat që i nënshtrohen detyrimit tatimor. Nga analizimi i dispozitave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuara apo shtuara ndër vite, rezulton se me ligjin nr. 9161, datë 18.12.2003, në nenin 8 e ardhura e tatueshme është shtuar germa “g”, në të cilën përfshihen të ardhurat e tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, me burim në Republikën e Shqipërisë, si dhe është shtuar neni 8/1, i cili rendit ato të ardhura të përjashtuara me ligj nga tatimi. Konkretisht në këtë nen, me ligjin nr. 122/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 [...]”, është shtuar pika 9, që ka përjashtuar nga tatimi *përfitimet për dëmshpërblime, të marra nëpërmjet vendimeve të formës së prerë të gjykatave, si dhe kompensimet e caktuara për kostot gjyqësore*. Sa më sipër, ashtu siç pretendohet edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit, në kohën e përfitimit së të ardhurës në vitin 2009 nga vendimi gjyqësor, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor të paguajë tatimin mbi këtë të ardhur.

25.6. PAGESA në mars të vitit 2021 e detyrimit tatimor të lindur në vitin 2009, duke e bërë vetëm për qëllim të procesit të rivlerësimit, nuk shëron paligjshmërinë e kësaj të ardhure në kuptim të nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit dhe njohësit të mirë të ligjit, nuk mund të përdorë si justifikim ngarkesën në punë, pakujdesinë apo harresën në përmbushjen e këtij detyrimi ligjor. Deklarimi i të ardhurës në deklaratën periodike vjetore 2009 apo depozitimi i saj në llogari bankare nuk e bën shumën 893.396 lekë (diferencë mes shumës së përfituar nga vendimi gjyqësor¹⁷ dhe principalit të huas) një të ardhur të ligjshme. Pavarësisht sa më sipër, kjo shumë, në vlerësim të trupit gjykues, konsiderohet si e ardhur shtesë/fitim dhe nuk përfaqëson në mënyrë të drejtpërdrejtë dëmshpërblim për ndonjë dëm të caktuar, i cili, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk duhet t’i nënshtrohej tatimit.

25.7. Pamjaftueshmëria e burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit konstatuar për dhënien e huas z. H. B., më datë 01.05.2002, si dhe mospërmbushja e detyrimit tatimor mbi diferencën mes shumës së përfituar nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. {***}, datë 29.01.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh dhe principalit të huas, në vlerësim të trupit gjykues, në linjë me Komisionin, bëjnë që shuma 2.423.336 lekë të mos vlerësohet e ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

25.8. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues konstaton se nga shuma prej 2.423.336 lekësh, janë krijuar në vijim pasuri e janë dhënë hua nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, konkretisht: (i) përdorur shuma 500.000 lekë tërhequr nga llogaria e depozitës së subjektit të rivlerësimit në Raiffeisen Bank, në të cilën më datë 03.02.2009 është derdhur shuma 2.423.336 lekë përfituar nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. {***}, datë 29.01.2007, për krijimin e depozitës 1.500.000 lekë, çelur në emër të bashkëshortes në OTP Bank ShA më datë 01.10.2010; (ii) shumat e tërhequra më datë 07.10.2011: (a) shuma 384.400

¹⁷ Depozituar në llogarinë bankare të Ramazan Avdiu më datë 03.02.2009, konfirmuar me shkresën nr. {***} prot., datë 04.02.2020, të Raiffeisen Bank ShA.

lekë tërhequr nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, në OTP Bank ShA, e cila origjinon nga depozita prej 1.500.000 lekësh, trajtuar më sipër në këtë paragraf; (b) shuma 1.178.400 lekë tërhequr nga subjekti i rivlerësimit, prej llogarisë së depozitës së tij në Raiffeisen Bank ShA, me burim shumën 2.423.336 lekë përfituar nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. {***}, datë 29.01.2007, përdorur për dhënie hua, huamarrësve P. dhe A. B. shumën 2.100.000 lekë dhënë hua, në të njëjtën datë, më 07.10.2011; (iii) mbyllja e depozitës prej 1.279.830 lekësh e bashkëshortes më datë 29.05.2013, në bankën Societe Generale Albania ShA, e cila e ka origjinën nga depozita 1.500.000 lekë¹⁸ e trajtuar më sipër në këtë paragraf, që buron në masën 500.000 lekë, pikërisht, nga shuma 2.423.000 lekë përfituara nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. {***}, datë 29.01.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh, ekzekutuar në vitin 2009, e cila ka shërbyer për dhënie hua shumën 1.400.000 lekë, huamarrësve A. dhe Sh. D., në të njëjtën datë, më 29.05.2013.

25.9. Në kushtet kur paligjshmëria e shumës 2.423.000 lekë ka afektuar ligjshmërinë e burimit të depozitave të krijuara, të gjendjes së likuiditetit në llogaritë bankare, si dhe huave të dhëna në vitin 2011, 2013 dhe 2015, trupi gjykues në Kolegj, me konsideratë efektin zinxhir të paligjshmërisë së kësaj shume në veprimet financiare të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në periudhën 2009 – 2016, për të mos amplifikuar këtë efekt në rezultatin e analizës financiare, vlerësoi të verifikojë mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për secilën nga pasuritë e marra në shqyrtim, respektivisht, pa dalë në rezultat përmbledhës për gjithë periudhën e rivlerësimit.

B/3. Për ndërtimin informal me sipërfaqe 68 m², në apartamentin e banimit me sipërfaqe 52,8 m², në Gramsh

26. Komisioni në vendim ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit rezulton me pamjaftueshmëri financiare për krijimin e kësaj pasurie me të ardhura nga burime të ligjshme.
27. Subjekti i rivlerësimit në ankim ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit në drejtim të kohës së ndërtimit të shtesës anësore dhe vlerës së ndërtimit: (a) *lidhur me kohën e ndërtimit*, subjekti i rivlerësimit kundërshton përfundimin e Komisionit në vendim se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit janë kontradiktore, pasi është i paarsyetuar në këtë drejtim dhe nuk analizon provat e paraqitura prej tij, të cilat provojnë në mënyrë të padyshimtë faktin që shtesa është përfunduar në gjendjen e deklaruar në deklaratën e interesave privatë 2012, në muajin tetor; (b) *lidhur me vlerën e ndërtimit*: (i) konkluzionet e Komisionit se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor të kohës (preventiv/situacion) për ndërtimin e shtesës, dhe se është në pamundësi financiare për të mbuluar ndërtimin në fazën e deklaruar, janë tërësisht të pambështetura në provat e paraqitura; (ii) mospranimi si provë i aktit të ekspertit vlerësues është haptazi i pabazuar, pasi volumet dhe zërat e punimeve nuk janë llogaritur mbi bazën e deklarimeve të bëra nga subjekti, por të gjendjes faktike në kohën e kryerjes së tyre; (iii) vlera e përcaktuar nga Komisioni nuk është e saktë, pasi shtesa anësore nuk ka pasur faqe perëndimore, pra, as mur e as suvatime të brendshme dhe të jashtme, as dyer e dritare. Referenca të çmimet e përcaktuara nga Enti Kombëtar i Banesave nuk është e saktë, pasi në rastin konkret nuk përfshihen punimet që i shërbejnë ambienteve të përbashkëta, të tilla si kafazi i shkallës, rrjeti i përbashkët elektrik e hidraulik apo izolimi i tarracës; (iv) në përcaktimin e vlerës së karabinasë, Komisioni nuk referon në akt ligjor, nënligjor apo disiplinë shkencore të ndërtimit se masa e shpenzimeve të ndërtimit në fazën e karabinasë përbën 70% të vlerës së objektit të përfunduar, gjë që e bën përfundimin e Komisionit arbitrar.

¹⁸ Referuar lëvizjeve të llogarisë bankare të bashkëshortes, përcjellë nga OTP Bank ShA, me nr. {***} prot., datë 22.01.2021.

28. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqësore, në analizim të shkaqeve ankimore të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstaton, si më poshtë.

28.1. Në kuadër të deklarimeve periodike dhe deklarimit për rivlerësim, kjo pasuri rezulton të jetë deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2012 *shtesë në banesën 1+1 në pallatin {***} Gramsh, me sipërfaqe rreth 70 m², ndërtuar deri në fazën e karabinasë + suvatime në tetor 2012. E paregjistruar në regjistrat publikë. Ndërtuar me të ardhura nga paga e kursime të mëparshme (huaja 300.000 lekë e kthyer nga P. B. në tetor 2012). Në vlerën 900.000 lekë. Në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti i rivlerësimit deklaron *shtesë pa leje në banesën e blerë në vitin 1996 në Bashkinë Gramsh, me sipërfaqe 68 m², ndërtim i papërfunduar. Ndërtuar karabinaja pjesërisht e suvatuar. Është deklaruar për legalizim me numër {***}, datë 19.12.2014, nga bashkëshortja T. A.. Shuma e përdorur për ndërtim është siguruar nga paga e bashkëshortëve dhe kursime të viteve të mëparshme. Është e palegalizuar dhe për pasojë e paregjistruar në ZVRPP-në Gramsh. Vlera: 900.000 lekë.**

28.2. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Rajonale Elbasan, me shkresën nr. {***} prot., datë 26.01.2021, informon se bashkëshortja e subjektit T. A. rezulton aplikuese në procesin e legalizimeve të ndërtimeve informale me formularin nr. {***} prot., datë 19.12.2014, në qytetin e Gramshit, të tillë rezultojnë dhe banorët e tjerë të pallatit, si dhe dërgon kopje të dokumentacionit përkatës. Në deklaratën nr. {***} prot., datë 19.12.2014, *“Për përfshirje në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesës në ndërtim me leje”*, bashkëshortja ka vetdeklaruar se ndërtimi është ngritur në periudhën 1997 – 2005. Me këtë praktikë rezulton të jetë dërguar dhe një deklaratë nr. {***} prot., datë 30.09.2015, *“Për përfshirje në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesës në ndërtim me leje”*, po nga T. A., në të cilin deklaron se ndërtimi është ngritur në qershor 2012. Në fotografitë e objektit shtesë anësore, në secilin nga këto dy aplikime, rezulton se gjendja e ndërtimit është e njëjtë, karabina e suvatuar pa dritare.

28.3. Për mospërputhjen e kohës së ngritjes së shtesës anësore, në dosjen e ILDKPKI-së, rezulton të jetë depozituar deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.05.2015, e bashkëshortes T. A., e cila sqaron se në aplikimin pranë Drejtorisë së ALUIZNI-t Elbasan ka shënuar gabim datën e ngritjes së ndërtimit (1997-2005), dhe me këtë deklaratë ndreq gabimet e bëra në deklarimin e datës 19.12.2014, duke sqaruar se ndërtimi është ngritur në vitin 2012.

28.4. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ka qenë gabim i bashkëshortes deklarimi për ndërtimin në vitin 1997 dhe pasi subjekti është vënë në dijeni të këtij gabimi i ka kërkuar të bëjë korigjimin, për të cilën bashkëshortja ka lëshuar një deklaratë noteriale dhe një deklaram tjetër për legalizim duke saktësuar se shtesa është ndërtuar në vitin 2012, gjë që provohet dhe nga ortofotot e ankesa e subjektit drejtuar Bashkisë Gramsh lidhur me këtë ndërtim. Në përgjigjet e pyetësorit të dytë (datë 02.03.2020), subjekti sqaron se në maj a qershor u ndërtuan vetëm 6 kolona, trarët dhe soleta, ndërsa në muajt tetor e nëntor muret dhe pjesërisht suvatimet. Shtesa ka mure vetëm në tri anë, pasi në anën perëndimore është pallati ekzistues dhe nuk është bërë as mur e as suvatime të brendshme. Rikonstruksioni i plotë i apartamentit ekzistues dhe shtesës është bërë në periudhën korrik - tetor 2019, kur subjekti kishte vendosur t’ia shiste këtë pasuri të vëllait. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti sqaron se objekti deri në fazën e deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2012 ka përfunduar në fund të tetorit ose në fillim të nëntorit 2012. Në qershor 2012 është ndërtuar struktura beton-arme dhe në shtator-tetor-nëntor 2012 është kryer pjesa tjetër e punimeve, 3 mure të jashtme dhe pjesërisht suvatime, një dorë suvatim i brendshëm dhe suvatimi i jashtëm. Pas ndërtimit të karabinasë së katit të katërt (që i përket subjektit të rivlerësimit) është ndërtuar në korrik karabinaja e katit të pestë. Për këtë shkak në muajin

qershor, nuk mund të fillonin punimet e mureve pasi gjendeshin skelat e mbajtjes së soletës dhe ishte duke u ndërtuar kati i sipërm sqaron subjekti.

28.5. Komisioni në vendim ka kryer analizën financiare në dy variante, duke e llogaritur ndërtimin e shtesës informale deri më datë 30.06.2012, vlerën e ndërtimit sipas deklaratimit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore 2012 dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, në masën 900.000 lekë në variantin e parë dhe deri më datë 30.10.2012 duke e përlllogaritur vlerën e ndërtimit sipas EKB¹⁹-së, në masën 1.051.758 lekë (68 m² x 29.461 lekë/m² sipërfaqe ndërtimit në Gramsh 2.003.348 lekë, në masën 70% të ndërtimit të përfunduar 1.402.343 lekë, duke zbritur nga kjo vlerën e TVSh-së 20%, si dhe fondin rezervë 5%, duke pranuar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit se punimet janë kryer me grupe pune të herëpashershme, po jo me fatura me TVSh) në variantin e dytë. Subjekti i rivlerësimit, rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në të dy mënyrat e analizës financiare kryer në Komision, në vlerat (-) 482.896 lekë dhe (-) 216.392 lekë, respektivisht.

28.6. Në ankim, subjekti pretendon se në deklaratën periodike vjetore 2012, që është dokumenti më i afërt me kohën e ndërtimit dhe më i besueshmi, ka deklaruar se ka përfunduar objektin në gjendjen e përkthuar në muajin tetor 2012. Të dhënat në deklaratën noteriale të bashkëshortes dhe deklarimet në deklaratën e pasurisë *vetting*, në të cilat është përcaktuar vetëm viti i ndërtimit, nuk vijnë ndesh me deklarimet e bëra në vitin 2012, pavarësisht se bashkëshortja kishte deklaruar në deklaratën e bërë prej saj për efekt legalizimi, muajin e kryerjes së ndërtimit, qershor 2012.

28.7. Trupi gjykues i Kolegjit gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit mbi periudhën e përfshirë në analizë. Për gjendjen e ndërtimit *karabina* nuk ka një përcaktim në akt ligjor apo nënligjor të përqindjes që ajo përfaqëson në raport me ndërtimin e përfunduar, për faktin se *karabina* konsiderohet një ndërtim që mund të ketë vetëm kolona dhe soletë, por edhe një ndërtim me mure të ndërtuar, por i pasuvatuar, pasi ashtu siç përmend dhe subjekti i rivlerësimit suvatimet përfshihen në punime rifinature, që e tejkalojnë gjendjen *karabina*. Nga leximi i kujdesshëm i deklaratës periodike vjetore 2012, subjekti rezulton të ketë deklaruar [...] *ndërtuar deri në fazën e karabinasë + suvatime në tetor 2012 [...]*, ndërkohë që në deklaratën e pasurisë *vetting*, deklarohet vetëm viti 2012 dhe jo muaji i ndërtimit. Në këto kushte, me të drejtë Komisioni ka bërë përlllogaritjet, duke marrë në konsideratë muajin e ndërtimit të deklaruar nga bashkëshortja e subjektit edhe nga banorët e tjerë të pallatit, të cilët, sipas dokumentacionit të përcjellë, me shkresën nr. {***} prot., datë 21.01.2021, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, për katin e parë dhe të dytë, deklarojnë të kenë ngritur ndërtimin në prill 2012, ndërsa T. A. (kati i tretë) në qershor 2012 apo dhe gjendjen e ndërtimit, sipas fotografive të depozituara në praktikën e legalizimit, ku shtesa objekt shqyrtimi që i përket subjektit të rivlerësimit dhe një kati më sipër rezulton e suvatuar dhe pothuajse e përfunduar, në krahasim me dy katet poshtë tij, të cilat rezultojnë vetëm me kolona, por që gjithashtu konsiderohet *karabina*.

28.8. Për sa i përket vlerës së ndërtimit, të deklaruar 900.000 lekë, pas kërkesës së Komisionit për të paraqitur dokumentacion justifikues ligjor preventiv/situacion për ndërtimin e shtesës 68 m², me përgjigjet e pyetësorit të dytë (02.03.2020), subjekti i rivlerësimit shpjegon se ndërtimi i shtesës nuk u krye nga një shoqëri ndërtimi, por nga disa punëtorë në grup, të cilët u gjetën nga banorët e kateve të mëposhtme. Për ndërtimin e themeleve, subjekti sqaron se i ka paguar banorit të katit përdhe shtetasit A. Z. shumën 54.200 lekë, si kontribut të tij. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit depozitoi aktin “*Relacion për shtesën e apartamentit të z. Ramazan Avdiu,*

¹⁹ Referuar udhëzimit nr. 4, datë 23.11.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2011”, për qytetin e Gramshit.

Gramsh”, datë 23.03.2020, përgatitur nga vlerësuesi F. S.²⁰, sipas së cilit kostoja e punimeve të kryera nga Ramazan Avdiu për ndërtimin e shtesës rezulton në vlerën 835.523 lekë. Në pikën 3 të këtij relacioni citohet se *zërat dhe volumet e punës të kryera, janë llogaritur sipas përmasave të planimetrisë dhe sqarimeve e shpjegimeve të deklaruara nga vetë z. Ramazan Avdiu, duke renditur*²¹ të dhënat sipas deklaramit të bërë nga subjekti. Në këtë akt, po ashtu eksperti shprehet se në preventive ka paraqitur vetëm punimet që rezultojnë nga gjendja faktike e të deklaruara prej z. Ramazan Avdiu.

28.9. Mungesa e dokumentacionit për vlerën në kohën e ndërtimit, vjen pasi ndërtimi nuk është bërë me leje apo nga një shoqëri ndërtimi, të cilat hartojnë preventiva e situacione dhe lëshojnë në faturat tatimore vlerën e mallrave dhe punimeve të kryera, arsye të pamundësisë objektive për paraqitjen e dokumenteve për të provuar vlerën e ndërtimit. Këto rrethana, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk përjashtojnë mundësinë e vlerësimit të objektit me ekspert vlerësues, referuar çmimeve të tregut apo atyre të miratuara, si orientim për preventivimin e punëve publike në rastin e prokurimit të fondeve publike. Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit në ankim e parashtrime në Kolegj pretendon se deklarimet që ai i ka paraqitur ekspertit rrisin vlerën e ndërtimit të shtesës, përsëri në kushtet kur relacioni i ekspertit vlerësues është bërë në bazë të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, ai vlerësohet pa vlerë provuese nga trupi gjykues, aq më tepër kur ekspertimi është bërë pasi ndërtimi kishte përfunduar dhe kur vlera e rezultuar e këtij ekspertimi konfirmon vlerën e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore 2012 dhe atë *vetting* prej 900.000 lekësh, sipas së cilit ndërtimi i shtesës ka kushtuar 840.000 lekë, 54.200 lekë kontribut për themelet dhe 5.000 lekë për prishjen e ballkonit dhe heqje mbeturinash inerte, në total rreth 900.000 lekë.

28.10. Në përcaktimin e koston së ndërtimit të shtesës anësore, me konsideratë praktikën e ndjekur tashmë në jurisprudencën e tij, Kolegji iu referua udhëzimit nr. 4, datë 23.11.2011, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2011”*, në të cilin është përcaktuar se për qytetin e Gramshit kosto mesatare për sipërfaqe ndërtimi është në vlerën 29,461 lekë/m². Në kushtet e një objekti të papërfunduar, në vijim të arsyetimit në paragrafin 28.7 të këtij vendimi, jurisprudencën e Kolegjit të sjellë në vëmendje nga subjekti i rivlerësimit, në të cilën vlera e karabinasë është përcaktuar në masën 40-42% të vlerës së plotë të objektit, në Kolegj u krye analiza financiare, duke e konsideruar koston e ndërtimit në masën 42% të ndërtimit të përfunduar, në vlerën 841.406 lekë.

28.11. Lidhur me burimin e krijimit të shtesës informale, subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* deklaron: (i) të ardhurat nga paga të bashkëshortëve; dhe (ii) kursime të viteve të mëparshme, ndërsa në deklaratën periodike vjetore 2012 deklaron: (i) të ardhurat nga pagat; dhe (ii) kursimet e mëparshme (huaja 300.000 lekë e kthyer nga P. B. në tetor 2012). Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se duke llogaritur edhe vetëm elementin hua të kthyer nga z. P. B. në vitin 2012, në shumën 300.000 lekë, gjendja do të shkonte pozitive. Gjithashtu, subjekti pretendon se ka pasur gjendje *cash* në vitin 2007, kundërvlerën e shumës 3.641 USD dhe vetëm ky element, pa përfshirë huan e kthyer apo shpenzimet në masë më të ulët, provojnë në mënyrë kategorike se ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për ndërtimin e shtesës.

²⁰ *Licencuar me nr. {***}, datë 15.07.2008, si vlerësues i pasurive të paluajtshme të llojit truall e ndërtesë.*

²¹ *Në “Relacion për shtesën e apartamentit të z. Ramazan Avdiu, Gramsh”, citohet: “[...] a) punimet për ndërtimin e shtesës janë kryer në vitin 2012 (deklarim); b) muraturat e jashtme janë mure dopio me tulla të lehtësuara me trashësi 9 cm dhe me një shtresë polisteroli prej 3 cm në mes (deklarim); c) punimet e kryera prej tij janë konstruksion beton/arme i shtesës, muraturat e tullës, suvatimi i jashtëm dhe vetëm dora e parë e suvatimeve të brendshme të tavaneve e muraturave (deklarim) [...]”. Këtij relacioni i janë bashkëlidhur: librezë e volumeve të punimeve të kryera, preventiv, planimetri, foto të objektit dhe dy ortofoto digitale të viteve 2007 e 2015.*

28.12. Lidhur me shumën 3.641 USD, të pretenduar nga subjekti si burim krijimi të gjendjes *cash* në fund të vitit 2007, Komisioni në vendim ka arritur në përfundimet se deklaratimet e subjektit në deklaratën periodike vjetore 2007 bien ndesh me rezultatet/gjetjet e Komisionit gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar. Prova e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me transfertën bankare të kryer prej tij të vëllait, tregon vetëm veprimin e kryer për transferimin e shumës dhe nuk pasqyron fakte të mëvonshme mbi këtë shumë. Në llogarinë e subjektit të rivlerësimit nuk rezultojnë veprime të mëpasshme apo transferta nga vëllai i tij për kthimin e shumës. Kjo provë nuk sjell ndonjë ndryshim nga ai i rezultatit të hetimit se shuma e pretenduar nuk ishte tërhequr dhe konvertuar duke u mbajtur *cash* në banesë, por ishte transferuar te llogaria e vëllait të subjektit. Shpjegimet e dhëna prej subjektit nuk provojnë pse ka kryer deklaratime të ndryshme dhe as provojnë se shuma është kthyer prej vëllait të tij brenda vitit e është përdorur nga subjekti për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar. Subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën e gjetjeve të Komisionit dhe as pretendimet e tij. Komisioni nuk e ka marrë në konsideratë në analizën financiare të vitit 2007 këtë shumë, si burim për krijimin e gjendjes *cash*, duke e konsideruar deklarin e subjektit të rremë.

28.13. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar përfundimet e Komisionit, duke ngritur në ankim këto pretendime: (i) nuk ka asnjë mospërputhje në deklaratën periodike, atë *vetting* dhe shpjegimet gjatë hetimit administrativ, bazuar tërësisht në prova e vëna në dispozicion. Komisioni ka përjashtuar në mënyrë të padrejtë shumën 3.641 USD në vitin 2007; (ii) arsyetimi i Komisionit për të mos marrë në konsideratë në analizën e vitit 2007 të kësaj shume si burim për krijimin e gjendjes *cash*, duke e konsideruar deklarin e subjektit të *rremë*, është tërësisht i pabazuar në fakte, me synimin për të eliminuar burimet e ligjshme të subjektit të rivlerësimit. Shuma prej 3.641 USD është dhënë në përdorim të përkohshëm, si *hua pa interes* e për shkak të marrëdhënies së posaçme nuk është lëshuar shkresë me fuqi të plotë provuese; (iii) Komisioni në vendim nuk përcakton se çfarë lloj prove mund të paraqiste subjekti për të provuar kthimin e shumës. Kjo vjen për shkak se ekzekutimi i detyrimeve nga një marrëdhënie juridike provohet me deklarin e kreditorit, sipas dokumentit që mund t'i kërkohe nga debitori. Subjekti i rivlerësimit ishte kreditori i vëllait dhe në deklaratën periodike vjetore 2007, nuk ka bërë gjë tjetër veçse ka konfirmuar kthimin prej tij të shumës 3.641 USD, sjellje në harmoni me dispozitat e Kodit Civil dhe rregullimet e legjislacionit. Lidhur me këtë shumë, trupi gjykues konstaton si vijon.

28.13.1. Në deklaratën periodike vjetore 2007, subjekti i rivlerësimit deklaron: (a) *shtuar shuma e parave cash në banesë, në vlerën 885.000 lekë (shuma prej 335.000 lekësh e saj vjen si pasojë e konvertimit të shumës 3.641 USD, në maj 2007, nga mbyllja e depozitës përkatëse;* (b) *pakësuar depozitë bankare në emrin e subjektit të rivlerësimit në Bankën Popullore, dega Gramsh, mbyllur kjo depozitë më datë 04.05.2007, shumë e dollarëve të konvertuar në datën e mësipërme, me kurs 1 USD = 91.99 lekë, vlera 3.641 USD.*

28.13.2. Referuar lëvizjeve të llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit, përcjellë nga OTP Bank ShA, me shkresën nr. {***} prot., datë 18.01.2021, subjekti i rivlerësimit ka llogari depozite nr. {***}, në monedhën USD, në vlerën 3.040,62, çelur në datën 29.10.2005, krijuar nga rinovimi i depozitës ekzistuese në vlerën 3.000 USD, e çelur në datën 28.04.2005, derdhur *cash* nga subjekti i rivlerësimit. Depozita më datë 04.05.2007, së bashku me interesat ka qenë në vlerën 3.641 USD. Kjo shumë është deklaruar nga subjekti *shtuar cash në banesë* në deklaratën periodike vjetore 2007. Po më datë 04.05.2007, rezulton se shuma 3.642,49 USD, të jetë transferuar me urdhërxhirim të brendshëm me përshkrimin *pag. [...] në favor të A. B. nga Ramazan Avdiu.*

28.13.3. Në prapësimet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit sqaron se shuma 3.641 USD, depozitë e mbyllur në datën 04.05.2007, i ka kaluar në llogari të vëllait B. A. me kërkesën e vëllait tjetër A. A., të cilët kishin një ekonomi të përbashkët familjare. Në vitin 2007, vëllai

A. A., kishte dëshirë të vijonte studimet në Angli. Pasi kishte kontaktuar me universitetet për vitin akademik 2007-2008, në prill të vitit 2007, ka kërkuar të transferonte shumën që dispononte në llogarinë e vëllait B. A., në OTP Bank ShA, për garanci financiare për marrjen e vizës britanike, ndërkohë që kishin rënë në dakordësi që në llogarinë e tij të shtohet person i autorizuar apo titullar edhe vëllai A. A.. Subjekti sqaron se në kushtet kur vëllai hoqi dorë nga aplikimi, kundërvlera e shumës 3.641 USD i është kthyer në *cash* nga vëllai B. A. brenda vitit 2007. Duke qenë se në deklaratën periodike vjetore 2007 kërkohej të deklaroheshin vetëm shtesat e pakësimet në fund të vitit, subjekti sqaron se nuk ka deklaruar veprime që kanë pasur efekt zero, pra, dhënie marrje huaje pa interes apo transferim e kthim brenda vitit. Shuma prej 3.641 USD ka qenë nga burime të ligjshme financiare dhe është transferuar e kthyer pa interes brenda një periudhe të shkurtër disamujore, brenda vitit.

28.13.4. Për të provuar sa pretendon lidhur me depozitën 3.641 USD, subjekti me prapësimet e rezultatit të hetimit administrativ ka depozituar në Komision: (a) ekstrakt të llogarisë së vëllait të tij nga OTP Bank ShA; dhe (b) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.04.2021, e z. A. A., ku deklarohet rreth përpjekjeve për ndjekjen e studimeve në Angli në vitin 2007, si dhe konfirmon shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit.

28.13.5. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë së klientit N. A. në OTP Bank ShA për periudhën 09.03.2006 – 13.08.2007, shuma prej 3.642,49 USD, transferuar nga i vëllai Ramazan Avdiu, rezulton të jetë kaluar për depozitë me përshkrim {***} *çelje DMA²², tërheq për DMA B. A.*

28.13.6. Në dokumentin *sqarime në lidhje me deklaratimet e pasurisë për vitet 2003-2013, për ILDKPKI-në²³*, subjekti i rivlerësimit deklarohet se: [...], në 2007 kam realizuar të ardhura në shumën 1.396.577 lekë, por kam tërhequr e përdorur edhe depozitën e mbyllur këtë vit, në shumën 3.641 USD. Nga sa sipër, në këtë vit kam shpenzuar një shumë prej 339.724 lekësh dhe 3.641 USD. Duke qenë se vlera e dollarit ka qenë rreth 100 lekë, kam shpenzuar një shumë që shkon nga 690.000 lekë deri në 710.000 lekë. Në këto kushte nuk mendoj se nuk ka mosmbulim për asetet.

28.13.7. Trupi gjykues në Kolegj, pas analizimit të dokumentacionit, vlerëson se: (i) subjekti i rivlerësimit duhet të kishte depozituar lëvizjen e llogarisë bankare të vëllait N. A. edhe për periudhën në vijim, për të pasqyruar transaksionin fundor të shumës së pretenduar dhe vërtetuar tërheqjen e kësaj shume; (ii) nga leximi i lëvizjeve të llogarisë bankare, nuk evidentohet bllokimi i kësaj shume për garanci bankare, por transferimi i saj në llogari “Depozitë me Afat”; (iii) ekzistojnë mospërputhje mes deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit para procesit të rivlerësimit në deklaratën periodike 2007 dhe sqarimeve të dhëna pranë ILDKPKI-së në vitin 2015, pasi në 2007 i deklarohet gjendje, në 2015 i deklarohet të shpenzuara. Në këto kushte, në linjë me Komisionin, trupi gjykues arrin në përfundimin se me dokumentacionin e administruar provohet vetëm transaksioni i dhënies së shumës, por në asnjë rast nuk provohet kthimi i kësaj shume subjektit të rivlerësimit. Nëpërmjet provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në Komision, nuk provohet që shuma prej 3.641 USD u tërhoq e u mbajt *cash* në banesë si deklarohet vetë subjekti në deklaratën periodike vjetore 2007. Për arsyet e mësipërme, trupi gjykues vlerëson të mos konsiderojë këtë shumë si burim për krijimin e gjendjes *cash* në banesë në fund të vitit 2007 e, për pasojë, as përdorimin e kësaj shume në formë kursime për pasuritë e krijuara në vijim.

28.14. Për sa më sipërshtesuar, në analizën financiare të kryer në Kolegj për të verifikuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të investuar në ndërtimin e shtesës informale deri në qershor 2012, me të ardhura nga burime të ligjshme, nuk

²² Akronim për “Depozitë me afat”.

²³ Sipas “Procesverbal mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, datë 21 maj 2015, mbajtur në ILDKPKI.

u konsiderua si burim krijimi shuma prej 3.641 USD me arsyetimin e mësipërm. Rezultatet e analizës financiare treguan mungesë të të ardhurave të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për kryerjen e këtij investimi në vlerën (-) 378.792 lekë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

B/4. Lidhur me mjetet monetare, depozita të deklaruara në deklaratën e pasurisë vetting

29. Trupi gjykues konstaton se në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi: (i) shumën prej 2.500.482 lekësh në llogarinë e pagës në Raiffeisen Bank ShA, dega Gramsh. Këto janë të ardhura nga paga e përfutur nga puna në vite si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, të patërhequra ndër vite; (ii) depozitë bankare me afat njëvjeçar në emër të subjektit të rivlerësimit në bankën Societe Generale Albania ShA, dega Gramsh, çelur në vitin 2015, në shumën 500.000 lekë, krijuar me të ardhura nga paga e bashkëshortëve e kursimet e mëparshme. Shtesat mbi shumën e krijuar nga interesat e maturuara të depozitës (në vlerën 508.512 lekë); (iii) depozitë bankare në emrin e bashkëshortes T. A. në bankën Societe Generale Albania ShA, dega Gramsh, çelur në vitin 2013, në shumën 800.000 lekë, krijuar me të ardhura nga paga e bashkëshortëve e kursimet e mëparshme. Shtesat mbi shumën e krijuar nga interesat e maturuara të depozitës (në vlerën 848.730 lekë); (iv) depozitë bankare në emrin e bashkëshortes T. A. në bankën Societe Generale Albania ShA, dega Gramsh, çelur në vitin 2013, në shumën 500.000 lekë. Shtesat mbi shumën e krijuar nga interesat e maturuara të depozitës (në vlerën 536.262 lekë).
30. Komisioni, lidhur me burimin e ligjshëm, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, për krijimin e pasurive të luajtshme, mjete monetare të deklaruara në formën e llogarisë rrjedhëse dhe në formën e depozitës bankare, në vlerën 4.300.025 lekë, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës së bashku me analizën financiare të kryer për periudhën e rivlerësimit 2003 – 2016, sikurse edhe gjatë analizimit të marrëdhënieve të huadhënies së subjektit të rivlerësimit me të tretë.
- 30.1. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të pagës së subjektit të rivlerësimit, përcjellë nga Raiffeisen Bank ShA, me shkresën nr. {***} prot., datë 04.02.2020, rezulton se shuma 2.500.482 lekë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* është e akumuluar nga pagat e realizuara për periudhën 09.01.2014 – 30.12.2016. Në këto kushte, Komisioni nuk kishte arsye përse t’i kalonte subjektit të rivlerësimit barrën e provës lidhur me të ardhurat në këtë llogari page dhe shumat e gjeneruara në këtë llogari janë përfshirë në analizën financiare të kryer në Komision e Kolegj, në zërin të *ardhura nga pagat*.
- 30.2. Lidhur me depozitën bankare në shumën 500.000 lekë, çelur nga subjekti më 11.06.2015, në Societe Generale Albania ShA, dega Gramsh, subjekti i rivlerësimit ngre pretendimin se Komisioni nuk është shprehur në vendim nëse kjo depozitë është krijuar me burime të ligjshme. Në analizën financiare në vendim, Komisioni nuk është shprehur për këtë pasuri. Veç të tjerash, si burim krijimi për këtë pasuri duhet të konsiderohet edhe shuma 1.070.000 lekë e kthyer nga huamarrësi A. D. në maj 2015. Procesi i hetimit dhe arsyetimi i Komisionit në vendim janë tërësisht inkohorent. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues konstaton:
- 30.2.1. Në deklaratën periodike vjetore 2015, subjekti i rivlerësimit deklaroi *çelur depozitë në bankën Societe Generale, dega Gramsh, në qershor 2015, në shumën 500.000, me të ardhura nga paga dhe huaja e kthyer*.
- 30.2.2. Në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni ka administruar shkresën nr. {***} prot., datë 22.01.2021, të OTP Bank ShA²⁴, nga ku rezulton depozitë bankare në shumën 500.000 lekë, çelur më datë 11.06.2015, në bankën Societe Generale Albania ShA. Për këtë depozitë

²⁴ OTP Bank ShA, përfaqëson ish-bankën Societe Generale Albania ShA.

bankare, Komisioni pas korigjimit të gabimit material dhe rishikimit të analizës financiare, konstatoi se për *depozitën bankare 500.000 lekë, datë 11 qershor 2015, rezultati ndryshon nga rezultat negativ në vlerën (-) 511.249 lekë në rezultat pozitiv në vlerën 384.216 lekë*, ndërkohë që në vendim Komisioni nuk shprehet për këtë depozitë, ndërsa analiza financiare e vitit 2015 i ka rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 849.621 lekë, duke mos justifikuar, kështu, shpenzimet e kryera, kursimet e realizuara dhe huan e dhënë shtetasit F. M., gjatë këtij viti. Sa i përket shumës prej 1.070.000 lekësh të kthyer nga shtetasi A. D., në linjë me Komisionin, trupi gjykues nuk e konsideroi të ardhur të ligjshme e nuk e përfshiu në analizë. Në analizën financiare të kryer në Kolegj, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj depozite më datë 11.06.2015, në vlerën (-) 541.370 lekë, sipas nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

30.3. Lidhur me depozitat e bashkëshortes në shumën 500.000 lekë dhe shumën 800.000 lekë çelur në vitin 2013 në bankën Societe Generale Albania ShA, dega Gramsh, Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ dhe rishikimit të analizës financiare, konkludoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive në vlerat (-) 229.167 lekë dhe (-) 409.626 lekë respektivisht, ndërsa në vendim nuk është shprehur për secilën prej depozitave, por në kuadër të analizës financiare vjetore 2013 ka konstatuar balancë negative në vlerën (-) 420.635 lekë.

30.4. Për depozitën bankare në shumën 500.000 lekë, subjekti i rivlerësimit ngre në ankim këto pretendime: (i) në vendim, Komisioni nuk ka paraqitur analizë financiare, si dhe nuk është shprehur lidhur me argumentet e subjektit të rivlerësimit se ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e kësaj depozite, Komisioni ka pranuar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të saj, pasi në të kundërt, vendimi do të ishte pasojë e procesit të parregullt ligjor, pa i dhënë përgjigje pretendimeve të subjektit për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, duke i cenuar kështu të drejtën e mbrojtjes në proces; (ii) mosnjohja e padrejtë e kundërvlerës së shumës 3.641 USD. si burim për krijimin e gjendjes *cash* në fund të vitit 2007, sjell pakësimin e burimeve financiare në vijim dhe jep efekt zinxhir në shumë elementë të analizës financiare. Edhe nëse nuk përfshihet kjo gjendje *cash*, përsëri subjekti i rivlerësimit rezulton me balancë pozitive në masën 125.749 lekë. Në analizë të këtyre pretendimeve, trupi gjykues konstaton:

30.4.1. Në deklaratën periodike vjetore 2013, subjekti i rivlerësimit deklaroi *çelur 2 depozita bankare nga bashkëshortja T. A. në bankën Societe Generale, dega Gramsh, një në korrik 2013 në shumën 500.000 lekë dhe një në tetor 2013 në shumën 800.000 lekë. Burimi, të ardhura nga paga e 2013, të ardhura cash në banesë të viteve të mëparshme dhe shuma e kthyer së bashku me interesat e kthyera nga P. B. në tetor 2013.* Depozita është konfirmuar nga OTP Bank ShA, me shkresën nr. {***} prot., datë 22.01.2021.

30.4.2. Komisioni, pas korigjimit të gabimit material të gjendjes *cash* si deklaruar nga subjekti në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie 2003 dhe rishikimit të analizës financiare, konstatoi se për këtë depozitë rezultati negativ ulet nga vlera (-) 544.167 lekë në vlerën (-) 229.167 lekë. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të bashkëshortes së subjektit, përcjellë Komisionit nga OTP Bank ShA, rezulton se depozita 500.000 lekë më datë 10.07.2013 e ka burimin nga shuma 1.279.830 lekë, e cila vetë origjinet nga depozita 1.500.000 lekë e krijuar në masën 500.000 lekë tërhequr më datë 01.10.2010 nga llogaria e subjektit të rivlerësimit në Raiffeisen Bank ShA, ku ishte depozituar shuma 2.423.336 lekë përfituar nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor në vitin 2009, të cilën trupi gjykues, si arsyeuar në paragrafin 25.7 të këtij vendimi, e vlerësoi të paligjshme. Në këto kushte, duke mos e përfshirë në analizë shumën 1.279.830 lekë në ndryshimin e gjendjes së likuiditetit, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me balancë negative në vlerën (-) 920.553 lekë më datë 29.05.2013, për dhënien e huas shtetasit A. D. dhe diferencë negative prej (-) 232.036

lekësh nga analiza e kryer për periudhën 30.05.2013 – 10.07.2013, për krijimin e depozitës 500.000 lekë në korrik 2013, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

30.5. Lidhur me depozitën bankare në shumën 800.000 lekë çelur nga bashkëshortja në bankën Societe Generale Albania ShA, dega Gramsh, më datë 14 tetor 2013, subjekti në ankim ngre pretendimin se Komisioni në vendim nuk është shprehur nëse kjo depozitë është me burime të ligjshme, që të çon në përfundimin se Komisioni ka njohur ligjshmërinë e burimeve të krijimit të saj, në të kundërt, kishte detyrimin të paraqiste në vendim si analizën financiare, ashtu edhe përfundimet lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit. Pavarësisht përfshirjes ose jo të shumës 3.641 USD, rezultati negativ ka ardhur edhe si pasojë e mosnjohjes pa të drejtë si burim të ligjshëm të shumës 600.000 lekë, të kthyer nga huamarrësi P. B. në vitin 2013. Në analizë të këtyre pretendimeve, trupi gjykues konstaton:

30.5.1. Pas korrigjimit të gabimit material, me analizën financiare të rishikuar, përcjellë subjektit të rivlerësimit më datë 16 prill 2021, Komisioni është shprehur *se për depozitën bankare 800.000 lekë në emër të bashkëshortes në datën 14 tetor 2013, rezultati negativ ndryshon nga vlera (-) 506.287 lekë në vlerën (-) 409.626 lekë.*

30.5.2. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, duke mos përfshirë si të ardhur të ligjshme shumën 3.641 USD dhe shumën 600.000 lekë të kthyer nga huamarrësi P. B., nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur të justifikojnë me të ardhura të ligjshme krijimin e depozitës bankare në shumën 800.000 lekë, në OTP Bank ShA, më datë 14.10.2013, në vlerën (-) 381.216 lekë për këtë vit. Analiza financiare për gjithë vitin 2013 tregon se subjekti dhe personi i lidhur nuk justifikojnë shpenzimet e kryera, kursimet e realizuara dhe huan e dhënë gjatë vitit 2013, në vlerën (-) 359.130 lekë.

30.6. Në përfundim, për depozitat bankare të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me mungesë burimesh financiare të ligjshme, për krijimin e depozitave në emër të bashkëshortes në shumën 500.000 lekë dhe 800.000 lekë në vitin 2013 dhe depozitës në emër të subjektit të rivlerësimit në shumën 500.000 lekë në vitin 2015, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

B/5. Lidhur me huan dhënë z. D. X. më datë 22.07.2004

31. Komisioni në vendim vlerëson se subjekti i rivlerësimit e ka fshehur këtë hua nga deklarata e pasurisë *vetting* e kontrolli i ILDKPKI-së ndër vite dhe veprimet e subjektit janë të gabuara e cenojnë rëndë etikën dhe figurën e gjyqtarit. Subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij dhe se në kuptim të pikës 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ndaj tij duhet të zbatohet masa disiplinore e shkarkimit, pasi nuk mund të provojë dot të kundërtën.
32. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionet e mësipërm të Komisionit, duke i konsideruar të pabazuara në prova e në ligj, duke pretenduar se : (i) në kohën e dhënies së huas, shuma nuk ka qenë as në përdorim e as në posedim të tij, por thjesht e mbante në ruajtje. Veprimi juridik i huadhënies është kryer në vitin 2003 nga vëllai i subjektit dhe jo nga vetë subjekti. Deklarata me shkrim në vitin 2004 nuk ka pasur si qëllim lidhjen e një kontrate të re, por marrjen e një provë për të provuar huan dhënë z. D. X., në shumën 20.000 dollarë amerikanë, në vitin 2003 nga z. B. Ç.. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit nuk kishte detyrim ligjor të deklaronte këtë hua në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie në vitin 2003 dhe deklaratën periodike vjetore 2004; (ii) veprimet e subjektit nuk mund të vlerësohen si përpjekje për fshehje apo për deklarim të pasaktë të pasurisë kur marrëdhënia e huas nuk është zbuluar si pasojë e veprimeve hetimore të kryera nga Komisioni, por nga

deklarimet me vërtetësi të subjektit në përgjigjet të pyetësorit, si një gjyqtar i përgjegjshëm për rëndësinë e funksionit që kryen në një shtet të së drejtës, i cili nuk mund të japë deklarime të pavërteta. Në analizë të këtyre pretendimeve, trupi gjykues konstaton:

32.1. Në përgjigjet e datës 06.02.2020 të pyetësorit standard, lidhur me transfertat nga jashtë, subjekti i rivlerësimit deklaroi se dy vëllezërit K. dhe B. (N.) A. në vitin 2000 kanë emigruar ilegalisht në Angli. Në vitet 2001 – 2004 nga asistenca dhe puna kanë sjellë në Shqipëri një sasi të ardhurash, nëpërmjet institucioneve financiare (western union, money gram). Një pjesë e kanë dërguar në emër të tyre, një pjesë nga persona të tjerë, shokë të tyre, dërgesat kanë ardhur në emrin e subjektit ose vëllait të tij P. A.. Në gjysmën e dytë të vitit 2002, një pjesë e tyre rreth 1.200.000 lekë u përdorën nga prindërit e tij për riparimin e banesës në fshat, ndërsa një pjesë tjetër për të mbuluar shpenzimet e jetesës për vëllain A. A. në atë kohë student në Tiranë. Për arsye sigurie këto të ardhura i mbante subjekti i rivlerësimit në banesën e tij. Në vitin 2003, z. B. Ç. (vjehtëri i kunatit, vëllait të bashkëshortes) i ka kërkuar që një shumë prej 20.000 dollarësh amerikanë t'ia jepte hua një të njohuri të tij me të cilin kishte marrëdhënie biznesi, z. D. X., nga Fieri, me interes 10% në vit (interesat bankare në atë kohë për depozitat me afat kanë qenë rreth 9% në vit). Pas miratimit të vëllezërve, shuma iu dha me kushtin që huaja të quhej si e dhënë z. B. Ç.. Subjekti sqaron se meqë shuma ishte e vëllezërve dhe duhet të bënte deklarin për vitin 2003, me z. B. Ç. ranë dakord që huaja të quhej e dhënë nga i vëllai P. A..

32.2. Në vijim të përgjigjeve, subjekti i rivlerësimit deklaroi se normalisht shumat duhet t'i kishte lënë në bankë, por mesa kujton në vitin 2001 pati panik për falimentim bankash. Në kushtet kur pas një viti z. D. X. nuk ia kishte kthyer shumën z. B. Ç., ky i fundit i kishte kërkuar subjektit që t'i merrte një dokument me shkrim. Në korrik 2004, pasi z. B. Ç. e kishte sjellë z. D. X. në Gramsh, subjekti i kërkoj këtij të fundit të lëshonte një deklaratë për marrjen e huas. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se kjo deklaratë u shkrua me shkrim dore prej tij, pasi z. D. X. kishte vështirësi në shkrim. Kontrata, sipas tij, u quajt e lidhur në 22 korrik 2004 dhe shuma duhet të kthehej në korrik 2005, por që nuk u kthye. Në kushtet kur plotësohej afati i parashkrimit, subjekti iu drejtua me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila vendosi që z. D. X. t'i kthejë detyrimin në shumën 2.500.000 lekë. Në këtë vendim citohet se shuma i përket vëllezërve të subjektit të rivlerësimit.

32.3. Për të mbështetur shpjegimet e tij, me përgjigjet e pyetësorit, subjekti i rivlerësimit depoziton:

32.3.1. Transfertat²⁵ me përfitues subjektin e rivlerësimit Ramazan Avdiu dhe vëllain e tij P. A. transferuar nëpërmjet Money Gram dhe Western Union.

32.3.2. Deklaratë e thjeshtë (shkrim dore), datë 22.07.2003, e z. B. Ç., i cili deklaroi se i ka marrë z. P. A. më datë 22.07.2003, hua në shumën 20.000 USD, me interes mujor 20.000 lekë, me afat 1 vit dhe me të njëjtat kushte ia ka dhënë shumën z. D. X.

²⁵ Me përfitues Ramazan Avdiu nëpërmjet Money Gram: dërgues J. Sh., shuma 4.099 GBP, më datë 17.07.2001; dërgues K. Ç., shuma 2.749 GBP, më datë 05.03.2002; dërgues Xh. N., shuma 2.739 GBP, më datë 03.11.2001; dërgues S. K., shuma 2.828 GBP, më datë 09.11.2001; dërgues B. A., shuma 2.000 GBP, më datë 19.04.2002; dërgues J. Sh., shuma 1.480 USD më datë 09.07.2002; dërgues J. H., shuma 2.619 GBP nëpërmjet Western Union, më datë 20.04.2004.

Ndërsa me përfitues P. A., nëpërmjet Money Gram: dërgues J. Sh., shuma 2.798 USD, më datë 06.03.2001; dërgues Sh. S., shuma 2.801 (monedha nuk përcaktohet), datë 11.04.2001; dërgues K. A., shuma 2.793 (monedha nuk përcaktohet) datë 22.05.2001; dërgues N. A., 2.791 USD, më datë 23.05.2001; dërgues A. K., 2.745 USD më datë 04.07.2001; nëpërmjet Western Union nga Italia, me dërgues E. J., të shumës 104.400 lekë më datë 14.11.2002

32.3.3. Deklaratë e thjeshtë (shkrim dore), datë 22.07.2004, nënshkruar mes z. Ramazan Avdiu dhe z. D. X., në prani të z. B. Ç.. Në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit deklaroi se sot më datë 22.07.2004 i dha shtetasit D. X. një hua në shumën 2.500.000 lekë, me afat kthimi për një vit, me interes 10% në vit. Subjekti ka deklaruar se kjo shumë është e vëllezërve të tij B. dhe K. A.. Deklarata u shkrua nga Ramazan Avdiu dhe u firmos nga D. X. dhe Ramazan Avdiu.

32.3.4. Vendim nr. {***}, datë 30.05.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për çështjen civile me paditës Ramazan Avdiu, i paditur D. X. me objekt *shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga mosekzekutimi i kontratës së huas, datë 22.07.2004, në masën 2.500.000 lekë, si dhe për çdo vit pas datës 22.07.2005, deri në ekzekutimin e vendimit interesin në masën 10% të shumës së huas. Sigurimin e padisë duke vënë sekuestër mbi pasuritë e luajtshme e të paluajtshme të të paditurit deri në vlerën 5.000.000 lekë.* Me këtë vendim, gjykata vendosi: *Pranimin e pjesshëm të padisë. Detyrimin e të paditurit D. X. t'i kthejë paditësit Ramazan Avdiu shumën e marrë hua prej 2.500.000 lekësh, si dhe dëmin e shkaktuar nga vonesa e pagimit të kësaj shume në vlerën e kamatë vonesave, sipas interesit më të lartë bankar aplikuar në Republikën e Shqipërisë nga bankat e nivelit të dytë deri në ekzekutimin e vendimit. Sigurimin e padisë duke vendosur sekuestro konservative mbi pasuritë e debitorit deri në vlerën e detyrimit. Gjykimi pranë kësaj gjykate është zhvilluar në mungesë të palës së paditur dhe njoftimi i saj është kryer me shpallje.*

32.3.5. Vendim nr. {***}, datë 30.05.2016, me të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor civil nr. {***}, datë 30.05.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë [i ekzekutueshëm nga data 07.07.2016].

32.4. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ lidhur me këtë hua, subjekti i rivlerësimit sqaron se nuk e ka deklaruar, pasi shuma e dhënë hua nuk ishte në pronësi të tij, por e ka mbajtur vetëm në ruajtje, për shkak të kushteve të sigurisë së banesës dhe i jepeshin anëtarëve të familjes me kërkesë të tyre. Në fund të vitit 2003, subjekti nuk e kishte më në ruajtje shumën, pasi ajo ishte marrë hua nga z. D. X. e, për këto arsye, nuk u deklarua në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie, të vitit 2003. Subjekti i rivlerësimit sqaron se ka vepruar si përfaqësues i vëllezërve pa tagër të shprehur me prokurë sesa si huadhënës, shkak për të cilën nuk e ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2004. Në kushtet kur shuma nuk ishte në pronësi të tij, edhe as huaja e përcaktuar në vendimin gjyqësor, subjekti nuk e ka deklaruar as në deklaratën e pasurisë *vetting*. Me këto prapësime, subjekti i rivlerësimit nuk i konsideron vëllezërit e tij *persona të tjerë të lidhur*, sipas përcaktimeve të nenit 3, pika 14 dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Ai sqaron se nuk ka asnjë pjesë të shumës dhe nuk ka përfitur asnjë të ardhur prej saj. Shuma ka ardhur në rrugë legale, që edhe nëse subjekti do ta fshihte do të evidentoheshin transferta të bëra në emër të tij në rastin e një hetimi të mundshëm nga ILDKPKI-ja, vetëm me kërkim informacioni. Shuma e dhënë hua, sipas subjektit, është siguruar nga puna në Angli e vëllezërve të tij, të cilët kanë punuar në informalitet e nuk mund të vërtetohet mënyrë e fitimit të këtyre parave. Vëllezërit, sipas subjektit, nuk janë dënuar ndonjëherë brenda apo jashtë vendit, as edhe për një kundërvajtje penale. Në prapësim të konstatimit të Komisionit, i cili në rezultatet e hetimit administrativ e ka vlerësuar në pozitën e pronarit, poseduesit dhe përdoruesit të shumave, subjekti i rivlerësimit thekson se nuk ka përfitur ndonjë shumë prej dërgesave të vëllezërve dhe ka vepruar në cilësinë e depozitarit, parashikuar nga neni 982 e vijues të Kodit Civil, pasi ruajtja nuk është, as e drejtë pronësie, as posedimi e as përdorimi, të cilat veç të tjerave janë të drejta për të gëzuar sendin, pra, për të përfitur frytet nga përdorimi, në rastin e të hollave, përfitim i interesave apo krijimi i pasurive prej tyre. Në ankim, subjekti shkon më tej duke u shprehur se mënyra e dërgimit të shumave në rrugë ligjore nëpërmjet transfertave iu jepte autoriteteve angleze dhe shqiptare mundësinë e verifikimit, nëse do të kishin dyshime lidhur me ligjshmërinë e tyre.

32.5. Duke konsideruar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se shuma e dhënë hua prej 20.000 USD i përket vëllezërve të tij, K. dhe B. A., nga analizimi i formularëve të transfertave bankare të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se nga 12 transfertat të kryera drejt tij apo të vëllait P. A., vetëm 3 rezultojnë të jenë dërguar nga vëllezërit B. dhe K. A. dhe një e dërguar nga bashkëshortja e këtij të fundit, znj. J. H.. Transfertat e tjera konstatohet të jenë dërguar nga këta persona: J. Sh., Sh. S., A. K., E. J., Xh. N., S. K. dhe K. Ç.. Ky i fundit, i cili i ka dërguar subjektit të rivlerësimit më datë 05.03.2002 shumën 2.749 GBP, rreth dy muaj më pas, siç rezulton nga aktet në dosjen gjyqësore merr cilësinë e dorëzanesit në kontratën e huadhënies²⁶ nënshkruar më datë 01.05.2002 mes subjektit të rivlerësimit dhe huamarrësit H. B. e, më pas, të të paditurit bashkë me z. B., që me vendimin nr. {***}, datë 29.01.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh, detyrohen t'i paguajnë të paditësit Ramazan Avdiu, shumën prej 2.000.000 lekësh. Nga ana tjetër, në përgjigjet e pyetësorit të tretë, subjekti i rivlerësimit sqaron se z. K. Ç. ushtron aktivitet tregtar në qytetin e Gramshit në fushën e tregtimit të artikujve ushqimore që në fillim të viteve '90 dhe se e njëjta që para vitit 2000 dhe nuk ka marrëdhënie të posaçme me të, por thjesht njihen.

32.6. Nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, nuk rezulton që Komisioni në vendim të ketë bërë një analizë financiare për mundësinë financiare të dërguesve të këtyre shumave, por e ka mbështetur konkluzionin e tij mbi sjelljen dhe veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me disponimin e këtyre shumave, në kuadër të etikës gjyqësore, cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë dhe fshehjes së kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting*. Sa më sipër, mungesa e konkluzionit të Komisionit mbi qenien ose jo të vëllezërve të subjektit të rivlerësimit *persona të tjerë të lidhur*, sipas përcaktimeve të nenit 3, pika 14 dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk ka cenuar të drejtën e mbrojtjes apo procesin e rregullt ligjor, si dhe nuk afekton arsyetimin e konkluzionit të arritur nga Komisioni.

32.7. Lidhur me këtë hua në vlerë të konsiderueshme prej 20.000 USD apo 2.500.000 lekësh, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit se vetëm e ka mbajtur në ruajtje shumën në banesë bie ndesh me vetë aktet e depozituara dhe shpjegimet e tij, se në fund të vitit 2003 ia ka dhënë shumën z. D. X., dhe në vitin 2004 është ai që ka ndërmarrë veprime për materializimin e saj me nënshkrimin së bashku me z. X. të deklaratës së thjeshtë me shkrim dore, të shkruar nga vetë subjekti i rivlerësimit më datë 22.07.2004. Për të vijuar më tej me depozitim prej tij të padisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt *për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga mosekzekutimi i kontratës së huas, datë 22.07.2004, në masën 2.500.000 lekë*, ku është në cilësinë e paditësit, ndërkohë që si palë paditëse mund të ishte dhe i vëllai P. A., meqë, sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, ishte rënë dakord që huaja të quhej e dhënë prej tij. Këto fakte tregojnë se veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit, pa një prokurë përfaqësues nga vëllezërit e tij, bëjnë që ai të jetë sjellë si pronar i kësaj shume e që tejkalojnë kufijtë e mbajtjes në ruajtje. Në mbështetje të këtyre rrethanave faktike, subjekti i rivlerësimit duhet ta vendoste veten përpara detyrimit për të deklaruar, si në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie në vitin 2003, ashtu edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, shumën e dhënë hua z. D. X. si pasuri në përdorim, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 5 e Aneksit të Kushtetutës. Ky detyrim përforcohet me faktin se në procesin gjyqësor civil *de juro* ai është paditës e, për rrjedhojë, do të rezultojë kreditor i shumës së përfituar nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor, pavarësisht pretendimit të tij se përfitimet nga vendimi gjyqësor do të merren nga vëllezërit e tij. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka fshehur në deklaratën e pasurisë *vetting*, këtë marrëdhënie huaje dhe likuiditetet që janë objekt i saj, duke

²⁶ Në pikën 6, të kontratës së huadhënies, datë 01.05.2002, parashikohet: "Në rast të mospërbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë prej huamarrësit H. B. me të njëjtat kushte detyrimin do ta përmbushë dorëzanesi K. Ç."

synuar shmangien nga kontrolli i burimeve për këtë pasuri prej organeve të rivlerësimit, duke u ndodhur kështu në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

B/6. Për huat e dhëna në vitet 2002, 2004, 2011, 2013 dhe 2015

33. Lidhur me huat e dhëna, Komisioni ka arritur në këto konkluzione: (a) veprimet janë kryer *cash*, jashtë sistemit bankar duke krijuar paqartësi dhe mosbesueshmëri mbi këtë veprimtari. Veprimet janë kryer në mungesë të plotë të transparencës e që ngrenë dyshime mbi ekzistencën e fiktivitetit apo deklarimit të rremë nga subjekti i rivlerësimit, i cili ka cenuar figurën e gjyqtarit me veprimet dhe mosveprimet e tij; (b) veprime të kryera nga një gjyqtar që ka njohje e dijeni të plotë mbi kuadrin ligjor dhe detyrimet për pagimin e tatimeve mbi të ardhurat, veprimet e kryera prej tij jo vetëm që nuk krijojnë transparencë, por përkundrazi shmangin atë dhe mbeten vetëm në kontekstin deklarativ; (c) subjekti i rivlerësimit ka ngritur një skemë me bazë deklarative, konfuze dhe aspak transparente, për të cilën Komisioni krijoi bindjen se janë deklarime të rreme; (ç) huadhëniet duken si një taktikë pune e gjyqtarit gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës; (d) pretendimet se interesat e huave kanë qenë në masën e interesave bankare, afërsisht sa interesi që do të përfitonte edhe nga depozitimi në një bankë ose më i ulët se interesi i kredive bankare, është i pambështetur në ndonjë provë apo fakt, pasi nga hetimi ka rezultuar se interesat e tij kanë qenë të larta dhe përtej atij bankar dhe se subjekti nuk ka paraqitur ndonjë provë për këtë pretendim. Nëse ai do të kishte dashur të përfitonte interesin bankar mund t'i linte lekët në depozitë (pasi ashtu i kishte ato fonde) e të përfitonte interesa në rrugë transparente; (dh) duket sikur subjekti i rivlerësimit, krahas ushtrimit të detyrës së tij si gjyqtar, ka ushtruar veprimtari që duhet të ushtrohet nga banka apo persona të licencuar, që në të paktën dy raste ka rezultuar se u ka shkaktuar pasoja të rënda huamarrësve deri në sekuestrim të pasurive të tyre nëpërmjet ekzekutimeve gjyqësore. Ushtrimi i kësaj veprimtarie nga një gjyqtar duket i papranueshëm me etikën e tij dhe në vlerësim të Komisionit është në cenim të besimit të publikut te drejtësia.
34. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionet e Komisionit, duke pretenduar se: (i) pas huas dhënë z. H. B. në vitin 2002, nuk ka dhënë më hua deri në vitin 2011, për periudhën 2011 – 2015 u ka dhënë hua dy miqve të tij dhe një mikut të mikut të tij të ngushtë, për t'i ndihmuar në zgjidhjen e çështjeve të tyre familjare. Ai nuk ka ndjekur ndonjë *taktikë pune* dhe përdorimi nga Komisioni i kësaj fjale është bërë për të rënduar situatën e sjelljes së subjektit të rivlerësimit. Qëndrimi i Komisionit është i gabuar, pasi veprimet e subjektit në dhënien dhe kthimin e huave janë kushtëzuar nga ligji; (ii) lidhur me huan dhënë z. D. X., vlerësimi i Komisionit për interes të palogjikshëm tregtar është tërësisht i pabazuar. Përfundimi i Komisionit se huamarrësi mund të ketë pasur qëllime paligjshëm është absurd dhe i pabazuar në prova; (iii) për të katër huat e dhëna, interesi i përfituar nuk ka qenë më i lartë se interesi maksimal i depozitave bankare të kohës. Komisioni nuk arsyeton në vendim përse arrin në konkluzionin se huat janë dhënë ndjeshëm me interesa më të larta bankare. Në asnjë rast Komisioni nuk paraqet një analizë të shifrave sa më të larta janë interesat e huave nga ato të bankës; (iv) veprimet e subjektit nuk kanë qenë informale, ato kanë qenë transparente pasi janë deklaruar rregullisht në deklaratat periodike vjetore dhe për to është lëshuar dëftesë e përmbushjes së detyrimit; (v) veprimet e subjektit të rivlerësimit janë transparente, të kryera në kuadrin e rregullimeve të Kodit Civil dhe Kodit të Procedurës Civile, të deklaruara rregullisht në deklaratat e interesave privatë periodikë, pa asnjë pasojë për ndonjë person apo shoqërinë në tërësi. Për këto arsye, vendimi lidhur me këtë pjesë është tërësisht i pabazuar në Kushtetutë, ligjin nr. 84/2016 dhe dispozitat e Kodit Civil e Kodit të Procedurës Civile; (vi) lidhur me arsyetimin e Komisionit në vendim se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar një aktivitet të kryer nga *banka apo persona të licencuar për këto aktivitete*, nuk i është kaluar barrë prove, duke e disavantazuar e duke mos i dhënë mundësi të shprehet në cenim të së drejtës së

mbrojtjes efektive. Kodi Civil nuk ndalon dhënien e huas nga persona fizike jo tregtarë. Në ndryshim nga funksionimi i bankave, subjekti nuk u ka marrë hua personave të tjerë për të dhënë huat, por ka dhënë të ardhurat e akumuluar dhe interesi i përfituar nga huat e dhëna, ka qenë sa ai bankar. Kur një kredimarrës nuk shlyen huan në një bankë, siç parashikon Kodi i Procedurës Civile, banka përfiton interes nga mospërmbushja në masën e kamatës ligjore, pra, jo më pak se 8% në vit. Subjekti nuk ka marrë penalitete për vonesën, pasi nuk ka pasur qëllim përfitimin e interesave më të larta se ato bankare. Veprimtaria e subjektit nuk mund të krahasohet me veprimtarinë bankare apo të personave juridike që kryejnë veprimtari kreditimi.

35. Në analizë të këtyre shkaqeve ankimore, trupi gjykues konstaton, si vijon.

35.1. Nga aktet në dosjen gjyqësore rezulton se subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur kanë dhënë hua huamarrësve: H. B. në vitin 2002, në shumën 10.000 USD, D. X. në vitin 2003, në shumën 20.000 USD, P. dhe A. B. në vitin 2011, në shumën 2.100.000 lekë, A. dhe Sh. D. në vitin 2013, në shumën 1.400.000 lekë, si dhe F. M., në vitin 2015, në shumën 600.000 lekë. Këto marrëdhënie detyrimi, janë formalizuar me kontratë të thjeshtë jo noteriale (2002), me deklaratë me shkrim dore (2003, 2004), me kontrata të nënshkruara para noterit (2011 dhe 2013), si dhe me aktmarrëveshje shkruar me shkrim dore (2015), si vijon.

35.1.1. Për huan në shumën 10.000 USD dhënë z. H. B. më datë 01.05.2002, kontrata e huadhënies është me afat 1 (një) vit dhe interes 10% në vit. Sipas kushteve kontraktuale, huaja dhe interesat do t'i kthehen huadhënësit vetëm në dollarë amerikanë. Nëse huamarrësi nuk përmbush detyrimin në afat do të paguajë kamatëvonesë. Gjatë vazhdimit të kontratës, huamarrësi nuk do të kryejë asnjë veprim për shitjen e pasurisë së tij të paluajtshme. Çdo veprim i tillë do të konsiderohet se kryhet në mashtrim me qëllim mosekzekutimin e detyrimeve që burojnë nga kontrata.

35.1.2. Për huan në shumën 2.500.000 lekë dhënë z. D. X., më datë 22.07.2004, nëpërmjet *deklaratë të thjeshtë, jo noteriale*, është përcaktuar afati njëvjeçar, me interes 10% në vit.

35.1.3. Për huan në shumën 2.100.000 lekë dhënë z. P. B. dhe bashkëshortes së tij, A. B., me kontratë huaje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.10.2011, me afat 2 vjet dhe interes 10.7% për dy vite, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë, sasia që do të kthejë huamarrësi më datë 07.10.2013, është 2.325.000 lekë, konkretisht: (a) 600.000 lekë në datën 07.10.2012; (b) 600.000 lekë në datën 07.04.2013; dhe (c) 1.125.000 lekë në datën 07.10.2013. Sipas nenit 4 të kontratës, me qëllim përmbushjen e detyrimeve që lindin prej saj, palët kanë rënë dakord të vendosin në hipotekë sendin e paluajtshëm të regjistruar pranë ZVRPP-së Gramsh, me të dhënat, lloji *njësi* me sipërfaqe 56,5 m², në pronësi të huamarrësit. Gjithashtu, në këtë kontratë parashikohen penalitete për vonesa në kthimet e shumave më sipër, si dhe garantimi në rast zhvlerësimi të lekut, në rast se kursi zyrtar i këmbimit të monedhës euro në raport me lekun është rritur më shumë se 10% krahasuar me kursin e datës së nënshkrimit të kontratës, që është 140.47 lekë, huamarrësi detyrohet të paguajë diferencën që vjen për këtë shkak.

35.1.4. Për huan dhënë z. A. D. dhe bashkëshortes së tij, Sh. D., me kontratë huaje nr. {***} rep., {***} kol., datë 29.05.2013, bashkëshortja e subjektit, T. A., u jep hua me shpërblim në masën 10% në vit, shumën 1.400.000 lekë, interesi i llogaritur në ditë 383 lekë, afati i dhënies së huas është për një periudhë të pacaktuar. Për marrjen dhe kthimin e detyrimit nënshkruhet kuitancë, interesi do shlyhet me një këst në çdo fund viti. Në këtë kontratë përcaktohet se *nëse huamarrësit nuk e shlyejnë detyrimin brenda afatit të caktuar, ata do të paguajnë një kusht penal për çdo ditë vonese në shumën 766 lekë, por asnjëherë më shumë se 20% të të gjithë shumës fillestare për çdo vit vonese. Palët kanë vendosur të mos vendosin titull garancie apo hipotekë.*

35.1.5. Për huan dhënë z. F. M., sipas aktmarrëveshjes datë 10.05.2015, nga subjekti i rivlerësimit Ramazan Avdiu, në shumën 600.000 lekë, me afat 2 vjet, me interes sa interesi maksimal i depozitave me afat 1 (një) vjeçar të bankave Raiffeisen ose Popullore + 1%, interes, i cili llogaritet në datën e dhënies së huas dhe në 1 (një) vit pas dhënies së huas për vitin e dytë. Për pagesë të vonuar, me përjashtim të marrëveshjes, do të paguhet interes 10% në vit. Nëse gjatë afatit ka zhvlerësim të monedhës euro, do të paguhet zhvlerësimi ndërmjet çmimit të euros në momentin e pagesës me çmimin 150 lekë për një euro.

35.2. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se nga viti 2002 deri në vitin 2015 u ka dhënë hua nga kursimet e tij katër personave të ndryshëm. Huat janë dhënë në mënyrë sporadike në vitet 2002, 2011, 2013 dhe 2015, pra, të shtrira në periudhë të gjatë kohore dhe me kërkesën e huamarrësve për zgjidhjen e problemeve familjare, konkretisht, z. A. D. e ka marrë huan për të paguar çmimin e truallit për legalizimin e banesës në Gramsh, z. F. M. për nevoja familjare, ndërsa P. B. për përfundimin e një banese në qytetin e Gramshit. Dy prej huamarrësve, sipas subjektit, bëjnë pjesë në rrethin e miqve të tij të ngushtë, prej shumë vitesh, me z. F. M. është njohur në vitet 1989 – 1990 dhe me z. A. D., prej vitit 2004. Me z. P. B. sqaron se është njohur nëpërmjet një shoku në vitin 2011, z. H. B. e ka njohur nëpërmjet z. K. Ç., ndërsa z. D. X., nga z. B. Ç., vjehri i kunatit të subjektit.

35.3. Sa i përket masës së interesit të huave, subjekti i rivlerësimit, në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, ka sqaruar se ajo është dakordësuar mes palëve dhe nuk ka pasur për qëllim nxjerrje fitimi, por për të ruajtur vlerën e shumave si pasojë e zhvlerësimit të lekut. Nëse masa e interesit do të ishte më e lartë se interesat bankare, atëherë, sipas subjektit, veprimi i tij mund të konsiderohej si dhënie e parave me *fajde*, me qëllim realizimin e fitimeve të paarsyeshme në dëm të interesave të personave që për shkak të nevojave të tyre pranojnë marrjen e këtyre huave. Në vlerësim të subjektit të rivlerësimit, ligji nuk ka përcaktuar masën e interesave të huave, por përcakton se huaja është me kamatë, me përjashtim të rasteve kur palët vendosin ndryshe. Niveli maksimal i detyrimeve ndërmjet personave fizikë në një marrëdhënie huaje nuk është i përcaktuar me ligj, por nga praktika e unifikuar e Gjykatës së Lartë. Konsiderohen të ligjshme interesat (kamata) deri në masën e interesave maksimale të depozitave bankare. Interesat e huave të dhëna janë nën interesat maksimalë të depozitave bankare dhe nuk përbëjnë akte e sjellje që cenojnë figurën e gjyqtarit.

35.4. Nga analizimi i dokumentacionit të dosjes gjyqësore, trupi gjykues konstaton se dhënia e huave nga ana e subjektit, po ashtu dhe kthimi i tyre është bërë në *cash*, jo nëpërmjet sistemit bankar. Pavarësisht faktit se kontrata e huas mund të lidhet edhe pa praninë e noterit dhe në deklaratat periodike vjetore, në kuptim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjekti ka deklaruar si dhënie, ashtu edhe kthimin e huave, trupi gjykues konstaton se subjekti dhe bashkëshortja janë konsiderueshëm të familjarizuar me përdorimin e produkteve bankare, fondet i disponojnë në llogari bankare, ndërkohë që nuk kanë kanalizuar kryerjen e transaksioneve të huadhënies nëpërmjet këtyre llogarive. Subjekti i rivlerësimit, si njohës i legjislacionit supozohet se duhet të operonte nëpërmjet sistemit bankar, për më tepër kur shumat e dhëna hua huamarrësve P. B. dhe A. D., ishin gjendje likuiditeti në llogari bankare deri në momentin e huazimit të tyre, ashtu dhe shuma 500.000 lekë e z. F. M. tërhequr prej tij nga llogaria bankare pranë Raiffeisen Bank ShA dhe kthyer subjektit të rivlerësimit në *cash*. Në vlerësim të trupit gjykues, vetë subjekti i rivlerësimit duhet të ishte i interesuar për kryerjen me transparencë të këtyre veprimeve financiare, për të mundësuar provueshmërinë dhe lehtësuar gjurmueshmërinë e tyre, në kushtet kur ai vetë ka qenë subjekt deklarimi.

35.5. Aktiviteti i dhënies së huave në shuma të konsiderueshme me normë interesi 10 % në vit, më i lartë krahasuar me normën e interesave bankarë, trupi gjykues e konsideron në papajtueshmëri me funksionin e gjyqtarit, i cili nuk mund të ushtrojë veprimtari financiare me qëllim fitimi e të peregjistruar në organet përkatëse. Lidhur me normën e interesit të aplikuar nga subjekti i rivlerësimit në dhëniet e huave, nga të dhënat e Bankës Botërore²⁷ për interesat e depozitave (në %) në sistemin bankar në vend, trupit gjykues i rezulton se për vitin 2002, norma vjetore e interesit të depozitës ka qenë 8.53%, ndërsa interesi i përcaktuar në huan dhënë z. H. B. në maj 2002, ka qenë 10% në vit. Në kushtet e pagesës në afat të interesit nga huamarrësi B., subjekti i rivlerësimit përfiton + 1.47% më shumë se interesi bankar në këtë rast. Në vitet 2004 dhe 2013, në të cilët subjekti i rivlerësimit ka dhënë hua me normë interesi 10% në vit, normat e interesit, sipas të dhënave të Bankës Botërore, kanë qenë 6.6% dhe 4.164% për secilin vit përkatësisht, dukshëm më të ulëta se norma e përcaktuar nga subjekti i rivlerësimit në marrëveshjet e nënshkruara për këto hua. Për huan dhënë z. P. B. në vitin 2011, nga analizimi i akteve në dosjen gjyqësore, trupi gjykues konstaton se sipas kontratës së huas norma vjetore e interesit është përcaktuar 5.35%, ndërkohë që gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit depoziton aktin *deklaratë pranimit i përmbushjes së pjesshme të detyrimit*, tetor 2014, nënshkruar nga ai vetë dhe huamarrësi P. B., në të cilën është deklaruar se interesat për vitin nuk u llogaritën në masën 10%, por në masën 8%, ndërkohë që sipas të dhënave të Bankës Botërore, interesi për vitin 2014 ka qenë + 1.914%.

35.6. Aplikimi i normës së interesit 10% është trajtuar dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në shqyrtimin e padisë që subjekti i rivlerësimit ka depozituar në gjykatë kundrejt të paditurit D. X., me objekt: *Shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga mosekzekutimi i kontratës së huas, datë 22.07.2004, në masën 2.500.000 lekë, si dhe për çdo vit pas datës 22.07.2005, deri në ekzekutimin e vendimit interesin në masën 10% të shumës së huas. Sigurimin e padisë duke vënë në sekuestër mbi pasuritë të luajtshme e të paluajtshme të të paditurit deri në vlerën 5.000.000 lekë.* Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në vendimin nr. {***}, datë 30.05.2016, ka çmuar se [...] *përcaktimi i dhënë në deklaratën e datës 22.07.2004, lidhur me përcaktimin e kamatëvonesave në shumën 10% në vit për shumat e marra hua vlerësohet si një kusht kontraktor absolutisht i pavlefshëm, pasi vlera e tyre e tejkalon kamatëvonesën ligjore. Në këtë nen përcaktohet se kamatëvonesat caktohen me ligj. Banka e Shqipërisë është institucioni i cili përcakton kamatëvonesat dhe aplikimi i tyre nga bankat e nivelit të dytë. Sa më sipër, gjykata çmon se i padituri duhet të detyrohet që të kthejë, jo vetëm shumën e marrë hua në vlerën 2.500.000 lekë, por edhe dëmin e shkaktuar nga vonesa e pagimit të detyrimit nga data që është vënë në vonesë 22.07.2005 deri në ekzekutimin e detyrimit. Ky dëm do të llogaritet sipas interesit më të lartë bankar i aplikuar në Republikën e Shqipërisë nga bankat e nivelit të dytë të shumës 2.500.000 lekë nga data 22.07.2005 deri në ekzekutimin e detyrimit shumë e cila do të llogaritet në fazën e ekzekutimit.*

35.7. Mbështetur në situatën faktike të sipërtrajtuar, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit pretendon se interesat që ai ka përfituar nuk janë në masën 10% të huas së dhënë, trupi gjykues në vlerësimin e tij i referohet pikërisht vullnetit të subjektit të rivlerësimit të materializuar në normat e interesit të përcaktuara prej tij në kontratat dhe aktmarrëveshjet e viteve 2002, 2004 dhe 2013, të cilat janë më të larta se të dhënat zyrtare të Bankës Botërore për interesat e aplikuar në sistemin bankar në vend për periudhat përkatëse. Fakti që huat kanë qenë të përsëritura, në vlera të konsiderueshme, me interes më të lartë se interesi i depozitave bankare, provon se veprimet financiare të kryera nga subjekti i rivlerësimit përfshihen në veprimtari private fitimprurëse dhe infektojnë ligjshmërinë e të ardhurave nga këto interesa. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se interesi i rënë dakord mes palëve nuk ka pasur për qëllim nxjerrjen

²⁷ <https://databank.worldbank.org/reports.aspx?source=2&series=FR.INR.DPST&country=#>

e fitimeve, por për të ruajtur vlerën e shumave si pasojë e zhvlerësimit të lekut dhe se i njëjti interes do të ishte përfituar edhe në bankë, gjendet i pabazuar nga trupi gjykues, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka operuar në ndryshim me sa pretendon e, për më tepër, kur përveç interesit më të lartë se ai bankar, subjekti i rivlerësimit ka përcaktuar kushte penalizuese e garantuese sikur të ishte institucion financiar.

35.8. Për ushtrimin prej tij të një aktiviteti që kryhet nga banka apo persona të licencuar për këto aktivitete, subjekti pretendon se Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove, duke e disavantazuar e duke mos i dhënë mundësi të shprehet në cenim të së drejtës së mbrojtjes efektive. Trupi gjykues konstaton se me rezultatet e hetimit, edhe pse Komisioni nuk është shprehur ekzaktësisht se e konsideron aktivitetin e kryer nga subjekti i rivlerësimit si një aktivitet bankar apo të kryer nga personat e licencuar në këtë drejtim, prej tij është kërkuar shpjegim nëse huadhëniet me interes ndër vite, në shuma të konsiderueshme, ishin në harmoni me dispozitat Kushtetuese, dhe nëse binin ndesh me figurën e gjyqtarit në Republikën e Shqipërisë. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të sqarojë në mënyrë shteruese ligjshmërinë e veprimeve të tij lidhur me huadhëniet dhe nuk i është cenuar e drejta për t'u mbrojtur. Konkluzioni i Komisionit në vendim, lidhur me sa sipër, vjen si rezultat i analizimit të dokumenteve të administruara në dosjen gjyqësore, konkretisht të marrëveshjeve e kontratave të huadhënies dhe përcaktimeve në to.

35.9. Nga ana tjetër, si në ankim, ashtu edhe në parashtrimet për shkaqet e ankimit depozituar në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ngre pretendimin se nuk ka vepruar si tregtar dhe se Kodi Civil nuk ndalon dhënien e huas nga persona fizikë jotregtarë. Duke iu referuar përcaktimeve në nenin 4, pika 2²⁸ të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, ai pretendon se në ndryshim nga banka, nuk ka pranuar depozita nga qytetarët për t’i dhënë hua, por ka dhënë të ardhurat e akumuluar prej tij dhe interesi i përfituar ka qenë sa ai bankar. Subjekti shprehet se nuk ka marrë penalitete për vonesën, pasi nuk ka pasur qëllim përfitimin e interesave më të larta se ato bankare. Veprimtaria e subjektit nuk mund të krahasohet me veprimtarinë bankare apo të personave juridikë që kryejnë veprimtari kreditimi.

Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues, në ndryshim nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit se burimi i dhënies së huave kanë qenë kursimet e tij dhe të bashkëshortes, konstaton se ka pasur dhe raste kur subjekti ka marrë hua të afërm për dhënien e këtyre huave. Në përgjigjet e pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për periudhën 2010 – 2016 (*deklaron që nuk mban mend datat konkrete*) ka marrë hua pa interes, për periudha të shkurtra, kur ka kryer veprime me persona të tjerë, si për *dhënien e huave*, për pagesën e arsimit të vajzave apo ndonjë veprim tjetër. Huat kanë qenë në shuma jo më të mëdha se 300.000 lekë, i ka marrë përgjithësisht të djali i dajës G. T. duke depozituar dhe deklaruar noteriale të tij²⁹ për këtë qëllim, si dhe në ndonjë rast nga i vëllai A. A.. Këto hua, ai deklaron t’i ketë marrë borxh pa interes, për periudha të shkurtra dy-tre mujore, për të mos prishur afatin e maturimit të depozitave apo për shkak se nuk dispononte ndonjë shumë të vogël *cash* në banesë deri në masën e pagës. Duke qenë se veprimet janë kryer brenda vitit nuk janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore përkatëse. Ndërkohë që në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë deklaruar se ka dhënë kursimet e veta, me përjashtim të një rasti kur i ka marrë vëllait një shumë të vogël për një kohë të shkurtër, nuk ka marrë hua

²⁸ Në nenin 4, pika 2 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, parashikohet se: “Veprimtari bankare” është pranimi i depozitave monetare ose i fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe përdorimi i tyre për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të vet, si dhe emetimi i mjeteve të pagesës në formën e parasë elektronike.

²⁹ Me përgjigjet e pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit depoziton deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.02.2020, të z. G. T..

me apo pa interes nga shtetas të tjerë. Qëndrimet e subjektit të rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ për këtë çështje, rezultojnë kontradiktore dhe nga dokumentacioni i administruar provohet se subjekti i rivlerësimit ka pasur për qëllim realizimin e fitimit.

35.10. Në vijim, nga analizimi i akteve për huat e dhëna, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit në këto aktmarrëveshje/kontrata huaje ka parashikuar kushte penalizuese, konkretisht: (i) për huamarrësin H. B.: (a) nëse huamarrësi nuk përmbush detyrimin e tij në afat, do të paguaj kamatëvonesë³⁰; (b) nuk do të kryejë asnjë veprim për shitjen e pasurisë së tij të paluajtshme, pasi një veprim i tillë do të konsiderohej mashtrim me qëllim mosekzekutimin e detyrimeve të kontratës; (c) në rast mospërmbushje të detyrimeve të kontratës, ato do të përmbushen nga dorëzanësi K. Ç.; (ii) për huamarrësit P. dhe A. B.: (a) penalitete për vonesa në kthimet e kësteve të huas; (b) garantim në rast zhvlerësimi të lekut, nëse kursi zyrtar i këmbimit të monedhës euro në raport me lekun është rritur në shumën 10% krahasuar kursin e datës së nënshkrimit të kontratës; (c) vendosja në hipotekë e sendit të paluajtshëm *njësi*, me sipërfaqe 56,5 m²; (iii) për huamarrësin D. X.: në cilësinë e dorëzanësit paraqitet z. B. Ç.; (iv) për huamarrësit A. dhe Sh. D., nëse nuk e shlyejnë detyrimin brenda afatit të caktuar, do të paguajnë një kusht penal për çdo ditë vonese në shumën 766 lekë, por asnjëherë më shumë se 20% të të gjithë shumës fillestare për çdo vit vonese; (v) për huamarrësin F. M., për pagesë të vonuar, me përjashtim të marrëveshjes, do të paguhet interes 10% në vit. Nëse gjatë afatit, ka zhvlerësim të monedhës euro do të paguhet zhvlerësimi ndërmjet çmimit të euros në momentin e pagesës me çmim 150 lekë për një euro. Për të gjitha këto parashikime në aktet e huadhënies duket që subjekti i rivlerësimit operon si institucion financiar, jep hua kundrejt fitimit, kundrejt garancive, si dhe aplikon kamatëvonesa.

35.11. Në këto kushte, gjendet i pabazuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk ka marrë penalitete për vonesa, pasi një element i tillë është parashikuar në kontratat e huadhënies. Për sa më sipër, mjafton të përmendet deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, ku lidhur me huan dhënë huamarrësve P. dhe A. B. deklarohet se ka mbetur pakthyer principali në shumën 775.000 lekë dhe interesi fillestar prej 225.000 lekësh, ndërkohë është kthyer nga principali shuma 1.325.000 lekë dhe interesa për vonesën nga 2012 e në vazhdim në shumën 304.000 lekë, përfshirë vitin 2016.

35.12. Lidhur me kthimin e shumave të dhëna hua apo mundësinë financiare të huamarrësve në përmbushjen e tyre, si dhe pagesën e tatimit mbi interesat e përfituara prej tyre, pavarësisht se trupi gjykues, ashtu siç ka arsyetuar në paragrafët 25.7, 25.8 dhe 25.9 të vendimit, e në kushtet kur ka vlerësuar të paligjshme shumën 2.423.336 lekë, paligjshmëria e saj ka afektuar dhe shumat e dhëna hua, huamarrësve P. dhe A. B. në vitin 2011 dhe huamarrësve A. dhe Sh. D. në vitin 2013, arrin në përfundimin se konkluzionet e Komisionit dhe më pas shkaqet e ankimit të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me kthimin e huave dhe pagesën e tatimit mbi interesat e përfituara, nuk kanë peshë dhe janë pa efekt për vendimmarrjen e Kolegjtit. Megjithatë, trupi gjykues gjen me vend të theksojë ambiguitetin e situatës së rezultuar nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore. Pavarësisht se subjekti ka nënshkruar kontrata/aktmarrëveshje për huat e dhëna në vitet 2011, 2013 dhe 2015, nuk i është përmbajtur vullnetit të shprehur dhe kushteve të përcaktuara në këto kontrata, ndërkohë paguan tatime mbi të ardhurat deklarative nga interesat e huave apo interesat për vonesat në shlyerjen e tyre, siç citohet në shkresën nr. {***} prot., datë 01.02.2021, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan, Ramazan Avdiu ka vetdeklaruar dhe paguar tatime pa ngarkuar asnjë dokument (kontratë qiraje

³⁰ Kamatëvonesat, si vijon: (a) nga data 15.05.2003-15.06.2003, çdo ditë 0.1% të huas dhe interesave të arrira; (b) 16.06.2003 – 15.07.2003, për çdo ditë vonesë do të paguaj 0.5% të huas dhe interesave të arrira; (c) pas datës 16 korrik 2003, për çdo ditë vonesë 1% të huas dhe interesave të arrira; (ç) gjatë vazhdimit të kontratës huamarrësi nuk do të kryej asnjë veprim me shitjen e pasurisë së tij të paluajtshme.

apo kontrata dhënie huaje). Në këto kushte, trupi gjykues gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit që subjekti i rivlerësimit krijon konfuzion dhe paqartësi lidhur me kthimin mbrapsht të shumave dhe pagimin e detyrimeve tatimore.

35.13. Rrethanat e analizuara në çështjen objekt shqyrtimi për huat e dhëna në vitet 2002, 2004, 2011, 2013 dhe 2015, për veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se bien në kushtet e paligjshmërisë, sa i përket aktivitetit të palicencuar, të ardhurave të realizuara dhe të patatuara, ashtu si arsyetuar në këtë vendim, të cilat trupi gjykues i ka vlerësuar në kuadër të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë në kuptim të nenit 59, pika 1, germa “a” të këtij ligji.

36. Lidhur me zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si rrjedhojë e vlerësimit tërësor në kuptim të nenit 4, pika 2 e po këtij ligji, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni zbatimin e kësaj dispozite e ka bazuar në vlerësimin në tërësi të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe veprimeve të kryera prej tij për huat e dhëna. Duke e konsideruar këtë konkluzion të Komisionit në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, në ankim dhe parashtrimet e depozituara në Kolegj, sjell në vëmendje qëndrimin e Kolegjit në jurisprudencën³¹ e tij, me pretendimin se kjo dispozitë (neni 61, pika 5) aplikohet në dy raste: (i) kur masa disiplinore nuk merret për asnjë nga kriteret në mënyrë të veçantë, por nga vlerësimi në tërësi i tri kriterëve vlerësohet se subjekti i rivlerësimit është i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës; dhe (ii) kur nga vlerësimi në tërësi i procedurave, subjekti është i papërshtatshëm për shkak të sjelljes së tij gjatë procesit të rivlerësimit.

36.1. Trupi gjykues, në vijimësi të jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit lidhur me aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, e gjen të drejtë pretendimin e ngritur nga subjekti i rivlerësimit. Thirrjen për zbatim të kësaj dispozite, e paraprin vlerësimi për të tria kriteret e këtij procesi (pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale) në tërësinë e tyre, kur problematikat e konstatuara për secilin kriter janë të pamjaftueshme për t’u ngritur në shkak shkarkimi më vete, sipas parashikimit në pikat 1, 2, 3 e 4, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 apo në rast kur sjellja dhe gatishmëria e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit cenon bashkëpunimin³² me Komisionin dhe Kolegjin, sipas parashikimit të nenit 48 të këtij ligji. Përderisa, në rastin objekt shqyrtimi, mangësitë e konstatuara në kriterin e vlerësimit të pasurisë janë të tilla që mjaftojnë për të kualifikuar subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, si dhe kur nuk ekzistojnë rrethana të tjera lidhur me këtë kriter, të cilat nuk janë përfshirë sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, mangësitë e këtij kriteri nuk mund t’i ngarkohen rishtazi subjektit edhe në kuptim të nenit 61, pika 5, pasi do të cenonin parimin e *mosndëshkimit dy herë për të njëjtën vepër*.

37. Për sa më sipër, trupi gjykues, mbështetur në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi nr. 381, datë 06.05.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i drejtë dhe, si i tillë, duhet lënë në fuqi.

³¹ Shih, vendimin nr. 37, datë 11.10.2022, paragrafët 18.3, 18.4 dhe 23.12, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

³² Shih vendimin nr. 3, datë 06.02.2023, paragrafi 12.20.1, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 381, datë 06.05.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ramazan Avdiu.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 06.06.2023.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi